

Shtator 2012
Numri: 54
E përmuajshme

Revistë edukative-kulturore - www.revistaetika.com

ETIKA

Shqipëri: 150 Lekë
Kosovë: 1 Euro
Maqedoni: 60 Den

**O ZOT,
NA BEGATO
ME DASHURINË
TËNDE!**





Editorial

“Allahu im! Të lutem të më bësh nga ata që të duan Ty, duan ata që të duan Ty dhe duan punët dhe veprat që të shpien te dashuria Jote. Allahu im! Bëj që dashuria ime për Ty të jetë më e madhe sesa dashuria ime për shpirtin tim, familjen time dhe ujin e pijshëm.” (Tirmidhi, Deavat, 73, Tefsirul Kuran, 39)

“Allahu im! Më begato me dashurinë për Ty dhe me dashurinë e personit, dashuria e të cilit për Ty ka për t’i vlejtur në jetën tjetër! Allahu im! Më jep fuqi që me anë të begative që Ti më ke dhuruar dhe të cilat unë i dëshiroj, të arrij të kryej punë, të cilat Ti i do dhe je i kënaqur me to! Allahu im! Bëj që ato gjëra që unë i dëshiroj, por Ti nuk mi ke dhënë, të mos më pengojnë të merrem me ato gjëra që Ti i do dhe të mos pengojnë që unë të jem i dhënë vetëm pas adhurimit Tënd!” (Tirmidhi, Deavat, 73/3491)

I Dërguari i Allahut e kërkonte dashurinë në tre nivele:

- 1 – Dashuria drejtuar Allahut.
- 2 – Dashuria drejtuar atyre njerëzve që e duan Allahun.
- 3 – Dashuria ndaj veprave që do të shpien drejt Allahut.

Kjo do të thotë se “dashuria për Allahun” do të jetë në qendër të zemrës. Fakti që edhe i Dërguari i Allahut kërkonte dhe përgjërohej për këtë gjë, të cilën ai e bën duke u mbështetur tek tradita që kishte ardhur nga profeti Davud, tregon se njeriu duhet ta kërkojë në mënyrë të vazhdueshme atë lloj dashurie.

Dihet se ai që dashuron, kërkon të jetë së bashku në çdo moment me atë që dashuron.

Dihet se ai që dashuron, ka mall për atë që dashuron.

Dihet se ai që dashuron, dëshiron t’ia plotësojë dëshirat asaj që dashuron.

Dihet se ai që dashuron, dëshiron ta përmendë atë që dashuron dhe nuk ngopet duke e bërë këtë gjë.

Dihet se ai që dashuron, dëshiron që dashuria e tij për atë që dashuron të rritet përherë e më shumë.

Këto ligje vlejné edhe në dashurinë e besimtarit ndaj Allahut.

Për këtë arsye, ajeti kuranor “Ela bi dhikrilahi tatmeinul kulub”, që do të thotë “Zemrat arrijné prehjen, ngopjen dhe qetësinë vetëm duke përmendur Allahun dhe duke menduar për Të”, fillon me pjesën pyetëse “A nuk është kështu” (Ela), duke sqaruar në këtë mënyrë gjendjen shpirtërore të besimtarit, zemra e të cilit është e mbushur me dashurinë ndaj Allahut.

“Dashuria për Allahun” vjen atëherë kur besimi është shtrirë në të gjithë indet e zemrës dhe është shndërruar në harenë brenda klimës së dashurisë. Ajo është majaja kryesore e personalitetit të besimtarit. Dashuria është ndjenja që ushqen besimin.

Kërkesa e dytë e të Dërguarit të Allahut, është “dashuria për ata që e duan Allahun”. Kjo do të thotë të kërkosh që dashuria e Allahut të shndërrohet si mishi me kockën brenda në shoqëri dhe të ndërtohet një shoqëri e re rreth dashurisë për Allahun. Në këtë mënyrë, i Dërguari i Allahut na mëson se besimtari do të arrijë ta mbajë të gjallë dashurinë për Allahun, vetëm në qoftë se jeton brenda një bashkësie që përbëhet nga besimtarë që i kanë zemrat të mbushura me këtë lloj dashurie. Kjo do të thotë se dashuria do të bëhet sociale, pra do të marrë formë në trajtën e një shoqërie.


Në shkallën e tretë të lutjes së dashurisë që bënte i dërguari i Allahut, thuhet “punët që do të më shpien tek dashuria për Ty”, duke u kërkuar një model jetese dhe një tërësi sjelljesh dhe shprehish që janë të indeksuara te dashuria e Allahut. Nga kjo pjesë e lutjes kuptojmë se duhet të tregojmë kujdes që çdo sjellje dhe veprim në jetën tonë, të jetë nga sjelljet e bukura që burojnë nga dashuria për Allahun dhe nga ana tjetër, të plotësojë kriteret e një veprimi që do të na shpjerë drejt “dashurisë për Allahun”.

Do të lexoni:

- Ahmet Tashgetiren / 4** Dashuria, ushqimi i zemrës
- Bejan Mehmet / 7** Udhëzimi është dhurata më e madhe hyjnore
- Nuredin Jëlldëz / 10** Energjia e harmonisë
- Edison Çeraç / 12** Paradoksi i ateizmit
- Prof. dr. Esad Xhoshan / 15** Delikatessa e të Dërguarit të Allahut
- Nexhat Ibrahimimi / 16** Ç'është Islami? -2-
- Dyxhane Xhyndiogllu / 20** 4 ngjyrat e vdekjes
- Semih Jollaçan / 24** Edukimi me mëshirë
- Nuredin Nazarko / 26** Lëvizjet totalitare
- Neslihan Nur Tyrk / 30** Falëndero Zotin!
- Dr. Jusuf El-Karadavi / 33** Vështrimi i shariatit Islam ndaj padrejtësisë
- Doç. dr. Sylejman Derin / 34** Kriteret e dashurisë për hir të Allahut
- / 36** Fotoja e Muajit
- / 38-39** Një ajet - Një hadith
- Osman Nuri Topbash / 40** Ndjeshmëria e besimit
- Dr. Adem Ergyl / 46** Kibleja e dashurisë

4

Ahmet Tashgetiren



16

Nexhat Ibrahimimi



26

Nuredin Nazarko



Viti: VI | Numri: 54 | Shtator 2012

Drejtor & Kryeredaktor:

Alban Kali

albankali@yahoo.com
+355 67 20 86767

Redaktor:

Zija Vukaj

Korrektore:

Dr. Irida Hoti

Përkthyesit:

Albert Halili / Arjan Ymeraj
Artur Tagani / Fatmir Sulaj
Ilir Hoxha

Dizajn-Grafik:

Bledar Xama

bledar_xama@hotmail.com

Për artikuj:

e-mail: revistaetika@progresibotime.com

Shkëmbor 2012

40

Osman Nuri Topbash



48

Musab Këjlyogllu



58

Bynjamin Zeran



Dynjaja është ara e ahiretit

48 / Musab Këjlyogllu

Istikameti

53 / Duran Ekizer

Çfarë përfitoi bota prej tij?

54 / Dr. Rexhep Ozdirek

Rënkova shumë

56 / Hatixhe Ežkan

A e përligj qëllimi aktin?

58 / Bynjamin Zeran

El Haku Mutekathur

60 / Ahmed Kalaja

Lënia e xhihadit sipas, Ebu Ejubit (r.a.), është fatkeqësi e madhe

63 / M. Sami Ramazanogllu

Qytetnimi musliman, përshtypjet ndërkombtare, shkaqet e prapavajtjes

64 / Zani i s'kaluemes

Arti i Kaligrafisë dhe Tez'hibit në botën Islame

66 / Ma. Artur Tagani

Të drejtat dhe obligimet e femrës

68 / Ma. sci. Flamur Sofiu

Sa më të pastër dhëmbët, aq më e fortë kujtesa

72 / Shëndet

Një libër me 53.000 fjalë konvertohet në ADN

73 / Teknologji

Gjendja e shqiptarëve në Siri

74 / Aktualitet

PROGRESI
BOTIME
www.progresibotime.com

Adresa:

L: Vasil Shanto / Rr: Çajupi
Shkodër / Albania

Tel: +355 22 254 634
Fax: +355 22 254 633

Zyra e përfaqësimit Maqedoni

Rr. Stiv Naumov / nr. 9 / lokal 25
Shkup / Maqedoni
+389 71 956 271

Zyra e përfaqësimit Kosovë:

Rr. Ardian Zurnaxhiu / pn. Ralin
Prizren / Kosovë
Tel: +381 29 222 795
Fax: +381 29 222 797
+377 4411 98 48

Çmimi:

Shqipëri: 150 Lekë
Abonim (një vjetor): 1500 Lekë
Kosovë: 1 Euro
Abonim (një vjetor): 10 Euro
Maqedoni: 60 DEN
Abonim (një vjetor): 720 DEN
Europë: 2 Euro
Abonim (një vjetor): 24 Euro



Dashuria

ushqimi i zemrës

Ahmet Tashgetiren

I Dërguari i Allahut, *salallahu alejhi ve selem*, ka thënë:

“Profeti Davud, alejhi selam, lutej me këto fjalë:

“Allahu im! Të lutem të më bësh nga ata që të duan Ty, duan ata që të duan Ty dhe duan punët dhe veptrat që të shpien te dashuria Jote. Allahu im! Bëj që dashuria ime për Ty të jetë më e madhe sesa dashuria ime për shpirtin tim, familjen time dhe ujin e pijshëm.” (Tirmidhi, Deavat, 73, Tefsirul Kuran, 39)

Në një raportim tjetër të këtij hadithi, mësojmë se i Dërguari i Allahut lutej me këto fjalë:

“Allahu im! Më begato me dashurinë për Ty dhe me dashurinë e personit, dashuria e të cilit për Ty ka për t’i vlejtur në jetën tjetër! Allahu im! Më jep fuqi që me anë të begatave që Ti më ke dhuruar dhe të cilat unë i dëshiroj, të arrij të kryej punë, të cilat Ti i do dhe je i kënaqur me to! Allahu im! Bëj që ato gjëra që unë i dëshiroj, por Ti nuk mi ke dhënë, të

mos më pengojnë të merrem me ato gjëra që Ti i do dhe të mos pengojnë që unë të jem i dhënë vetëm pas adhurimit Tënd!” (Tirmidhi, Deavat, 73/3491)

Këto dy hadithe na mësojnë lutje që i ka bërë i Dërguari i Allahut.

Mund të thuhet shumë mirë se ato janë edhe lutjet e dashurisë. Në hadithin e parë, i Dërguari i Allahut e fillon lutjen e tij drejt Zotit, me fjalët “kërkoj, dëshiroj”, ndërsa në hadithin e dytë, me fjalët “më dhuro, më begato”.

Kur shohim se i Dërguari i Allahut e ka filluar lutjen e tij me fjalët “më dhuro, më begato”, mund të pohojmë se e konsideronte “dashurinë” si një “ushqim hyjnor”. Ashtu siç është buka ushqim i domosdoshëm për fizikun, ashtu edhe dashuria është shndërruar në ushqimin e domosdoshëm për zemrat.

Kështu që, mungesa e dashurisë shndërrohet në urinë e zemrës dhe të shpirtit. Në këtë rast, “lutja për dashuri” në të njëjtën kohë mban edhe synimin për shpëtimin nga uria e zemrës.

I Dërguari i Allahut e kërkonte dashurinë në tre nivele:

1 – Dashuria drejtuar Allahut.

2 – Dashuria drejtuar atyre njerëzve që e duan Allahun.

3 – Dashuria ndaj veprave që do të shpien drejt Allahut.

Kjo do të thotë se “dashuria për Allahun” do të jetë në qendër të zemrës. Fakti që edhe i Dërguari i Allahut kërkonte dhe përgjerohej për këtë gjë, të cilën ai e bën duke u mbështetur tek tradita që kishte ardhur nga profeti Davud, tregon se njeriu duhet ta kërkojë në mënyrë të vazhdueshme atë lloj dashurie.

Dihet se ai që dashuron, kërkon të jetë së bashku në çdo moment me atë që dashuron.

Dihet se ai që dashuron, ka mall për atë që dashuron.

Dihet se ai që dashuron, dëshiron t'ia plotësojë dëshirat asaj që dashuron.

Dihet se ai që dashuron, dëshiron ta përmenjë atë që dashuron dhe nuk ngopet duke e bërë këtë gjë.

Dihet se ai që dashuron, dëshiron që dashuria e tij për atë që dashuron të rritet përherë e më shumë.

Këto ligje vlejné edhe në dashurinë e besimtarit ndaj Allahut.

Për këtë arsye, ajeti kuranor “Ela bi dhikrilahi taiminul kulub”, që do të thotë “Zemrat arrijné prehen, ngopjen dhe qetësinë vetëm duke përmendur Allahun dhe duke menduar për Të”, fillon me pjesën pyetëse “A nuk është kështu” (Ela), duke sqaruar në këtë mënyrë gjendjen shpirtërore të besimtarit, zemra e të cilit është e mbushur me dashurinë ndaj Allahut.

“Dashuria për Allahun” vjen atëherë kur besimi është shtrirë në të gjithë indet e zemrës dhe është shndërruar në harenë brenda klimës së dashurisë. Ajo është majaja kryesore e personalitetit të besimtarit. Dashuria është ndjenja që ushqen besimin.

Kërkesa e dytë e të Dërguarit të Allahut, është “dashuria për ata që e duan Allahun”. Kjo do të thotë të kërkojë dashuria e Allahut të shndërrohet si mishi me kockën brenda në shoqëri dhe të ndërtohet një shoqëri e re rreth dashurisë për Allahun. Në këtë mënyrë, i Dërguari i Allahut na mëson se besimtarit do të arrijë ta mbajë të gjallë dashurinë për Allahun, vetëm në qoftë se jeton brenda një bashkësie që përbëhet nga besimtarë që i kanë zemrat të mbushura me këtë lloj dashurie. Kjo do të thotë se dashuria do të bëhet sociale, pra do të marrë formë në trajtën e një shoqërie.

Në shkallën e tretë të lutjes së dashurisë që bënte i dërguari i Allahut, thuhet “punët që do të më shpien tek dashuria për Ty”, duke u kërkuar një

model jetese dhe një tërësi sjelljesh dhe shprehish që janë të indeksuara te

dashuria e Allahut. Nga kjo pjesë e lutjes kuptojmë se duhet të tregojmë kujdes që çdo sjellje dhe veprim në jetën tonë, të jetë nga sjelljet e bukura që burojnë nga dashuria për Allahun dhe nga ana tjetër, të plotësojë kriteret e një veprimi që do të na shpjerë drejt “dashurisë për Allahun”.

I Dërguari i Allahut përgjerohej që “të gjitha begatitë që na janë dhuruar, të cilat i dëshirojmë që t'i kemi, të shndërrohen në forcën e duhur për të punuar ato punë që i pëlqen Allahu dhe me të cilat është i kënaqur.” Në këtë mënyrë, ai e ngarkon ymetin e tij me ndërgjegjen për t'i caktuar të gjitha begatitë, nga të cilat përfitojmë në jetën e përditshme, në llogari të një jete me të cilën është i kënaqur Allahu dhe e do atë.

Kjo do të thotë se “dashuria e Allahut”, që lëshon sythe në zemër, duhet të masivizohet në mesin e njerëzve dhe të përfshijë të gjithë statet e jetës.

Ai që do të formohet nga të gjitha këto, është njeriu i Islamit, i mbrujtur me dashuri dhe shoqëria e fesë islame.

Leximi i kujdesshëm i ajetit 54, të sures Maide, na

*Burimi i vërtetë
i dashurisë është Krijuesi i Gjithësisë,
“që është i mbushur me dashuri
dhe do pa masë çdo krijesë”.
Zemra e njerëzve, që janë shkëputur
nga burimi i dashurisë, është e tharë,
e uritur dhe plot dhimbje. Pasi vetëm Zoti
sundon mbi zemrat. Në qoftë se dashuria
është një begati, burimi i saj
është Zoti, sepse Ai është burimi
i të gjitha begative.*

mundëson të shohim dallimin e dashurisë që ekziston në shoqërinë islame me dashurinë që ekziston në një shoqëri që ka zgjedhur një rrugë tjetër nga ajo e Islamit. Ja cili është ajeti në fjalë:

“O besimtarë! Nëse ndokush prej jush braktis besimin e vet, dijeni se Allahu do të sjellë njerëz, që i do dhe që e duan; të përulur me besimtarët dhe të ashpër me femohuesit; që luftojnë në rrugën e Allahut dhe nuk i tremben qortimit të asnjë qortuesi. Kjo është mirësia e Allahut, të cilën Ai ia jep kujt të dojë. Allahu është Bujar i madh dhe i Gjithëditur.”

Ata që braktisin fenë...pra, që zgjedhin një rrugë tjetër përveç rrugës së fesë islame...

Allahu do t'i zëvendësojë me një bashkësi tjetër.

Karakteristika e parë e asaj shoqërie është fakti se ata meritojnë dashurinë e Allahut ndaj tyre. Natyrisht se edhe ata e duan Allahun.

Me fjalët e Kuranit “Juhibbuhum – Allahu i do ata!”

Si dhe...Juhibbunehu...
Ata e duan Allahun.

Më pas, karakteristikën e dashurisë e ndjekin edhe veçoritë tjera. Modestia ndaj besimtarëve, qëndrimi krenar përballë qafirëve, blatimi i jetës në rrugën e Allahut, nënvleftësimi i fyerjeve që i bëhen për shkak të besimit...

Ky është përkufizimi hyjnor për shoqërinë islame. Një shoqëri që mbështetet mbi themelet e dashurisë, një shoqëri krenare.

“Ai i do ata dhe ata e duan Atë...”

Duhet menduar thellë se ç'do të thotë të jesh një shoqëri që takohet në dashuri me Krijuesin.

Në një shoqëri joislame, është e qartë se ekziston problemi i dashurisë. Mungesa e dashurisë është akti i një zemre të zbrazur, që nuk arrin të përcaktojë në mënyrë të drejtë se ku dhe si duhet të drejtohet.

Pasi burimi i vërtetë i dashurisë është Krijuesi i Gjithësisë, “që është i mbushur me dashuri dhe do pa masë çdo krijesë”.

Zemra e njerëzve, që janë shkëputur nga burimi i dashurisë, është e tharë, e uritur dhe plot dhimbje.

Pasi vetëm Zoti sundon mbi zemrat.

Në qoftë se dashuria është një begati, burimi i saj është Zoti, sepse Ai është burimi i të gjitha begative.

Si mund të shndërrohet në një burim që rrjedh pa pushim, dashuria që nuk buron nga dashuria për Allahun?

Në mënyrë që një bashkësi të ruajë karakteristikat e saj si një shoqëri myslimane, duhet që zemrat e individëve që formojnë atë shoqëri të jenë të mbrujtura me dashurinë që nuk e ka këputur lidhjen e saj me burimin hyjnor.

Në qoftë se bëhet pyetja: vallë çfarë është dashuria që të takon me Krijuesin?..

Duhet të shohim sërish në kornizën e gjerë të saj:

Të kujtosh përherë atë që do.


T’ia përmbushësh dëshirat atij që dashuron.

Të mos qëndrosh larg atij që dashuron.

Të gëzosh dashurinë e atij që dashuron...

I dërguari i Allahut na nxit të drejtohem drejt portës së Zotit dhe të mësojmë të lutemi, në mënyrë që të bëhemi pjesëtarë të një shoqërie të tillë dhe një shoqëri e tillë gëzon dashurinë e Zotit. Të drejtohem që të fitojmë dashurinë prej dergjahut hyjnor. Pra, profeti na orienton të kërkojmë prej Zotit dashurinë për Allahun dhe dashurinë e Allahut.

Në njëfarë kuptimi, kjo do të thotë se jemi në provën nëse do të bëhemi apo jo shoqëria që do Allahu. Zoti na e mundësoftë këtë gjë. Amin.





UDHËZIMI

ËSHTË DHURATA MË E MADHE HYJNORE

Bejhan Mehmet

Dhurata më e madhe, që Allahu i Madhëruar na ka bërë, sigurisht është udhëzimi. Nisur nga kjo, le të shtjellojmë së pari kuptimin leksikor e terminologjik të fjalës *udhëzim*. Pastaj të shfaqim shembuj në kuptim pozitiv e negativ nga koha e të Dërguarit të Allahut, sallallahu alejhi ve sellem. Në këtë mënyrë, dëshiroj ta perceptojmë temën më mirë.

Kuptimi leksikor i fjalës *udhëzim*: të kuptosh rrugën e drejtë e të mirë dhe ta pasosh atë. Ndërsa në kuptimin terminologjik, do të thotë që besimtarët ndaj të cilëve drejtohet mesazhi i Allahut të Lartësuar, ta pasojnë me sinqeritet Hz. Pejgamberin, sallallahu alejhi ve sellem dhe ta duan atë më shumë se jetën dhe fëmijët e tyre. Me fjalë të tjera, ata duhet të bëjnë një jetë me në qendër Kuranin Fisnik.

Allahu Teala në suren el-Bakara, nga aspekti i besimit, i përshkruan profilet e njerëzve, si besimtarë, politeistë, hipokritë dhe mohues.

Krahas kësaj, shprehet se janë të shumtë ata që mposhten nga vetja e tyre, që mashtrohen nga veseset e djallit dhe që janë në një shkujdesje e humbje totale. Ndërsa si paralel me këtë, janë të paktë ata besimtarë që i kryejnë adhurimet me koshiençë, në kuptimin e vërtetë të saj.

Udhëzimi:

Është dhuratë e veçantë e Allahut të Madhëruar. Kështu që duhet t'ia dimë vlerën!

Të pendohemi si Hazreti Ademi, alejhisselam, për mëkatet, të durojmë në sëmundje si Hazreti Ejubi, alejhisselam, të bëhemi si Hazreti Musai, alejhisselam, duke rezistuar fuqishëm kundrejt Faraonëve dhe si krenaria e gjithësisë, Hazreti Muhamedi, sallallahu alejhi ve sellem, që të arrijmë të themi: "Ne nuk heqim dorë nga Islami, edhe nëse na e japin hënën në një dorë dhe diellin në dorën tjetër.

Në surel el-Fatiha, e cila është si përmbledhje e Kuranit Fisnik, Allahu Teala na urdhëron që në pesë namazet e ditës, të kërkojmë më shumë se dyzet herë udhëzim.

Faktikisht, jeta e njeriut ose ka Kuranin në qendër, ose ka veten dhe materializmin. Në të vërtetë, Allahu i Madhëruar asnjëherë nuk e ka lënë njeriun vetëm, por duke i dërguar libra dhe profetë, i ka dhënë kuptim jetës së tij dhe ata që dëshirojnë të pasojnë rrugën e drejtë, i ka urdhëruar t'i binden dhe ta ndjekin në mënyrë kategorike të Dërguarit e Allahut, sallallahu alejhi ve sellem.

I Dërguari i Allahut, Muhamedi, sallallahu alejhi ve



sellem, shkante shtëpi më shtëpi në Mekë dhe u jep-te mesazhet: "Kulu la ilahe illallah muhlisan, dehalet xhenneh" dhe "kulu la ilahe illallah, tuflihu". "Thoni se nuk ka zot tjetër përveç Allahut, që të shpëtoni dhe të arrini lumturinë e të dy botëve" dhe "Besoni me sinqeritet se nuk ka zot tjetër përveç Allahut, që të shpëtoni dhe të shpërbleheni me xhenet."

Në periudhën e parë, numri i besimtarëve ishte shumë i paktë. Për këtë arsye, i Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, bënte llogaritë dhe brengosej kundrejt popullit që nuk besonte dhe adhuronte idhujt... Allahu i Madhëruar, në ajetin e mëposhtëm, e ngushëlloi të Dërguarin e tij, alejhissalatu vesselam dhe të gjithë ata që përipiqen për të predikuar fenë e qartë Islame dhe theksoi se synimi i detyrës e shërbimit, nuk është udhëzimi absolut, por predikimi i sinqertë. Në ajetin fisnik, thuhet:

"Vërtet, ti (Muhamed) nuk mund të udhëzosh kë të duash, por është Allahu Ai që udhëzon kë të dëshirojë. Ai i njeh më mirë ata që janë të udhëzuar." (Sureja el-Kasas 28/56.)

Allahu i Madhëruar urdhëron që thirrja për në fenë e tij të bëhet me fjalë të urta dhe me këshilla të sinqerta.

Bilali me zë të djegur, i cili e perceptoi këtë gjendje në shkallën e njohjes së Zotit, pa dashje e humbiste veten në namazet hafile dhe thoshte: "Allah" Azze ve Xhelle. Për shkak se Hz. Umeri, radijallahu anh, shqetësohej për këtë, e mori Bilalin dhe e çoi te i Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, për t'u ankuar. Hz. Umeri (r.a.), tha:

- O i Dërguari i Allahut! Unë ankoem për Bilalin. I Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, i cili na ka mësuar që një të dhënë të mos e marrim vetëm nga një anë, i tha: "Le ta dëgjojmë edhe Bilalin!" Bilali, radijallahu anh, u përgjigj:

- O i Dërguari i Allahut! Allahu ju ka dërguar ju si pejgamber të fundit. Ju ka bërë Habibullah (të dashurin e Allahut). Ju ka dhënë të gjitha mirësitë, por dikë e ka lanë larg prej jush! Ju dëshironit shumë që të parët e Mekës, si Ebu Xhehli dhe Xhaxhai yt Ebu Lehebi të bëheshin myslimanë. Por ja që ishte zemra e Bilalit ajo që u ndriçua me dritën e Islamit. Ai e pranoi shpalljen. Ata që janë të parët sot, nesër do të ngelin në rreshtat më të fundit të neglighencës... Sado që ta falënderoj Allahun, përsëri është pak.

Tufejl bin Amri, i cili ishte kryetari poet i fisit Devs, erdhi në Mekë për Haxh. Hz. Muhamedin (s.a.s.), ia treguan aq të keq, saqë vendosi pambuk në veshë. Një çast, erdhi ballë për ballë me të Dërguarin e Allahut, sallallahu alejhi ve sellem. Kur e pa Pejgamberin (s.a.s.), në vetvete tha: "Kjo fytyrë nuk mund të gënjejë. Pastërtia e zemrës i reflektoka në fytyrë." Pastaj iu lut të Dërguarit të Allahut, alejhisselam, t'ia tregonte edhe atij ato që i thoshte popullit. Pejgamberi (s.a.s.), i tregoi rëndësinë e njësimit të Zotit. Tufejli, radijallahu anh, i dha besën dhe u udhëzua.

I Nderuari i gjithësisë shkoi në Taif për të predikuar dritën e Islamit në vende të ndryshme. Edhe atje bëri këtë thirrje: "O njerëz! Thoni "la ilahe illallah", që të shpëtoni!"

I Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, i cili



*“Unë jam peygamberi i gjallërimit, jo i shkatërrimit.
I mëshirës dhe jo i ndëshkimit.”*

nuk u mirëprit dhe nuk gjeti interesim nga populli, u gjuajt me gurë sikur të mos mjaftonte keqtrajtimi dhe mosinteresimi i tyre... Zejd b. Harithe përpiqej ta mbronte të Dërguarin e Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, nga të gjitha anët dhe bërtiste, duke thënë: “Më qëlloni mua, jo atë!” Por gurët që hidheshin, bashkë me Zejdin, i binin edhe Hz. Peygamberit (s.a.s.). Trupin e tij të bekuar e lanë të mbytur në gjak.

Xhebraili, alejhisselam, erdhi dhe tha:

“O Muhamed! Banorët e Taifit i kaluan kufijtë. Ndëshkimi i gjuajtjes me gurë ndaj një peygamberi, është shumë i rëndë. Nëse më lejon, ua hedh këta dy male sipër dhe të harrohet në histori ky qytet i shkujdesur.” I Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, iu përgjigj:

“Unë jam peygamberi i gjallërimit, jo i shkatërrimit. I mëshirës dhe jo i ndëshkimit.” Pastaj i kërkoi falje Allahut të madhëruar për banorët e Taifit. Në ato momente, një rob që quhej Addas, u solli rrush të Dërguarit të Allahut (s.a.s.) dhe Zejdit. Addasi u ndikua shumë kundrejt Peygamberit, sallallahu alejhi ve sellem, që hante rrush me besmele. Ai ndjeu interesim për Islamin, besoi dhe e shtoi dijen.

Domethënë, për të predikuar fenë, nuk ka nevojë të jesh poet apo ligjërues! Allahu e bën popullin të ndikohet kundrejt sinqeritetit.

Por le të përmendim edhe Thaleben dhe le të marrim mësim nga historitë e jetës së tij:

Thalebe i kërkoi të Dërguarit të Allahut, sallallahu

alejhi ve sellem, që t'i lutej Zotit për shtimin e pasurisë së tij. I Dërguari i Allahut (s.a.s.), i tha: *“Kjo peshë është e rëndë dhe nuk mund ta përballosh. Kështu që hiq dorë!”* Por Thalebe e përsëriti disa herë kërkesën e tij. Atëherë, i Dërguari i Allahut, alejhissalatu vesselam, u lut dhe Allahu i Madhëruar i dha pasuri Thalebes.

Thalebe, që falte pesë vaktet e namazit në xhami, menjëherë filloi të vinte vetëm për xhuma. Pastaj ra në një gjendje që e la edhe atë. Kur zbritën ajetet e zekatit dhe kur i shkuan mbledhësit e zekatit nga ana e Peygamberit, ai u shpreh se dashuria e tij për këtë botë e kishte kaluar ndjenjën e fesë, duke thënë: “A dëshironi të më grabisni pasurinë?” Në këtë mënyrë, e shkatërroi ahiretin e tij.

Lum për tre grupe njerëzish që e shijojnë besimin:

1. Ai që e do Allahun dhe të Dërguarin e tij (s.a.s.) më shumë se çdo gjë.
2. Ai që do dhe urren vetëm për hir të Allahut Teala.
3. Ai që frikësohet dhe shqetësohet nga kthimi në kufër sikur po hidhet në zjarr, pasi të ketë besuar.

Allahu i Madhëruar mos na lëntë në dorë të vetes sonë derisa t'i mbyllim sytë. Mos na lëntë në errësirën e injorancës, ndërkohë që na ka udhëzuar dhe fatin tonë e formoftë sipas kënaqësisë së tij. Na bëftë ne dhe gratë tona prej të devotshmëve dhe fëmijët tanë prej të bindurve. Umetit të Muhamedit, sallallahu alejhi ve sellem, i dhëntë urtësi dhe vizion!

Energjia e harmonisë

Nuredin Jëlldëz

Nëse dalin përfundime të ndryshme nga gjuha dhe dora, nga syri dhe këmba, të cilat kontrollohen nga i njëjti tru, kjo është joharmonia. Pamundësia për të argumentuar me duar atë që thotë me gojë, ashtu sikurse thotë edhe Kurani, "të flasësh atë që nuk e bën vetë", është shkak i pohimeve të pasuksesshme. Energjia e besimtarit buron nga kompaktësia e duar-këmbëve me gjuhën. Në momentin kur ka ndryshim mes dorës, këmbës dhe gjuhës, nuk krijohet energji. Besimtari shtypet nën fjalë, nuk mund të gjykojë me atë që ka në dorë. Është kusht harmonia mes organeve. Edhe energjia që do të dalë përmes besimit tonë, prodhohet nga kjo kompaktësi.

Besimtari që e bën gjuhën të flasë për atë që i ka bërë dora, ka përkrahjen hyjnore. Në fakt, besimtari është në përputhje me tërësinë. Njeriu që dërgon të njëjtët sinjale nga truri te dora, gjuha, këmba, syri dhe veshi, është njeri mbi të cilin mund të vërehet imani.

Qëllimet dhe praktikat harmonike mes gjuhës, dorës dhe organeve të tjera, janë ura që e shpien njeriun besimtar në xhami me identitetin e shtëpisë së tij. Ato e shpien nga shtëpia në xhami dhe nga xhamia në

punë. Besimtari i përqendrimit në ibadet (khushu), nuk pritet me ndonjë identitet tjetër në shtëpi nga ai që shfaq në xhami. Identiteti i tij në xhami është në harmoni me identitetin e tij në shtëpi. Durimi që shfaq në xhami, është po ai durim që shfaq edhe në shtëpi. Referenca që do të merret në xhami nga imami lidhur me atë, është si referenca që do të merret nga fëmijët e tij, lidhur me të. Nëse shokët e të njëjtit rresht kur fal namaz, e njohin si një njeri të mëshirshëm dhe të butë, fëmijët dhe bashkëshortja e tij nuk mund ta shikojnë si një njeri të pamëshirshëm.

Ky besimtar është me të njëjtin identitet edhe në tregti; fjala që shpreh me gojë, është rrjedhim i asaj që ka bërë dora e tij.

Edhe kur ecën, ecën me logjikën e asaj çfarë shpreh. Edhe kur ulet dhe ngrihet, mund të vërehet identiteti i tij që ecën mbi shinat që ka vendosur gjuha e tij.

Në jetën e një besimtari ka harmoni. Kjo harmoni është burim i begatisë. Për arsye se kalon një jetë të begatë, atij i mjafton pak pasuri. Jeton me një qasje mbi problemet, nuk mbytet brenda problemeve. Nuk

mbytet, sepse, nëse shfaq shqetësime ndërkohë që gjuha e tij gjithnjë flet për durimin dhe shpresën, atëherë kjo është joharmoni. Kurse ai, përmes harmonisë së vet, ka faktuar identitetin e tij.

Harmonia tek njeriu besimtar, është një karakter që mund të vërehet dukshëm tek personaliteti i qëndrueshëm dhe i pandryshueshëm nga stina në stinë. Ashtu sikur e njohin një besimtar gjatë muajit të Ramazanit, me të njëjtin karakter shfaqet edhe pas muajit të Ramazanit. Nuk bëhet fjalë për manifestim të ndonjë personaliteti të ndryshëm nga ai që është brenda muajit të Ramazanit. Qëndron në këmbë me identitetin e tij të qëndrueshëm.

Është harmonik edhe me kohën. Nuk e harxhon kot jetën, si qenia më e vyer, nën rrezet e diellit. Nuk mund të bjerë në inkoherencë, duke folur në njërën anë për jetën vdekatare dhe në anën tjetër të bëjë jetë sikur të jetë e përhershme. Harmonia e tij në këtë pikë, është energji për veten e vet. Natën e kalon me plot begati, po ashtu edhe ditën e kalon me plot begati. Gjen kohë edhe për namaz edhe për të punuar.

Edhe në xhiadin e tij mund të vërehet harmonia. Ai ndodhet në vendin ku duhet xhihadi. Po ashtu edhe në vendin kur duhet bamirësia (infak) gjendet...

Sëmundja nuk e privon nga harmonia e tij.

Në fjalorin e tij nuk ekziston lodhja dhe mërzia.

Vera/dimri nuk është për të. Ai është njeriu i të gjitha kohëve, njeriu i të gjitha kushteve.

Zemrën me mendjen i ka në harmoni të plotë. Shpirt-

in dhe trupin i ka në harmoni, po ashtu. Shpresat dhe punën i ka në harmoni. Mes shokëve dhe pritshmërive ka harmoni. Ka një harmoni mes statusit ku gjendet dhe objektivit ku synon të arrijë.

Nuk mund të ketë kontrast ajo çfarë ka në duar, me atë që del nga goja. Mund të ketë një kontrast të përkohshëm, por e rregullon pa kaluar shumë. E rregullon marrëdhënien që ka buruar nga kontrasti.

Sahabët, miqtë e Zotit, hynë në qytetet që nuk e njihnin gjuhën e tyre. Ata e zgjidhën këtë gjë përmes kësaj harmonie, duke hyrë si njerëz të imanit. Për arsye se nuk panë kundërthënie tek ata, njerëzit i kuptuan çfarë kërkonin, megjithëse nuk e njihnin gjuhën e tyre. Gjendja e tyre u bë gjuhë për ta. Madje edhe ato që nuk i flisnin ishin të dëgjueshme. Ecjet e tyre kishin një kuptim, heshtja e tyre kishte një zë.

Harmonia mes mendjes dhe organeve të lidhura me mendjen, i bëri ata të pëlqehen nga qiejt. Për shkak të pëlqimit që morën nga qiejt, u bënë të dashur edhe në sipërfaqen e dheut. Mjafton një herë të bëhesh i pëlqyer që të hapen rrugët. Atëherë në punë lind qetësia, në shtëpi begatia, në sy mprehtësia, në mendje perceptimi, në zemër nuri.

Ai njeri, rrugëtimin e ka drejt Zotit. Ajo çfarë mbron ai, është e drejta. Ajo çfarë flet, është e vërteta.

Ai është besimtar. Si rezultat i imanit të tij, ai qëndron drejt, krenar. Harmonia mes dorës dhe gjuhës së tij, është aq madhështore sa bashkimi i qiejve me tokën, madhështore sa qenia e tij.



Edison Çeraj

PARADOKSI I ATEIZMIT

Borxhi i ateistëve

Le ta nisim me disa pyetje, duke u dhënë edhe përgjigje, pasi besojmë se ka vetëm një përgjigje të mundshme e të përbashkët për to. Kë mohojnë ateistët? Zotin. Mosekzistencën/mospraninë/mungesën e kujt synojnë të provojnë ateistët? Atë të Zotit. Ndaj kujt rebelohen ateistët? Ndaj Zotit. Në adresë të kujt shkon i gjithë qëndrimin i tyre mospranues? Në adresë të Zotit. Domethënë, ateistët janë të tillë falë Zotit; dhe për rrjedhojë ata duhet t'i shprehin mirënjohjeje Atij.

De facto, jeta e ateistit nuk është një jetë pa Zot, sepse ai angazhohet vazhdimisht për të provuar ateizmin e tij, dhe këtë e bën duke mohuar Zotin; duke mos i shpëtuar kështu "kurthit" që e bën atë të kthehet në një dëshmi të Zotit në tokë e ndër njerëz. A nuk është një dëshmi *sui generis* rasti kur një ateist merr përsipër të shkruajë një libër, në të cilën rreh të argumentojë se nuk ka Zot!?

Ka raste, kur në mungesë të besimitarit të denjë që të flet për Zotin, rëndësinë e çështjes dhe kujtesën për Zotin e nxit ndonjë ateist.

Ndodh që dëshmia më e madhe për një gjë/çështje të jetë fshehur pikërisht aty ku besohet e mendohet se është krejt e kundërta.

Shkaku ose shkaqet e ateizmit

Shkoj me bindje se ateizmi është një sëmundje metafizike (ose një çrregullim metafizik përbrenda qenies), ilaçin e së cilës, për fatin "e keq" të ateistëve, e ka vetëm Zoti.

Njeriu mund ta ndërtojë raportin me Zotin vetëm për-

mes tri mënyrave: përmes monoteizmit, politeizmit ose ateizmit. Po të marrim politeizmin, mund të themi se ai nuk ka gjasa të shfaqet, nëse më para nuk është monoteizmi. Edhe te popujt më paganë është fare e lehtë të gjenden gjurmë monoteizmi, ku, pak a shumë, vihet re se një ndër zotat është më i rëndësishmi, nga i cili varen zotat e tjerë; të cilit i rezervohet konsiderata dhe vendi më i lartë e kështu me radhë. Pra, kjo do të thotë se në kryeherë ai popull (ashtu sikundërse të gjithë popujt) ka qenë monoteist, pra ka besuar dhe adhuruar Zotin një të vetëm. Me kalimin e kohës, një apo disa njerëz kanë devijuar nga ky besim dhe nga ky adhurim duke i bashkëngjitur Zotit, zota' të tjerë, gjersa është shndërruar i gjithë populli në politeistë. Nuk mund të ketë shumë zota pa qenë së pari Zoti, sepse duhet si model, ose si origjinali, nga i cili rrjedhin të tjerë në formë "kopjeje" ose "kopjimi".

E njëjta gjë vlen edhe për ateizmin, gjë që e prekëm në hyrje. Që të ketë ateizëm ose ateistë, më përpara duhet të jetë Zoti, në mënyrë që të mohohet ose të mos pranohet, dhe ja ku lindi ateizmi.

Një ndër shkaqet e ateizmit pasiv ose të rënies në harresë të Zotit², janë (disa nga) përfaqësuesit e besimit, ose

1. Të ashtuquajtur.

2. Një gjendje kjo që është fort herë më komplekse dhe më problematike se ateizmi. Ateisti, sidoqoftë është në kërkim dhe është i vetëdijshëm për qëndrimin e tij; ndërsa ai që ka rënë pre e harresës, as nuk është në kërkim dhe as nuk është i vetëdijshëm se çfarë ndodh me të. Kjo është gjendja që ka kapulluar pjesën më të madhe të njerëzve sot, gjendja e cila të shtyn të mendosh se kemi të bëjmë me një ateizëm më të rëndë se ateizmi i djeshëm që perëndoi në Perëndim, pikërisht aty ku lindi.

besimtarët, që me padijen ose sjelljet e tyre bëhen shkak për të kundërtën e asaj që kanë për mision.

Qasja filozofike, ose në parim

Filozofikisht folur, *ateizëm* do të thotë mohim i ekzistencës së Zotit apo i ndonjë mundësie (dhe jo thjesht i një mundësie racionale) të të njohurit të Zotit (ateizmi teorik). Te ata që pohojnë këtë ateizëm teorik, ai mund të jetë tolerant (dhe madje edhe thëllësisht i interesuar), nëse nuk ka qëllime misionare; ai është *militant*, kur e konsideron veten si një doktrinë që duhet propaganduar për lumturinë e njerëzimit dhe lufton të gjitha fetë, duke i quajtur ato lajthitje të dëmshme. Ne flasim për ateizmin praktik (indiferentizmin) të një forme jete, në të cilën pranimi teorik i ekzistencës së Zotit nuk ka pasoja të perceptueshme. Për të vendosur saktësisht se çfarë përbën ateizëm, kjo varet pikërisht nga fakti se cili konceptim i Zotit supozohet. Të gjitha sistemet e materializmit dhe monizmit materialist janë pa dyshim ateiste (atomistët e hershëm grekë, cinikët pas-sokratikë, epikurianizmi, filozofë të caktuar të Rilindjes si Campanella, natyralizmi i Iluminizmit francez (Volter-i, Holbach-u, Lamartine), pozitivizmi dhe monizmi gjerman i shekullit të 19-të (Vogt, Büchner, Moleschott, Haeckel), hegelianizmi i majtë (Foerbach-u, Marx-i), socializmi popullor i shekullit të 19-të, materializmi dialektik dhe bolshevizmi, ateizmi militant i nxitur nga shteti (i lëvizjes së pafe në vendet komuniste), pozitivizmi i shprehur qartë, sensualizmi dhe pragmatizmi, të gjitha format e filozofisë për të cilat ateizmi është postulat; që do të thotë, teori si ato (që rrjedhin nga Nietzsche) të Camus-ë ose ekzistencializmi i Zh. P. Sartre-t, apo etika e N. Hartmann-it, të cilat rreken konkretisht të vërtetojnë se Zoti nuk ka gjasa të ekzistojë apo nuk duhet të ekzistojë. Nëse çdo formë panteizmi (sidomos në idealizmin gjerman) duhet të klasifikohet si ateizëm, kjo varet nga fakti se sa larg shkon ajo në jo thjesht të identifikuarit e njeriut dhe të botës me absoluten.³

Politeizmi do të duhet të karakterizohet si ateizëm deri në masën që ai e bën të vështirë apo, në një rast ekstrem, të pamundur që akti i fesë së vërtetë të drejtohet kah terreni absolut i botës. (Anasjelltas, politeizmi i antikitetit e persekutoi si ateist monoteizmin e disa filozofëve dhe atë të Krishterimit, për shkak se refuzonte perënditë e Shtetit; dhe sërish Etërit e Kishës u përpoqën të pikasin një ateizëm të fshehur pas herezive.) Në perspektivën e historisë së ideve, ateizmi si sistem filozofik është

3. Rahner, K. (2012) *Ateizmi*, shkëputur nga *Enciklopedia e teologjisë*. Përkth. Arjol Guni. Tiranë: www.erasmusi.org.

shfaqur gjithnjë në momentet e krizës dhe tranzicionit nga një epokë intelektuale, kulturore dhe shoqërore në tjetrën. Kjo, se ai është një fenomen krize, projektimi i një pyetjeje të maskuar si një përgjigje, jo përgjigja e një epoke që ka arritur siguri të pathyeshme. Në secilin tranzicion drejt një epoke të re të përvojës së njeriut me vetveten, duket se kapërcehet njëfarë përvoje e veçantë e kufizimit të tij; kjo errëson pranimin nga njeriu të karakterit të tij rrenjësisht të fundëm dhe prodhon përshtypjen se nuk ka vend për një realitet vërtet të fundëm dhe absolut. Më tutje, kuptimi i ri i problemeve të parashtruara nga format e përfaqësimit dhe i termave që dikur mendoheshin të përshtatshëm për të shprehur njohjen e Zotit, tani sugjeron se të flasësh për Zotin, do të ishte sikur të zbatoheshin koncepte të tilla ndaj një objekti jo-ekzistues. Apo së paku, jepet përshtypja se asnjë pohim kuptimplotë nuk mund të bëhet në lidhje me të.⁴

Në thelb, njeriu nuk mund të bëjë asnjë pohim apo mohim në lidhje me Qenien e Zotit; sepse pohimet apo mohimet më kuptimplota që mund të bëhen, janë ato që Zoti ka bërë për Vetën, por edhe ato që ka bërë Profeti për të, duke qenë se ai ishte i dërguari i Zotit. Pikërisht mbi këto dy themele, duhet të përvijohet meditimi dhe përsiatja e njeriut për Zotin.

Që ateizmi teorik është i mundur, kjo tregohet nga përvoja ekzistuese në historinë e fesë dhe të filozofisë. Se si duhet interpretuar teologjikisht ky fakt, kjo është një çështje më vete. Madje dhe nga pikëpamja krejtësisht filozofike, ateizmi është jo thjesht një nga dallimet e shumta të opinionit mes njerëzve lidhur me ekzistencën apo provueshmërinë e ndonjë qenieje të veçantë. Sepse, nëse ateizmi vërtet e kupton vetveten dhe e rrok atë se çfarë nënkuptohet me Zot, ai mohon se e gjithë çështja e të qenit dhe e subjektit personal si të tillë, i cili po e shtron këtë çështje, mund të ngrihet ndonjëherë. Por një çështje e tillë ngrihet rishmi si kusht pikërisht i mohimit të saj. Rrjedhimisht, ateizmi e ndrydh veten deri në atë masë, sa që ai e kupton natyrën e vet. Megjithatë, ai është i mundur, sepse njeriu është një qenie, e cila, duke e keqkuptuar natyrën e saj dhe nëpërmjet gabimit të saj të vërtetë, mund të bjerë në kontradiktë me vetveten,⁵ duke rënë kështu në një stad fort problematik për njerëzoren e tij, të cilën duhet ta ruajë nga cenimi gjatë këtij udhëtimi e jo të rreket të

4. Po aty.

5. Po aty.

gjejë një kuptim të ri për veten; sepse *de facto*, kjo të çon drejt qëndrimit *njeriu nuk lind, por bëhet*.

Nihilizmi, një ateizëm me pahir

Nihilizmi bashkëkohor është shfaqur dhe është përvijuar si një formë religjioni në mbretërinë e qytetërimit. Nihilizmi nuk është mohim i Zotit, por protestë se përse nuk ka Zot, ose – si te Beckett-i – protestë përse nuk ka njeri, përse njeriu s'është i mundur, përse nuk është i realizueshëm në kushtet e ekzistencës? Gjithnjë, nëse ai nuk është flakur në këto kushte, por është vendosur dhe çdo gjë e vendosur del që ka një qëllim për të përmbushur; ndërkohë që gjëja e flakur e ka përmbushur/përfunduar qëllimin.

Ndërkaq, ky qëndrim implikon, jo përfytyrimin shkencor, por atë religjioz të njeriut dhe të botës. Njeriu sipas shkencës, është i mundshëm dhe i realizueshëm, por këtu dhe tani. Porse, "çdo gjë përfundimtare nuk është njerëzore". Fjala e njohur e Sartre-t, se "njeriu është synim i kotë", është religjioze edhe për nga kumbimi edhe për nga kuptimi, sepse ajo shpreh një qëndrim i cili shkaktohet nga shpërfytyrimi i frymës religjioze, e cila përbën një paprani, një hiç kërcënues, dhe si i tillë, ky konstatim trason mundimshëm në një truall religjioz *par excellence*.

Për materializmin nuk ka synime dhe as kotësi – nuk ka kotësi, meqë s'ka synime. Duke e flakur qëllimin si një kuptim më të lartë të fjalës, materializmi u lirua nga rreziku i absurdit dhe i kotësisë. Bota dhe njeriu në të kanë cak praktik, kanë funksion, qoftë ky edhe zoologjik. Përfundimi se njeriu është pasion i kotë, përfshin vetëdijen se njeriu dhe bota s'janë të një rrafshi, sepse njeriu është vendosur në botë, ka ardhur me bujtë e më pas i duhet të vazhdojë udhëtimin.

Me një qëndrim të tillë, të njëjtë radikal ndaj botës, ka zanafilluar çdo religjion. Kotësia e Sartre-t ose absurdi i Camus-ë, manifestojnë kërkimin e qëllimit e të kuptimit, kërkim i cili, ndryshe nga religjioni, përfundon pa sukses. Ky kërkim është religjioz, sepse është flakje e qëllimit tokësor të jetës njerëzore, flakje e funksionit. Çdo kërkim i Zotit është religjion. Nga ana tjetër, jo çdo kërkim është zbulim.

Nihilizmi është zhgënjim, jo për shkak të botës dhe të rendit, por sepse në gjithësi nuk ka Zot. Çdo gjë është e kotë dhe absurde, nëse njeriu vdes përgjithmonë.

Filozofia e absurdit, tekstualisht, nuk bën fjalë për religjionin, por e shpreh në formë eksplicite bindjen se njeriu dhe bota nuk u bënë përmbi kushte të njëjta. Kjo filozofi, shpërfaq atë formë ankthi, që në të gjitha etapat, për-

jashtë përfundimin e mbramë, është religjioz.

Njeriu, qoftë për nihilizmin qoftë për religjionin, është i huaj në këtë botë. Për nihilistët, është i huaj, sepse është i pashpresë, ndërsa për religjionin, sepse bart shpresën e shpëtimit.

Mendimet e Camus-ë mund të merren si mendime të një besimtari të zhgënjyer. Le të citojmë diçka prej reflektimeve të tij në këtë kontekst: "Në një botë në të cilën zhduket sakaq iluzioni dhe dritat, njeriu ndihet si i huaj. Ky është dëbim pa dalje, duke qenë se aty nuk ruhen kujtimet e vatrës së humbur, as shpresat se më në fund do të arrihet në ndonjë tokë të premtuar." Diku tjetër: "Sikur të isha një dru ndër drurë... kjo jetë do të kishte kuptim, ose më mirë, kjo çështje nuk do të shtrohej, meqë unë do përbëja pjesën e kësaj bote. Do të isha kjo botë, të cilës tani i kundërvihem me të gjithë vetëdijen time." "Çdo gjë është e lejuar, meqë Zoti nuk ekziston dhe meqë njeriu vdes."

Arsyetimi i fundit, nuk ka të bëjë fare me ateizmin sipërfaqësor dhe të bindur të mendimtarëve racionalistë. Përkundrazi, ky arsyetim është më shumë një kujë e heshtur e një shpirti të drobitur duke kërkuar Zotin, pa mundur ta gjejë. Kemi të bëjmë me një ateizëm që shkaktohet nga dëshpërimi.

Rreth çështjes së lirisë morale, ekzistencializmi ka të njëjtin qëndrim si religjioni. Simone de Bouvoire shkruan: "Në fillim njeriu s'është asgjë. Ai ka në dorë të bëhet i mirë ose i keq, në varësi të faktit se a e pranon lirinë apo jo. Liria i parashtron në mënyrë absolute qëllimet e veta dhe s'ka asnjë forcë të jashtme, qoftë kjo edhe vdekja, që të jetë në gjendje të shkatërrojë atë që ajo ka themeluar... Nëse loja e panisur s'është e humbur, as e fituar, atëherë është e nevojshme të luftohet e të rrezikohet çast pas çasti." (*L'existentialisme et la Sagesse des Nations*⁶)

Edhe dyzimi i qenies që teorizon Sartre (*être en soi* dhe *être pour soi*⁷), është një mohim i qartë i materializmit. Vetëm emërtimet janë të reja, ndërsa thelbi është i kryehershëm dhe mund të identifikohet krejt lehtë.

Kur kritikohet qytetërimi, nuk synohet mohimi dhe përjashtimi i tij; edhe sikur të donim, një gjë e tillë është e pamundur. Ajo që duhet bërë dhe mund të bëhet, është rrënimi i mitit të tij.

Si përfundim, le të themi se Zoti është kudo, edhe në fjalinë mohuese të ateistit. Problemi është se ne nuk e dimë ku është e ku po shkon njeriu!

6. Ekzistencializmi dhe urtësia e popujve

7. Qenie më vete dhe qenie për vete



DELIKATESA E TË DËRGUARIT TË ALLAHUT

Prof. dr. Esad Xhoshan

Transmetohet se bashkëshortja e nderuar e të Dërguarit të Allahut, sallallahu alejhi ve sellem dhe nëna e besimtarëve, Hz. Aishe (r.anha.), ka thënë:

“Unë nuk kam parë njeri që t’i ngjajë më shumë të Dërguarit të Allahut (s.a.s.), se sa vajza e tij Hz. Fatimeja, kerremallahu vexhheha, nga aspekti i urtësisë, sjelljeve të dashura dhe faljes së namazit me qetësi.

Kur Hz. Fatimeja shkante te i Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, i Dërguari i Allahut ngrihej në këmbë, e kapte për dore, e puthte në ballë dhe e ulte në vendin që po qëndronte vetë.

Po ashtu, kur i Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, shkante te vajza e tij, Hz. Fatimeja, edhe ajo ngrihej në këmbë, e kapte për dore, e puthte në fytyrë dhe e ulte në vendin që po qëndronte vetë.”¹

Në këtë transmetim shtrohet përpara syve tanë me gjithë ndriçimin dhe përsosmërinë vlera e veçantë dhe interesimi madhështor që shfaqte i Dërguari i Allahut (s.a.s.), ndaj fëmijëve të tij, si një monument çiltërsie, si një kulm i hijeshisë dhe si një rrezatim etik. Njeriu e ka të pamundur të mos influencohet dhe të mos emocionohet kundrejt kësaj skene dashurie, respekti dhe mëshire të pakrahasueshme!

Mendoni, i Dërguari i Allahut të madhëruar, robi më i dashur i Allahut, lideri që e admirojnë njerëzit, një njeri që edhe sundimtari i qëndron besnik, zotëria i të parëve dhe i atyre që do të vijnë, peygamberi fisnik i njerëzve dhe

xhindëve, edhe pse nuk kishte asnjë lloj obligimi, ngrihej në këmbë me modesti për një të vogël që, faktikisht, ajo ishte e detyruar ta respektonte, e gëzonte duke ia kapur dorën me dashuri, i puthte ballin dhe e ulte në vendin ku qëndronte vetë, që ta nderonte sa më mirë...

Më e rëndësishmja është se kjo sjellje fisnike shfaqet në një mjedis në të cilin jetonin njerëz larg civilizimit, që turpëroheshin prej fëmijëve të tyre vajza, që e pranonin si të palogjikshme dashurinë ndaj fëmijëve, puthjen dhe ledhatimin e tyre, madje njerëz barbarë, të ashpër dhe zemërgurë, që nuk u trembej syri për t’i varrosur në tokë fëmijët vajza të shkreta e të pafajshme.

Ja madhështia e suksesit të Islamit! Ja personaliteti dhe fisnikëria e lartë e të Dërguarit të Allahut, sallallahu alejhi ve sellem.

Salatet dhe selamet qofshin për ty, o njeriu më i ndershëm, më i moralshëm, më i sjellshëm dhe më fisniku! Ti je ai që e mbrojte gruan, e cila poshtërohej nëpër shekuj, i dhe pjesë asaj dhe i këshillove burrat të sillen mirë me të. Ti je ai që ua ke mësuar popujve të drejtat e saj shumë kohë para periudhave moderne.

Shënime:

1. Për transmetimin e Hz. Aishes, shik. Buhari, el-Edebu’l-Mufred, fq. 337, Hadithi nr: 971; Ebu Davud, Edeb, 144, Hadithi nr: 5217; Tirmidhi, Menakib, 61, Hadithi nr: 3872; Nesai, es-Sunenu’l-Kubra, V, 96, Hadithi nr: 3369; Ibn Hibban, XV, 403, Hadithi nr: 6953.



Ç'është Islami? -2-

Nexhat Ibrahim

Cilat janë pesë shtyllat e besimit islam?

Islami përbëhet prej pesë shtyllave boshte në jetën e myslimanit. Ato pesë shtylla janë: 1. Shehadeti (Dëshmia se nuk ka hyjni tjetër pos Allahut Një dhe i Vetëm dhe dëshmia se Muhamedi është rob dhe i dërguar i Tij); 2. Namazi (salati); 3. Sawmi (agjërimi); 4. Zekati dhe; 5. Haxhi (pelegrinazhi) në Mekë për atë që është në mundësi.

1. Shehadeti (Dëshmia se nuk ka hyjni tjetër pos Allahut Një dhe i Vetëm dhe dëshmia se Muhamedi është rob dhe i dërguar i Tij)

Kjo maksimë e besimit quhet *kelime-i-shehadet*, përkatësisht maksima e shehadetit, formula të cilën myslimanët e shqiptojnë për të dëshmuar përkatësinë e tyre fetare. Në gjuhën arabe kjo maksimë është: La ilahe il-All-llah – Muhammedun Resul'ull-llah, që në përkthim të lirë do të thotë: Nuk ka zot tjetër pos Allahut dhe Muhamedi është i dërguar i Allahut.

2. Namazi / Salati

Namazi është kushti i dytë i Islamit dhe është emërtim nga gjuha persishte për *salatin*, apo për *faljen*, si e quajmë ndryshe. Namazet janë të shumta, por pesë janë kryesore dhe kryhen brenda ditës. Nëpërmjet namazit njeriu sendërtion lidhjen ndërmjet vetvetes (njeriut) dhe Krijuesit. Në Islam nuk ka kler, ndaj namazi shërben për këtë qëllim, të ndërmjetësit ndërmjet Krijuesit dhe njeriut. Namazi përbëhet prej lëvizjeve trupore dhe shqiptimit të disa fragmenteve nga Kurani dhe disa lutjeve të tjera. Duke u kryer në disa periudha ditore, namazi vë një ritëm jetësor që do të ndikojë në tërë jetën tonë.

Namazi është më mirë të falet në xhami, por nuk ka të keqe nëse falemi kudo; në punëtori, arë, mal, shtëpi.

3. Zekati

Islami mëson se çdo gjë i përket Allahut, kurse ne jemi shfrytëzues të saj për një kohë të caktuar. Edhe paraja që e kemi në duart tona, është vetëm një amanet nga Zoti, për menaxhimin e së cilës duhet dhënë llogari. Institucioni fetar që merret me këtë çështje, quhet **Zekat**, që gjuhësisht do të thotë pastrim dhe zmadhim. Pasuria jonë pastrohet, duke e ndarë një pjesë të saj për nevojat e myslimanëve të nevojshëm. Pasuria jonë rritet, sepse ajo që ka ngelur është e jona. Çdo mysliman, për pasurinë që ka ngelur e tillë për një vit kalendarik, i nënshtohet përqindjes prej 2.5 % për arkën shtetërore (bejt'ul-mal), në rastin ku nuk ka shtet mysliman, kjo pasuri tubohet në arkën e bashkësive islame, kurse shpenzohet në kategoritë kuranore që janë cekur në ajetin e njohur **Innem'es-sadekatu lil-fukarai.....** Deri sa zekati është sadaka e detyrueshme, sadakaja e lirë është vullnetare dhe kryesisht jepet në fshehtësi. Për njerëzit që nuk kanë pasuri materiale, sadaka jepet edhe në forma të tjera. Muhamedi (a.s.), me një rast ka thënë:

"Edhe komunikimi me fytyrë të buzëqeshur është sadaka."

Shkalla më e ulët e sadakasë, sipas Muhamedit (a.s.), është përmbajtja nga punët e shëmtuara.

4. Agjërimi /Sawmi

Çdo vit, në muajin e nëntë të kalendarit mysliman është muaji i Ramazanit, muaji i agjërit për myslimanët. Koha e fillimit të agjërit fillon nga agimi e deri në perëndim të diellit apo prej para sabahut e deri në aksham. Kjo nënkupton që besimtari përmbahet nga ushqimi dhe pijet, marrëdhëniet intime etj., nga syfyri e deri në iftar. Përrjashtim nga agjërimi bëjnë të sëmurët, të paaftët, udhëtarët, shtatzënat, lehonat e raste të ngjashme, por këto ditë do t'i kompensojnë më vonë, kur të eliminohet shkaku i mosagjërit.

Fëmijët fillojnë të agjërojnë nga mosha e pubertetit, kurse nuk ka limit në moshën e pleqërisë: pra pleqtë agjërojnë varësisht nga fuqia e tyre fizike... edhe pse dobitë fizike, sociale e humane janë të shumta, agjërimi megjithatë, është ibadet për pastrim shpirtëror, ngritje dhe transformim shpirtëror e moral.

5. Haxhi (Pelegrinazhi)

Kryerja e haxhit në Mekë është obligim për çdo mysliman të shëndoshë dhe për atë që ka kushte materiale. Rituale të haxhit rrjedhin nga Ibrahim (a.s.), i cili së bashku me Ismailin e (ri)ndërtuan godinën e Qabesë. Tavafi, ecja ndërmjet Safa dhe Merve, qëndrimi në Arefat dhe të tjera kanë simbolikën e tyre dhe na ecin nëpër horizontet e historisë. Fjala vjen, ecja ndërmjet kodrave Safa dhe Merve simbolizon bredhjet e Haxheres për ushqim dhe siguri, Aferati simbolizon tubimin në Botën Përtej, hedhja e gurëve simbolizon luftën e brendshme kundër djallit, siç bëri Ibrahim (a.s.) dhe Ismaili (a.s.), etj.

Haxhi bie në muajin e 12-të të kalendarit hënor mysliman, kështu që paraqet një lëvizje në vete dhe bie gjatë të gjithë muajve kalendarikë, kështu që besimtarët sfidohen jo vetëm gjatë një sezoni, por gjatë tërë vitit. Veshja e haxhinjve është e thjeshtë dhe simbolikisht paraqet barazinë racore, kulturologjike, qytetare etj. Haxhi përfundon me bajram, i cili shënohet në forma të ndryshme: namaz, dhurata, vizita e forma të ngjashme.

Gjatë shekujve haxhi ka qenë ritual i vështirë, si për nga largësia, ashtu edhe për nga siguria e rrugës, ushqimi, ngrohësia dhe probleme të tjera. Mirëpo, viteve të fundit, haxhi është shumë më i lehtë, sepse udhëtimi në të shumtën e rasteve bëhet me aeroplan, vendosja nëpër hotele luksoze, ushqimi i siguar dhe cilësor etj. Miliona haxhinj të vendeve, gjuhëve, ngjyrave dhe nacionaliteteve të ndryshme, çdo vit kryejnë haxhin dhe takohen, njoftohen, këmbëjnë përvoja të ndryshme, që paraqet një rast të rrallë dhe të jashtëzakonshëm.

Si u manifestua përhapja e Islamit në botë?

Përhapja e fesë islame nëpër botë është interpretuar zakonisht njëanshëm, duke thënë se ajo ndodhi si rezultat i dhunës dhe presionit ekonomik. Mirëpo, studimet objektive tregojnë se dhuna ushtarake dhe ajo ekonomike nuk ka qenë rregull dhe strategji myslimane. Kundërshtarët e shpërfillin faktin se faktori kryesor gjendet në thjeshtësinë e mësimin islam, në besimin në një të vetmin Zot, i cili i vetmi meriton adhurim. Islami gjithashtu, arsyen e ngre në krye të kriterëve, duke e bërë mësimin detyrim parësor.

Duke ndjekur parimet e shëndosha, për një kohë të shkurtër, në vendin islam kultura dhe qytetërimi mysliman arriti nivele të larta në të gjitha pikëpamjet: besimorë, morale, kulturore, qytetëruese. Islami integroi të arriturat nga lindja dhe perëndimi, u dha frymë të re, hov të ri dhe përparimet qenë evidente kudo: në mjekësi, matematikë, fizikë, astronomi, gjeografi, hartografi, arkitekturë, art, letërsi, histori dhe shumë dituri të tjera. Evropa përfitoi pa masë nga depërtimi mysliman në truallin e saj. Ajo përfitoi algjebren, numrat arabë, sidomos zeron, pastaj astrolabi, kartat naviguese etj.

A është Islami fe jotolerante?

Islami është fe tolerante, madje edhe mbi këtë, sepse besimtarët hebraikë dhe kristianë i pranon si trashëgimtarë të fesë së Musait (a.s.) dhe Isait (a.s.). Islami është tolerant ndaj besimit të tyre, ndaj ritualeve të tyre dhe faltoreve të tyre. Ai i nderon dhe ndihmon, edhe pse as hebraizmi as kristianizmi (historik) nuk e pranojnë Islamit të barabartë me ta, duke e mohuar Muhamedin (a.s.) dhe Kuranin.

Kurani dhe Hadithi i kushtojnë rëndësi të jashtëzakonshme bashkëjetesës me të tjerët. Gjithashtu edhe hadithet e bëjnë



këtë. Të lexohet Hutbeja e Lamtumirës e Muhamedit (a.s.), do të mjaftonte të kuptohej thelbi i Islamit lidhur me këtë dhe shumë çështje të tjera.

Kurani thotë: **“Allahu nuk ju ndalon të shprehni mirësinë dhe të jeni të drejtë ndaj atyre, të cilët nuk luftojnë kundër jush për shkak të fesë (suaj) dhe që nuk ju dëbojnë juve prej shtëpive tuaja. Me të vërtetë, Perëndia i do të drejtit.”** (El-Mumtehane, 8)

Një ndër synimet e ligjit islam është që pakicat fetare në shtetin islam të gjallërojnë. Për këtë arsye, faltoret judaistekristiane në shtetin islam janë të shumta në çdo kohë gjatë historisë. Prandaj, s’është për t’u habitur kur në kryeqendrat myslimane, si Bagdadi, Kajro, Damasku dhe qytete të tjera janë përplot me kisha apo sinagoga. Kjo ka ndodhur edhe në qytetet tona si në Prizren, Prishtinë, Shkup, Shkodër e të tjera, ku edhe përkundër sundimit disashekullor osman objektet fetare jomyslimane vetëm sa janë shtuar e jo zvogëluar. Shembulli i Omerit (r.a.), në fillim dhe të Sulltan Mehmetit II Fatihut, janë vetëm dy nga shembujt e ndritshëm.

Ç’thotë Islami për luftën?

Islami nuk e pranon luftën si mjet të zakonshëm, por vetëm si mjet të jashtëzakonshëm, për vetëmbrojtje, për mbrojtjen e besimit dhe për mbrojtjen e pragut të shtëpisë. Rregullat e luftës janë tejet rigorozë, ku kursehen civilët, fëmijët, pleqtë, burimet e ujit, frytet bujqësore, drunjtë, kafshët etj.

Islami e luftën të keqen nga kushdo qoftë dhe ngado qoftë. Allahu nuk e do padrejtësinë, ndaj edhe e lejon vetëmbrojtjen:

“Luftoni në rrugën e Zotit, kundër atyre që luftojnë kundër jush, por mos e tejkaloni kufirin! Sepse Allahu nuk i do ata që e kalojnë kufirin.” (El-Bekare, 190).

“Nëse ata tregojnë prirje, për paqe, trego edhe ti prirje për të dhe mbështetu te Perëndia! Se Ai, me të vërtetë, i dëgjon të gjitha dhe di çdo gjë.” (El-Enfal, 61).

Vendi i luftës në Islam është dytësor, duke iu nënshtruar rregullave rigorozë të Kuranit dhe Hadithit. Shkelja e rregullave konsiderohet mëkat i rëndë.

Përveç fjalës *luftë* (harb) kemi edhe fjalën *xhihad*, e cila ndër të tjera ka edhe kuptimin e luftës, por ky kuptim është dytësor. Qëllimi kryesor i fjalës *xhihad* është ripërtëritja, transformimi shpirtëror i njeriut kundrejt të ligave. Ky kuptim buron prej fjalëve të Muhamedit (a.s.), kur kthehej nga një luftë, me ç’rast tha: **“Po kthehemi nga xhihadi i vogël (lufta) në xhihadin e madh (edukimi i vazhdueshëm).”** Prandaj, janë tendencioze pohimet e të tjerëve, kur thonë se Islami është fe xhihadiste, sipas tyre agresive, vrasëse etj.

Ç’mendojnë myslimanët për Jezuin?

Njëri prej pejgamberëve më kontravers në historinë pejgamberike është Isai (a.s.), të cilin kristianët e quajnë Jezu. Myslmanët kanë një respekt të jashtëzakonshëm për të, prandaj edhe me rastin e përmendjes së emrit të tij, ia shtojnë atributin *alejhisselam*, që do të thotë “paqja qoftë mbi të”.

Myslmanët refuzojnë bindjen judaiste se nëna e Isait (a.s.), ishte e pandershme, kurse Isai mashtrues dhe fëmijë i jash-tëligjshëm. Myslmanët refuzojnë edhe bindjen kristiane se Isai është i biri i Zotit, i cili u shfaq në tokë që t’ia falë njerëzisë mëkatit e bërë nga Adami dhe Eva. Myslmanët besojnë se ai është njëri prej të dërguarve të Zotit, besojnë se nëna e

tij, Merjemja është e ndershme dhe bashkë me të birin e saj janë njerëz të thjeshtë, e që Isain (a.s.), Zoti e ka angazhuar me misionin pejgamberik të populli i tij, duke vërtetuar pararendësit e tij pejgamberikë dhe duke paralajmëruar ardhjen e Muhamedit (a.s.).

Ajetet kuranore që flasin për Merjemen dhe Isain (a.s.), janë të shumta, kurse ne po cekim vetëm disa:

“Kur engjëjt i thanë (Merjemes): “O Merjeme! Perëndia të ka zgjedhur ty, të ka pastruar ty, dhe të ka privilegjuar ty mbi të gjitha femrat e botës.” (Ali Imran, 42)

„(Kujtoje) atë kohë kur engjëjt i thanë: “O Merjeme! Perëndia të sihariqon ty me një djalë: emrin do ta ketë Mesih – Isa i biri i Merjemit, do të bëhet i famshëm në këtë botë dhe në tjetrën dhe do të jetë njëri nga të afërmit e Perëndisë. Dhe do të bisedojë (Isai) me njerëzit edhe duke qenë i vogël në djep edhe duke qenë si njeri i rritur, dhe do të jetë nga më të mirët. Merjemi tha: “Zoti im! Qysh do të kem unë fëmijë, kur nuk më ka prekur asnjë mashkull?” – Ja kështu – tha: “Perëndia krijon ç’të dojë Ai. Kur vendos diçka, Ai vetëm thotë për të: Bëhu! – dhe ajo bëhet.” (Ali Imran, 45-47)

“Rasti i Isait te Perëndia, në të vërtetë, është si rasti i Ademit, që e krijoi prej baltës e pastaj tha: “Bëhu!” - dhe ai u bë.” (Ali Imran, 59).

Çfarë është rëndësia e familjes në Islam?

Familja në fenë islame ka një rëndësi të jashtëzakonshme. Ajo ndërtohet në baza të shëndosha dhe është pjesa kryesore e ndërtimit të shoqërisë. Familja e shëndoshë është edhe shoqëria e shëndoshë, kurse shoqëria e shëndoshë është edhe njerëzia e shëndoshë. Raportet janë të ngritura në nivel ibadeti: kemi detyra të ndërsjella për familjarët dhe kurrfarë preteksti nuk na heq nga detyrimin të përkudjesmi për familjarët, për të afërmit etj. Janë të shumta ajetet kuranore dhe hadithet e pejgamberit tonë Muhamedit (a.s.), lidhur me mënyrën e ndërtimit të raporteve ndërfamiljare dhe ndërfinore.

Trajtimi i myslimanës në Islam?

Islami e konsideron femrën individ të veçantë, me të drejta të plota para Krijuesit, por edhe para shoqërisë. E martuar apo jo, femra ka të drejtë të ketë pasuri dhe personalisht të qeverisë me të, pa detyrim që ta bashkëjetojë me pasurinë e burrit. Ka të drejtë shkollimi, pune, lëvizjeje, normalisht në koordinim me burrin. Veshmbathja është diçka e veçantë për femrën myslimane, edhe pse kohët e fundit është bërë temë debati në qarqet antiislame, duke e akuzuar femrën myslimane me shprehje tejet të rënda. Shpeshherë veshmbathja është manifestim i traditave të një popullit të caktuar.

Martesa me shumë gra, është e lejueshme?

Feja islame është shpallur për të gjitha kohët dhe për të gjitha vendet. Gjithashtu, është shpallur për të gjitha gjendjet shpirtërore dhe në pajtim me këtë i miraton nevojat e ndryshme shoqërore. Edhe pse në parim martesa islame është monogamike, megjithatë në raste të jashtëzakonshme lejohet edhe martesa me dy, tre e katër gra. Lidhur me këtë institucion fetar në Islam, në Perëndim ende zhvillohen diskutime të shumta, duke e kritikuar rëndë Islamin. Por Islami e aprovon martesën e dytë në raste të veçanta, të arsyeshme, por e ndalon rreptësisht prostitucionin dhe e trajton si degjenerim besimor e moral të shoqërisë njerëzore, që është

e kundërta e jetës perëndimore: rigorozisht ndiqet martesë monogamike por kurvëria është bërë pjesë normale e partnerëve bashkëshortorë.

Specifikat e martesës / kurorës islame?

Martesa / kurora myslimane nuk është *sakrament*, ibadet, por një kontratë e thjeshtë, e zakonshme, botërore, ndërmjet dy të rinjve (djalit dhe vajzës), të cilët, ndër të tjera, kanë të drejtë të vendosin kushte të caktuara para se të hyjnë në martesë. Ekziston edhe e drejta e divorcit, e ndarjes mes burrit dhe gruas, por ky institucion është lejesë e padëshirueshme, e urreyer nga Krijuesi.

Femra myslimane nuk mund të detyrohet në martesë të padëshirueshme, të imponuar, kurse prindërit me sugjerimet, këshillat dhe përvojën e tyre mund të ndihmojnë për të pasur një martesë të suksesshme.

Në Islam nuk ekziston dallimi mes gjinive as në ibadet, as në arsimim, as në edukatë, as në punë, ndërsa disa veprime në dukje diskriminuese ndaj femrës, bëhen për shkak të natyrës së femrës, kur kursehet nga punët e vrazhda e jodinjitoze.

Si duhet të sillen myslimanët ndaj të moshuarve?

Mësimi islam i trajton të gjithë njerëzit të barabartë. Sidomos të vjetrit i respekton. Kujdesi ndaj të vjetërve/moshuarve bie mbi të rinjtë. Madje, kjo konsiderohet detyrë e domosdoshme dhe e bekuar. Krijuesi ynë, jo vetëm që kërkon kujdes fizik ndaj prindërve, por edhe dashuri dhe mëshirë, duke e kujtuar kohën kur të rinjtë kanë qenë të vegjël e të paaftë. Prindi i vë çdo herë fëmijët në krye të prioritetëve, prandaj edhe fëmijët duhet të sillen po kështu ndaj prindërve. Madje, madje, kujdesi ndaj prindërve është menjëherë pas namazit. Nuk lejohet kurrfarë mërrroljeje, kurrfarë indiference ndaj tyre, pa marrë parasysh gabimet eventuale të tyre.

Allahu (xh.sh.), thotë:

"Zoti ju ka urdhëruar të adhuroni vetëm Atë dhe t'u bëni mirësi prindërve. Nëse njëri prej tyre, ose të dy, arrijnë pleqërinë te ti, mos u thuaj atyre: "Uh!", dhe mos i kundërshtoj ata (me fjalë të këqija), dhe drejtoju atyre me fjalë respekti. Lëshoji para tyre krahet e përluljes prej mëshirës dhe thuaj: "O Zoti im, mëshiroji ata, ashtu siç më kanë edukuar kur isha i vogël!" (El-Isra, 23-24).

Si e kuptojnë vdekjen myslimanët?

Islami i mëson besimtarët e vet se jeta në këtë botë është vetëm rruga përgatitore, rruga e angazhimeve dhe e sfidës drejt jetës së ardhshme. Si jeta paraekzistenciale, ashtu edhe jeta në këtë botë, janë në funksion të jetës tjetër, kurse vdekja është çasti kur obligimet tona në këtë botë përfundojnë. Edhe pse njerëzit herë-herë ndaj vdekjes reagojnë ftohtë, me frikë, tmerr e ankth, Islami mëson se ajo është një proces normal për njeriun dhe çdo gjë që ekziston. Ndaj edhe pas vdekjes, bëhet përgatitja e thjeshtë e xhenazes për t'u va-

rrusur. Vetë ceremonia e varrimit bëhet shpejt dhe pa rituale të shumta. Ai pastrohet, mbështillet thjeshtë me pëlthurë të pastër dhe varroset, pa veshje, pa vendosje të unazave, orës, qaforeve, ... pa shpenzime të mëdha dhe sa më shpejt që është e mundur. Para se të vdesim do të duhej t'i kemi parasysh fjalët e Muhamedit (a.s.), se njeriut të vdekur i ndihmojnë tri gjëra edhe pas vdekjes: *sadakaja që ka ndarë gjatë jetës, dija me të cilën i ka mësuar njerëzit dhe fëmija i edukuar mirë, që lutet për të.*

Si të ushqehemi?

Ushqimi është pjesë e rëndësishme e jetës së myslimanëve. Rëndësi ka jo vetëm lloji, por edhe mënyra e përgatitjes, freskia e të tjera, që në gjuhën moderne e quajmë ushqim ekologjik. Ushqimi në fenë islame është natyror dhe më i thjeshtë se te hebraikët dhe kristianët e hershëm. Thjeshtë, ndalohet derri dhe produktet e tij dhe të gjitha pijet dehëse (duhani, alkooli, drogat). Është detyrë fetare të merret ushqimi i shëndoshë dhe të zhvillohet një mënyrë e shëndoshë e jetës. Pejgamberi i Allahut ka thënë: *"Kërkoni nga Zoti juaj besim të fuqishëm dhe shëndet, sepse pas besimit të fuqishëm nuk ka mirësi më të madhe se shëndeti."*

El-Gazaliu, dijetari i njohur mysliman, e shpjegon si vijon faktin se dija, urtësia, dashuria dhe butësia linden nga ushqimi hallall:

"Ushqimi hallall e pastron zemrën, e ndriçon atë dhe e aftëson për pranimin e njohjes: çdo gjë tjetër është e pavlerë në krahasim me edukimin islam. Çdo gjë që ka njeriu në këtë botë, mund t'ia marrë djalli, t'ia djegë zjarri, t'ia vjedhë vjedhësi, por edukimi i mirë dhe dituria është pasuri e amëshuar, që na mbijeton në këtë botë, e sipas saj përcaktohet fati i përhershëm në botën tjetër."

Porosia e përgjithshme - epilogu

Islami është fe universale pa dallim kohe e hapësire, pa dallim gjuhe e ngjyre, pa dallim shteti e race. Ai u drejtohet të gjithëve dhe i përfshin në gjirin e vet të gjithë. Baza kryesore e tij është besimi në Krijuesin absolut, puna e mirë dhe besimi në Botën tjetër. Mirëpo, jo çdoherë punët kanë shkuar si duhet. Popuj të caktuar gjatë historisë kanë devijuar rrugën. Për disa të tillë kemi njohuri nga Kurani e për disa të tillë kemi prova historike.

Të gjitha ngjarjet historike janë mësim për njerëzit dhe në këtë thërret edhe Kurani duke thënë:

"Në këtë ka ajete (prova) për ata të cilët mendojnë."

Allahu i madhërishtëm thotë:

"Kurse ai që shmanget nga Libri Im, do të ketë jetë të vështirë dhe, Ne në Ditën e Kijametit do ta ringjallim të verbër atë. Ai do të thotë: "O Zoti im, përse më ringjalle të verbër, kur unë, pa dyshim, kam pasur shikimin më parë?" (Allahu) i tha: "Kështu (ke bërë); të kanë ardhur argumentet Tona, e ti i ke harruar ato. Kështu edhe ti sot do të jesh i harruar." (Ta Ha, 124-126).



4 NGJYRAT E VDEKJES

Dyxhane Xhundiogllu

Vdekja për njeriun është një tjetër emër i së panjohurës. I enigmës. Gnosa e lindjes, e kupton vdekjen si takimin e njeriut me të vërtetën. Çasti i takimit me të dashurën. Një natë dasme. Zgjimi nga e vërteta. Një çast kalimi.

Për të vdekurin. Për atë që zgjohet, për atë që takohet.

Ndaj dhe nga dritarja e gnosës, vdekja, nuk duket aspak errësirë. Vdekja është një natë, një natë e ndritshme. Sipas nesh. Një natë që e ndriçonjë yjet. Që e ndriçon shpresa.

Një ëndërr.

Një makth është për të paditurin. E errët. Tërësisht e errët. E errët sa injoranca, sa *gafleti*.

Kurse për ata që kanë shijuar kafshatën e kënaqësisë së Zotit, është vezulluese, shkëlqen. Nganjëherë, e mërzitshme si perëndimi i diellit. Porse, kjo mërzi nuk është mërzia e diellit, por e atyre që e shohin atë; e atyre që e shohin nga pas...

Ndërkohë që gjethet e çinarit bien si shkëmbinj mbi ty një nga një, e dashura të shfaqet mu përballë, të buzëqesh. Edhe i mërzitur qofsh nën atë çinar, a

mund të mos ia kthesh?

I jep leje të ikë, që të vijë sërish, që të mund të vijë.

Me një arsye. Për hir të dhunës së takimit (vullat).

Dhunës dhe dhunimit.

Mos u habitni, natyrisht që edhe vdekja ka ngjyrat e veta.

Sepse ka lloje. Ka shumë vdekje.

Përderisa je rritur pranë meje, tani duhet të pyesësh, o rrugëtar!

Duhet të pyesësh, aq sa je rritur, aq sa i ke rritur. Pyetjet. Zemërimin. Injorancën. Dashurinë. Aq sa je rritur dhe i ke rritur.

Duhet të pyesësh se "cila vdekje?"

Ngjyra të llojllojshme: e bardhë, e kuqe, e gjelbër dhe e zezë.

Katër ngjyrat e vdekjes.

Vdekjen para vdekjes.

Gnosën. Pra jo diturinë, por njohjen.

Mua.

Ndoshta, pastaj ty.

- "Dashuria mes dy të dashuruarve shpjegohet përmes bashkimit të dy ngjyrave që plotësojnë njëra-tjetrën, përmes përzierjes së atyre dy ngjyrave, përmes të kundërtës, përmes vibrimit të fshehtë mes dy toneve të ngjashme.

Vezullimi i mendjes në një ball mund të përshkruhet duke përdorur ton më të hapur mbi sfondin e errët; shpresa me një yll, kurse pasionet e njeriut me perëndimin e diellit."

Van Gogh-u, nën ndikimin e profesorit të tij Delacroix, për të ngjyrosur ndjenjat e veta, përfiton edhe nga bashkimi i të kundërtave, edhe nga të kundërtat e të ngjashmeve...

Një nga tri ngjyrat kryesore e sjell ballë për ballë me përzierjen e dy të tjerave; blunë, të verdhën dhe të kuqen... Për shembull, duke vendosur portokallinë (e kuqja + e verdha) përballë blusë, vjollcën (e kuqja + blu) përballë së verdhës, të gjelbrën (e verdha + blu) përballë së kuqes, arrin në dendësi ngjyrash, njëra më e fortë se tjetra; shprehi ndjenjash të forta dhe të dendësishme...

Van Gogh-u, që kishte treguar se shpresën mund ta shprehësh me një yll dhe pasionin me perëndimin e diellit, si e ka shprehur apo si ka dashur ta shprehte vdekjen ai?

Nuk kam hasur akoma në përgjigje të ndonjë specialisti apo në ndonjë përgjigje speciale. Por, gjithnjë kam besuar se tek vepra e famshme e tij "Ara e grurit dhe sorrat", të cilën e ka bërë në muajin kur u vetëvra, në Auvers-sur-Oise, do të gjenden mjaft

të dhëna për këtë.

Nëse kërkohet, ndoshta edhe aty mund të përballlet me ngjyrën e vdekjes; me ngjyrën e njohur të vdekjes...

Van Gogh-u në këtë vepër, u ka kushtuar vëmendje tri ngjyrave kryesore: të verdhës, të kuqes dhe blusë.

Në përshtatje me teorinë e ngjyrës, krahas tyre shton edhe të gjelbrën; dhe pastaj errësinë e sorrave që ngjiten drejt gjirit të qiellit të errësuar para furtunës... Tamam si e errëta e vdekjes... Pra, e zezë katran...

Jo vetëm të zezën e vdekjes, por edhe vetë qenien drejt vdekjes... Errësirën... Ta panjohurën... Jasën dhe dëshpërimin... Madje edhe fatkeqësinë...

E zeza katran është ngjyra që i përket vdekjes?

A duhet të jetë gjithmonë e zeza ngjyra e vdekjes?

Madje e zezë katran?

Fatkeqësisht, po.

Ne të vdekshmit nuk para e njohim vdekjen. Ndaj dhe e njohim keq.

I ikim.


I ikim me të katra.

Si mund të kuptohet saktësia e urtësisë dhe/apo e fesë? Si mund ta dalloni një fe të vërtetë nga ajo e rrejshme?

Në krye të shekullit të kaluar, një i ditur, duket sikur na ka dhënë një kriter që na ndihmon për t'i dhënë përgjigje kësaj pyetjeje:

- Ai që nuk sillet i thjeshtë para qenies, pra ai që kënohet se njeh çdo enigmë, është gënjeshtari më i madh.

Ndaj, ata që me thjeshtësinë e tyre thonë përballë fshehtësisë së Qenies, "Nuk arrita të të njoh ashtu siç duhet, e dashur", mund t'i njohim ndoshta jo nga



zëri, por nga sjellja.

RRëfyem se nuk arritëm ta njohim, ndaj duhet të vdesim.

Para se të vdesim.

Duhet ta shijojmë vdekjen me të katër ngjyrat e saj.

Dërvishët nakshi, që kanë humbur harenë melamite, duhen kapur për dore, mu ata duhen hedhur së pari në kutitë e ngjyrave.

Për hir të Shah Nakshibendiut.

Për hir të mjeshtrave të mëdhenj që ngjyrosën vdekjen.

Nën çinar.

Filozofinë e të vdekurit para se të vdesim, e kemi trashëgimi nga të parët. Nga njerëzit e urtë. Nga njerëzit e së vërtetës.

Jemi urdhëruar të zgjedhim vdekjen me duart tona, me vullnetin tonë, me dëshirën tonë. Për të arritur që të bëhemi "Hz. Njeriu" dhe për hir të pjekjes nga shkëlqimi i kuptimit, jemi urdhëruar të fshijmë baltën e materies nga pasqyra e shpirtit tonë.

Pastaj harruam. U harruam ngaqë gjithnjë harronim, edhe se harronim. U braktisëm.

Ngaqë nuk ditëm të vdisnim para se të vdisnim. Ngaqë nuk arritëm të vdisnim. Ngaqë nuk arritëm të zgjoheshim. Ngaqë nuk u ngjyrosëm me ngjyrat e vdekjes, madje ngaqë nuk dinim se duhej ngjyrosur.

"Filozofi, do të thotë të zgjedhësh vdekjen" –thotë Sokrati, me tërë heshtjen e tij. Rruga e së vërtetës udhëzon të dashurit e tu: mundshmëria e zgjedhjes së vdekjes.

Studentëve u thotë të vdesin, sa më parë të vdesin,

të vdesin para se të vdesin.

Nuk e braktis aspak thjeshtësinë para Qenies. Vdes.

Si njeri. Si një profet.

Ka dy lloje vdekjesh: një që është jashtë dëshirës: "meut-i tabii" (vdekje natyrore) dhe një që e zgjedhim vetë, ajo që ne dëshirojmë: "meut-i iradi" (vdekje e vullnetshme).

Ky kuptim buron nga enigma e hadithit "Vdisni para se të vdisni"!

Vdisni, por me vullnetin tuaj dhe para se të vdisni biologjikisht. Me dëshirën dhe zgjedhjen tuaj. Ndaj dhe kjo vdekje ka marrë emrin "meut-i ikhtijari" (vdekje e vullnetshme).

Përse e vullnetshme?

Ngaqë "Njerëzit janë në gjumë, kur të vdesin do të zgjohen". Për t'u zgjuar sa më parë nga gjumi i gaflet-it. Nga gjumi i gaflet-it, pra të dukesh sikur jeton...

Lloji i vdekjes, për ngjyrat e së cilës do të flasim, është një vdekje që e preferojmë.

Sepse ka ngjyrat e saj. Ka nivelet e veta.

Fillimisht, "vdekja e kuqe" (meut-i ahmer). Është vdekja e epshit. E dëshirave dhe ambicieve të panevojshme. Praktikave që na janë bërë zakon, afimiteteve që na kanë lindur nga ato çfarë na janë bërë praktikë...

E dyta: "vdekja e bardhë" (meut-i ebjadh). Vdekja e oreksit. E ngopjes, e ushqimit të tepruar...

"Vdekja e bardhë" është një tjetër emër i shijimit të urisë, i kënaqësisë që të jep uria. Të qëndrosh me vetëdije pa ngrënë, pa pirë... liria...

E treta: "vdekja e gjelbër" (meut-i ahdar). Vdekja e rrobës. Largimi nga veshja. Të braktisësh rrobën. Të



gjitha llojet e saj.

Unë jam një dervish i ngratë melami, pse mos ta them?

“Vdekje e gjelbër” është të heqësh rrobat, jo vetëm të trupit, por edhe ato të zemrës. Të zhvishesh nga posti, nga gradat, nga titujt dhe të mbetesh lakuriq para Zotit.

Të mos kesh një emër, që të mund të lexohet as në listën e atyre që do të hyjnë jo në xhehenem, por në xhenet. Është paemërsia. Pafamësia.

A nuk vdesin kështu murgjit e krishterë në manastire? A nuk vegjetojnë eremitët e vërtetë budistë me këto ngjyra të vdekjes në majë të malit?

Natyrisht, tri ngjyrat e vdekjes njihen nga të gjitha *rrugët*. Jetohen. Aq sa u është përcaktuar.

Po e katërta?

Ajo çfarë e dallon traditën e gnosës islame nga të tjerat, është pikërisht kjo ngjyrë. E fshehta e nakshizmit është tek ngjyra e kësaj vdekjeje.

Ngjyra e vdekjes është e zezë, o rrugëtar! E katërta është “vdekja e zezë” (meut-i esved).

Aty nuk ka të shpëtosh, të ndahesh, të ikësh, të mos veprosh. Pra, “vdekja e zezë” nuk është mosaktivitet e as që është ndonjë akt negativ. Përkundrazi, “vdekje e zezë” do të thotë të hysh në mes të njerëzve, të jetosh mes tyre, të angazhohesh me shqetësimet e tyre.

Të angazhohesh me shqetësimet e tjetrit, është një tjetër emër i vrasjes së *nefsit*. Qëndrimi larg nga vetja, nga mburrja e dervishit, nga kënaqësia e vetmisë. Të bëhesh një milingonë brenda turmës. Të shtypesh. Të shkelesh. Në mesin e zhurmës. Për të shërbyer. Edhe pse me *nefs*.

Pra, dalje nga manastiri. Ndarje nga teqja. Të heqësh dorë nga ndenja kokë më kokë me zemrën

tënde.

“Vdekje e zezë” është një tjetër emër i ndarjes nga Hira. Është vdekja e atij që realisht ka vdekur. E atij që ka arritur të vërtetën. Vdekja e individualitetit.

Këto ngjyra të vdekjes, nuk janë ngjyrat e rrugës sime. Edhe komenti i tyre madje është pak në këtë mënyrë. Dije që secilën ngjyrë e kam komentuar sipas egzoteristit. Sipas egzoteristit të saj. Sipas bashkëbiseduesit. Pra, gjendjes së bashkëbiseduesit. Iu shmanga komentimit sipas gjendjes sime. Iu shmangëm.

Kjo do të thotë që fjalën e kam për ata që i përkasin njërës *rrugë* nga *rrugët*. Jo të *dehurve* si unë.

Pa kujtoni Nesimi-n. Kundërshtarin e Halaxhit. Mbreti i atyre që janë fatëkeqësia e vetvetes.

Nëse nuk e kujton atë çastin kur ke pirë pijen e *vahdetit*, ç’mund të të them ty, o rrugëtar! Të paktën, Mikun kujto.

Kjo do të thotë, që duhet të qëndrosh tek egzoterizmi. Duhet të vazhdosh rrugën tënde. Bashkë me të gjithë. Në mes të të gjithëve.

Vdekjen duhet ta kesh nga duart e tua! Sipas teje. Sipas ngjyrës tënde.

Duhet të vdesësh me plot ngjyra, o rrugëtar.

Me kënaqësi.

Ndiqe amanetin tim, çfarëdo që të bësh, njihi me katër ngjyrat e vdekjes, o rrugëtar! Largohu pushtetit. Mirësive të pushtetit. Pasurisë.

Afrohju vdekjes, para se të plakesh. Të dashurës. Origjinës tënde. Para se të vdesësh. I mbuluar nga e zeza. Me ngazëllim.

Mos harro, duhet të vdesësh për të jetuar.

Duhet të jetosh mirë, të vdesësh mirë!





Edukimi me mëshirë

Semih Jollaçan

Allahu Teala, që e ka krijuar njeriun nga asgjëja me mëshirën e tij të pafundme, përsëri, me mëshirën e tij të pafundme nuk e ka lënë në mëshirë të fatit këtë krijesë të paaftë. Njerëzve u ka treguar rrugën e drejtë, e cila është e vetmja që i shpie te lumturia në këtë botë e në ahiret dhe u ka dërguar peygamberë e profetë që t'i udhëzojnë në këtë rrugë, të jenë shembull dhe prijës për ta.

Megjithatë, njeriu sapo doli në ekzistencë, i harroi urdhrat e Krijuesit të lartë, iu drejtua devijimeve nga rruga e drejtë që iu tregua dhe zgjodhi errësirën, në vend të ndriçimit e injorancën, në vend të dijes. Kur njerëzit devijonin nga natyrshmëria e tyre, Krijuesi i madhëruar i shpëtoi ata nga errësira e injorancës dhe nga shtigjet e turbullta, duke u dërguar profetë në mënyrë zinxhirore. Hallka e fundit e këtij zinxhiri ishte Muhamedi, sallallahu alejhi ve sellem, i cili kishte arritur kulmin në mëshirë dhe që fitoi lavdërimin: **“Ne të kemi dërguar ty vetëm si mëshirë për botët.”**

Zemrat që morën edukimin plot mëshirë të të Dërguarit të Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, ndërkohë që jetonin në dallgën e injorancës, u kthyen në Ebu Bekër, i cili është simboli i së vërtetës, në Umer, i cili është emri tjetër i drejtësisë, në Osman, i cili kishte arritur kulmin në edukatë e turp dhe në Ali, i cili ishte dera e dijes.

Edukimi i tij, sallallahu alejhi ve sellem, ishte i formuar plotësisht mbi mëshirën dhe faljen. Aty nuk kishte kurrrë zemërim dhe urrejtje. Libri ynë i lartë, Kurani fisnik, në lidhje me këtë çështje, thotë:

“Në sajë të mëshirës së Allahut, u solle butësisht me ta (o Muhamed). Sikur të ishe i ashpër dhe i vrazhdë, ata do të largoheshin prej teje. Prandaj, falua atyre gabimin dhe kërkoi falje Allahut për ta...” (Al Imran 3/159.)

Një njeri prej bedevinëve, prishi abdestin e vogël në xhaminë e Profetit. Sahabët filluan ta qortonin. I Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, u tha:

“Lëreni burrin të qetë dhe hidhni një kovë ujë te vendi ku prishi abdestin! Ju jeni dërguar për të shfaqur lehtësim dhe jo për të nxjerrë vështirësi.” (Buhari, Vudu 58; Edeb 80.) Ky burrë bedevi, që me kalimin e kohës arriti gradën morale të sahabëve të tjerë, thotë kështu për këtë ngjarje:

“Nëna dhe babai im i qofshin falë. I Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, nuk më qortoi dhe nuk më tha ndonjë fjalë të keqe. Vetëm më këshilloi:

“Abdesi nuk priset në xhami. Këto janë vende për të përkujtuar Allahun dhe për të falur namaz.” (Ibn Maxhe, Taharet, 78.)

I Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, i cili ishte shumë i butë dhe shumë i mëshirshëm kundrejt besimtarëve (et-Teube 128.), për shkak të kësaj mëshire

të pakufishme që kishte, nuk ia përplaste në fytyrë gabimin atij që e bënte, sepse përplasia e gabimit në fytyrë, më shumë e lëndon njeriun se sa e edukon.

Për këtë arsye, i Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, kur dëshironte të rregullonte ndonjë gabim, në vend që të fajësonte atë që e kishte bërë, shprehej në mënyrë indirekte se ajo sjellje ishte e gabuar.

Hazreti Aisheja, radijallahu anha, thotë:

“Kur Pejgamberi, sallallahu alejhi ve sellem, dëgjonte se dikush ka thënë diçka të gabuar dhe të padrejtë për të, nuk thoshte:

- Çfarë ka filani që thotë kështu e ashtu, por: *“Çfarë kanë disa njerëz që thonë kështu e ashtu.”* (Ebu Davud, Edeb, 6.)

I Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, i cili ishte deti i faljes dhe mëshirës, nuk dëshironte që dikush prej besimtarëve të ngelte në gjendje të vështirë.

Një ditë, i Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, po priste kohën e namazit në xhami me disa shokë të tij, që kishin ngrënë së bashku mish deveje. Befas, përhapet një erë shqetësuese ndërmjet tyre. Të gjithë ishin kureshtarë për atë që e bëri këtë gjë të pahijshme. Ai që e bëri këtë, u shqetësua shumë. Rruga e vetme për ta gjetur se kush e kishte bërë, ishte pritja e kohës së namazit, sepse kush do të merrte abdes, ishte ai që e kishte bërë këtë erë të keqe. Hazreti Pejgamberi (s.a.s.), e zgjidhi kështu këtë problem:

“Kush të ketë ngrënë mish deveje, le të marrë abdes!” Ata që gjendeshin aty, thanë: “Të gjithë kemi ngrënë.” Atëherë, Hz. Pejgamberi, sallallahu alejhi ve sellem, tha:

“Atëherë merrni abdes të gjithë!” Në këtë mënyrë, e parandaloi lëndimin e atij që bëri erën e keqe ndër-

mjet shokëve. (Haflimi, er-Rasulu'l-Arabi ve'l-Murabbi, botimi i parë, viti 1981, fq. 160.)

Nganjëherë, njeriu bie në gabim për shkak se nuk gjen rrugëzgjidhje për sjelljen që ka shfaqur. Dora e mëshirës, që i zgjatet njeriut që ka bërë diçka të gabuar, i tregon rrugë më të mira dhe e nxjerr të shkretin nga pusi i gabimit.

Rafi bin Amr, radijallahu anh, e tregon kështu një kujtim nga fëmijëria:

Kur isha i vogël, i gjuaja me gurë hurmat e Ensarëve. Për këtë arsye, më kapën dhe më shpunë te i Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem.

I Dërguari i Allahut (s.a.s.), më pyeti:

-Biri im! Përse u bie me gurë pemëve të hurmave?

Unë i thashë:

- O i Dërguari i Allahut! U rashë me gurë për të ngrënë (sepse isha i uritur).

Krenaria e gjithësisë, sallallahu alejhi ve sellem, më ledhatoi kokën dhe më tha:

- Mos i gjuaj më me gurë! Merr prej atyre që kanë rënë poshtë dhe haji! Pastaj u lut për mua: “O Zot! Ngope atë!” (Ibn Maxhe, Tixharat, 67.)

Së fundi, mund të themi:

Për shkak të edukimit të pashoq e plot mëshirë të të Dërguarit të Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, nga shoqëria që bënte një jetë gjysmë të egër, të ashpër dhe injorante, doli një shoqëri e shekullit të lumturi-së, që do ta ndriçojë dhe udhëzojë gjithë njerëzinë, e cila do të vijë deri në kiamet. Kjo shoqëri e begatë, me frymëzimin dhe begatinë që mori nga Ai (s.a.s.), i gjallëroi zemrat e vyshkura me flladet e pranverës së Islamit, kudo që shkante. Njerëzisë i mësoi përsëri vlerat njerëzore.

Paqja dhe bekimet e Zotit qofshin mbi të Dërguarin e Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, mbi familjen dhe mbi të gjithë shokët e tij.



LËVIZJET TOTALITARE

Nuredin Nazarko

Prirjet totalitariste nuk ishin thjesht simptomë e shek. XX, porse në këtë shekull u kristalizuan në lëvizje me tipare dhe qëllime të qarta. Gjithsesi, nuk ndërmendim që lindjen, zhvillimin dhe institucionalizimin e lëvizjeve totalitariste ta përcaktojmë thjesht dhe vetëm në një kontekst të caktuar të rrethanave historike, edhe pse këto të fundit dëshmojnë shumëçka për shfaqjen, organizimin dhe implementimin e lëvizjeve totalitariste.

Shfaqja në skenën e historisë njerëzore të lëvizjeve totalitariste nuk është e lidhur ngushtësisht dhe vetëm me faktorët materialë.

Lëvizjet totalitariste janë të lidhura ngushtësisht me masat, pasi pa masat ato as që do të ekzistonin. Interesant është fakti që lëvizjet totalitariste mbështeten nga masat që "...formojnë shumicën e atij numri të madh të njerëzve neutralë, politikisht indiferentë, që kurrë nuk hyjnë në ndonjë parti dhe vështirë se shkojnë ndonjëherë tek kutitë e votimit."¹ Por "indiferenca ndaj çështjeve publike, asnjëanësia ndaj problemeve politike, nuk janë në vetvete shkak i mjaftueshëm për lindjen e lëvizjeve totalitare."²

Lëvizjet totalitare, edhe pse të vendosura gjeografikisht në vende të ndryshme dhe në kontekste të ndryshme të rrethanave historike, shpërfaqin tipare të përbashkë-

ta në mënyrën e funksionimit të strukturës së tyre dhe implementimit të saj, përmes ushtrimit të pushtetit mbi masat, pasi pushteti për lëvizjet totalitariste nuk ishte qëllim në vetvete, por instrument për realizimin e një qëllimi madhor.

Fijet e lëvizjeve totalitare në kontekstin historik, janë të lidhura kryekëput me emra konkretë të udhëheqësve të tyre si B. Musolini, A. Hitleri, Lenini, Stalini, emra përmes të cilëve identifikoheshin këto lëvizje. Fillimisht, udhëheqësit e lëvizjeve totalitare pas krijimit të formacioneve politike, pranuan të qenit pjesë e garave elektorale për pushtet. Të qenit pjesë e garës elektorale dhe, për më tepër, të pakonsoliduara si forca potenciale politike, nuk iu dha kënaqësinë e fitimit të pushtetit përmes konkurrencës politike. Udhëheqësit e lëvizjeve totalitare vendosën në veprim mekanizmin e grushtit të shtetit, për marrjen e pushtetit. Në Gjermani Hitleri dështoi për marrjen e pushtetit me grusht shteti dhe u burgos. Gjatë periudhës së burgimit, shkroi veprën e tij "Mein Kampf", ku shpalosi dhe zbuloi idetë e tij për realizimin e rendit të ri botëror. Në Rusi, Lenini e konkretizoi grushtin e shtetit me përmbyshjen e regjimit carist dhe përfshirjen e bolshevikëve në koalicionë partiake me partitë e tjera politike të politikës ruse. Mossuksesi i grushteve të shtetit në marrjen e pushtetit, u dha kohën e duhur për reflektim udhëheqësve të lëvizjeve totalitare, në hartimin e strategjisë që do të përdorej për marrjen e pushtetit.

1. Arendt, H, Origjina e totalitarizmit, faq. 402

2. Po aty: 404-405

Pas dështimit të grushtit të shtetit, u pranua formimi i koalicioneve politike në formimin e kabineteve qeverisëse. Periudha e qëndrimit në koalicion shërbeu në konsolidimin e mëtejshëm të strukturave partiake, që do të shërbenin si bazë themelore për implementimin e sistemit totalitarist.

Në Rusi, Lenini pasi siguroi “24 % si të votive, ashtu edhe të vendeve në Asamble”³, në zgjedhjet e fundnëntorit 1917, u bind se kohëzgjatja e qëndrimit në koalicion do të ishte e stërmundimshme për marrjen e pushtetit. Duke shfrytëzuar debatet dhe mosmarrëveshjet në Asamble, përdori forcat e armatosura për të shpërndarë Asamblenë dhe për të eliminuar format demokratike të qeverisjes në Rusi. Pas këtyre veprimeve të suksesshme për bolshevikët, Lenini përqendroi pushtetin politik në duart e tij dhe njësoi shtetin me partinë, duke vulosur triumfin e revolucionit komunist në Rusi dhe ardhjen në pushtet përmes dhunës, ashtu sikundërse e kishte sanksionuar Marksi në veprat e tij. Në Gjermani, Hitleri ngërtheu një sërë elementësh që i përdori me efikasitet në ngjijtjen drejt pushtetit.

Hitleri përdori Traktatin e Paqes së Versajës, me kushte rënduese për Gjermaninë, nënshkruar pas Luftës së Parë Botërore, për të ngacmuar emocionalitetin dhe psikologjinë e gjermanëve, si nderhumburit, të nëpërkëmburit e Evropës, që duhej të rivendosnin dinjitetin e kombit gjerman në vendin që u takonte. Përdori antisemitizmin, për të goditur fuqinë ekonomike dhe origjinën racore të popullatës me origjinë hebraike, duke i evokuar hebrenjtë si shkaktarë të fatkeqësive që kishin mbërthyer Gjermaninë. Përdori racizmin për të evokuar racën ariane, nordike si racë superiore, që ishte shfaqur si raca më e fortë gjatë seleksionit natyror të evoluimit të racës njerëzore, nën hyqmin e së cilës duhej të ishin të gjitha racat e tjera njerëzore, të etiketuara si të dobëta, inferiore në raport me nordikët darvinianë. Përdori antikomunizmin për të ngërthyer pas vetes të gjitha shtresat sociale të shoqërisë gjermane, që i frikësoheshin rrezikut të një modeli ekonomik të centralizuar, veçanërisht industrialistët dhe sipërmarrësit e fuqishëm. Përdori evokimin e së shkuarës së lavdishme ushtarake, për të përfutur mbështetjen e veteranëve të luftës.



Për të shpalosur idetë e tyre, udhëheqësit totalitarë përdoruan mjeshtërisht oratorinë, duke organizuar mitingje pompoze, duke ligjëruar plot pathos përballë masave, për t’i manipuluar, në mënyrë që masat të **besonin** se ishin pikërisht këta udhëheqës që do t’iu jepnin vendin e merituar në histori kombeve respektive. Nga ana tjetër, strukturat partiake shkaktonin turbullira, prishjen e rendit dhe sigurisë, për të goditur kundërshtarët politikë si të paafte për të zgjidhur problematikat që shqetësonin njerëzit, edhe pse ishin në pushtet. Më tipike kjo situatë u shpërfaq në Itali e Gjermani.

Pyetja që na grish mendimin përkundruall lëvizjeve totalitare është se si arritën këto lëvizje të përfitonin masat e gjera të popullatave në mbështetje të tyre?

Lëvizjet totalitare kanë karakter gjithëpërfshirës, pasi synojnë të shtrihen në mbarë hapësirën gjeografike që mëtojnë të zotërojnë. Në këtë kontekst, përdorojnë teknologjinë, zbulimet e saj, masmediat, për të përçuar nëpërmjet propagandës masive atë çfarë synonin të përçonin, tek çdo individ, madje individ nuk konsiderohet individualitet njerëzor, por pjesë integrale e masës. Lëvizjet totalitare, duke përdoruar gjerësisht propagandën masive të ndërthurur me teknologjinë dhe spektaklin, synonin përfshirje sa më të madhe të njerëzve, për të qenë pjesë e masës. Universaliteti i lëvizjes ishte jashtëzakonisht joshës, pasi çdokujt të harruari, i jepej mundësia e identifikimit me lëvizjen, e shkrirjes me lëvizjen, për ta ndjerë vetveten pjesë organike të lëvizjes, sipas trillit një për të gjithë dhe të gjithë për një.

Lëvizjet totalitariste u shfaqën dhe gjalluan në një mjedis organik tërësisht të përshtatshëm, ku faktorët materialë dhe gjendja shpirtërore e njerëzve, aspak shpresëdhënëse në kushtet ekzistuese, punonin në favor të tyre. Vështirësitë ekonomike që përjetoi Gjermania dhe, për më tepër, goditja morale si shtet humbës që iu nënshtrua kushteve të rënda, të vendosura në Versajë, pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore, goditja nga Depresioni i Madh, ishin elementë pertinentë, në efektshmërinë e premtimeve se nazistët do të rikthenin stabilitetin dhe zhvillimin ekonomik të Gjermanisë. Në Rusi u evokuar vështirësitë dhe prapambetja ekonomike, të trashëguara nga regjimi carist, i fajësuar edhe për dështimin me turp

3. Filo. LI, “Histori e sistemeve politike të qeverisjes”, faq. 204-205

të Rusisë në Luftën e Parë Botërore. Evokimi i negativiteve dhe errësimi i së shkuarës cariste, u shërbeu komunistëve në lançimin e parimeve të Revolucionit Francez, "liri, barazi, vëllazëri", duke i shtuar edhe premtimin për tokë. Ky i fundit ishte tmerrësisht joshës, për një shoqëri jashtëzakonisht rurale sikurse ishte shoqëria ruse. Në Gjermani dhe Itali, ndryshe nga Rusia e kaluara evokohej si e lavdishme. Në thelb, evokimi i së shkuarës shërbente si frymëzim i ndryshimit dhe transformimit të rolit që duhej të luanin shtetet respektive në skenën e historisë botërore.

Paqëndrueshmëria politike dhe mosefektiviteti i qeverive, të koalicioneve qeverisëse, prodhonte pasiguri dhe mosgjydhje të problemeve që lidheshin me rendin, sigurinë, qëndrueshmërinë. Në këto situata të turbullta, të zymta dhe aspak shpresëdhënëse për të ardhmen, duke i shtuar dhe dështimin e përpjekjeve për konsolidim të formave demokratike të qeverisjes, zhgënjimi dhe mosbesimi ndaj aktualitetit politik ishin evidentë. Shfaqja e lëvizjeve totalitare plot grintë dhe energji për ndryshimin e gjendjes, i dha të kuptonte masës së të zhgënjyerve, mosbesuesve dhe apatikëve se drita në fund të tunelit, më në fund ishte një realitet që duhej përthithur në çdo qelizë të tyre. Lëvizjet totalitariste në raport ndaj forcave të tjera politike ishin të avantazuara, sepse asnjëherë më parë nuk ishin konsumuar si alternativa qeverisëse dhe nuk përkonin aspak në mënyrën e organizimit dhe funksionimit me partitë e tjera politike. Në qoftë se partitë e tjera përcaktoheshin përmes konkreteve, këto lëvizje ishin gati-gati magjike, mistike, që vetëm e ardhmja mund t'i zbulonte në lakuriqësinë e të vërtetës së tyre.

Por a ishin tërësisht përcaktues faktorët historikë, materialë në përcaktimin e suksesit të lëvizjeve totalitare në marrjen e pushtetit?

Përtej maksimizimit të shfrytëzimit eficient, të gjendjes së turbullt dhe plot vështirësi në favor të tyre, lëvizjet totalitariste mbartnin një mision, që nuk mund të kufizohej vetëm me zgjidhjen e problemeve politike, ekonomike, sociale etj. Misioni i tyre i drejtohej së ardhmes, për të cilën njeriu as që mund të zbulojë se çfarë në të vërtetë do të ndodhë. Udhëheqësit e lëvizjeve totalitariste propagandonin vazhdimisht se ishin në rrugën e realizimit të një misioni madhor, ngritjen e një rendi të ri botëror, ku do të zhdukeshin negativitetet dhe paqja do të mbretëronte në botë. "Hitleri, që e njihte mirë mentalitetin e atyre që ai vetë organizonte, përshkruante jo vetëm trupat e tij SS, por edhe shtresën e madhe prej së cilës ai i rekrutonte, kur thoshte se ata nuk interesoheshin për "problemet e përditshme", por vetëm për çështjet

ideologjike me rëndësi, për dekada dhe shekuj, kështu që njeriu ... e di se ai po punon për një detyrë të madhe që realizohet një herë në 2000 vjet."⁴ Pragmatizmi utilitarist i masave ka pushuar së funksionuari dhe tanimë me besimin se janë të privilegjuar, ngaqë janë pikërisht ata që do të realizojnë misionin, udhëheqjen e tyre për këtë çështje me rëndësi për dekada dhe shekuj, ia "delegojnë" udhëheqësit të pagabueshëm. Plotësimi i utiliteteve dhe përmbushja e interesave pragmatiste, nuk mund të shërbenin si inspirim për të besuar pa kushte në mesianizmin e lëvizjeve totalitare. Mesianizmi ishte jo vetëm i nevojshëm, por element qëndror i lëvizjeve totalitariste, në manipulimin e masave dhe suksesit të tyre. Pa mesianizmin, totalitarizmi do të ishte tërësisht pragmatist. Përmbushja e misionit mesianik, të shpëtimit dhe çlirimit të racës njerëzore, realizohej vetëm nëse triumfonte nazizmi apo komunizmi. Mesianizmi i lëvizjeve totalitariste, vendosi në qendër realizimin e parajsës **këtu dhe tani**, ndryshe nga besimet fetare për të cilët parajsa fitohet në përtejbotë. Premtimet që ushqenin siguri në realizimin e parajsës këtu dhe tani, përkundruall vështirësive dhe zymtësive, ishin mjaft të rëndësishme për të mbajtur ndezur besimin pa kushte të masave, në vërtetësinë e misionit që duhej realizuar dhe për të legjitimuar çdo nismë dhe veprim, që i shërbente realizimit të misionit. Besimi në vërtetësinë e lëvizjeve totalitariste, nënkuptonte padyshueshmëri dhe bindje të plotë ndaj asaj që premtuhej. Besimi i padyshimtë se një ditë të bukur, këtu dhe tani, do të realizohej parajsa, nxiti sakrifikimin e masave deri në vetmohim, pikërisht vetëm për parajsën tokësore që rezultoi utopi.

Lëvizjet totalitare nuk buruan nga kuturisjet dhe çmenduritë e rastit të njërit apo tjetër udhëheqës. Ato u bazuan në ideologji të mirëpërcaktuara me qëllim të mirëpërcaktuar. Librat, mbi fletët e të cilëve janë rreshtuar fjalët e vërteta të udhëheqësve të pagabueshëm, nuk janë abstraktë, por konkretë, të prekshëm, të shikueshëm dhe burim frymëzimi për masat. Lëvizjet totalitare ishin tërësisht të mbështetura vetëm mbi një ideologji, përjashtuese e çfarëdo alternative. Ideologjia e vetme, naziste apo komuniste, ishte e vetmja rrugë për realizimin e misionit mesianik, të shpëtimit të racës njerëzore. Librat mbi të cilët ngrihej ideologjia e vetme, si fjalë e udhëheqësve të pagabueshëm, ishin tërësisht të vërtetë. Kërkohej që të besohej se këta libra përmbanin të vërtetat e përjetshme, të pandryshueshme dhe të patjetërsueshme, të shprehura nga udhëheqësi dhe të zbuluara për masën nga propaganduesit e zellshëm. Besimi në vërtetësinë e të vërtetave të përjetshme, nuk mund të lejonte artikulimin e kritikës ndaj tyre. Masa duhej të besonte dhe jo

4. Arendt, H, vep. cit: 409

të diskutonte e të kritikonte doktrinën ideore të lëvizjeve totalitariste dhe as që duhej t'i shkonte nëpër mend dyshimi mbi pavërtetësinë e saj, pasi udhëheqësi duhet "të frymëzojë besim tek lëvizja"⁵

Lëvizjet totalitariste identifikoheshin me personalitetin e udhëheqësit. Udhëheqësi zotëronte cilësi të rralla dhe as që mund të barazohej me njerëzit e tjerë. Besohej se ai ishte i pagabueshëm, fjalët e tij ishin çdoherë të vërteta, të pakritikueshme nga masa e paarsye. Ai falte apo dënonte cilindo që dëshironte. Verdikti përfundimtar për të vendosur për të gjitha çështjet, ishte atribut dhe privilegj vetëm i udhëheqësit. Ai ndriçonte masën me hirin e fjalëve të tij, në rrugën e realizimit të misionit mesianik. Ai nuk mund të artikulojë gabime apo të përçojë të pavërteta. Pushteti ishte i përqendruar në duart e tij. Vetëm udhëheqësi mund t'u jepte masave kuptimin e të qenit mbi botë dhe vetëm tek ai vareshin shpresat për sukses. Lëvizjet totalitariste në tërë strukturën e tyre monolite, edhe pse u mbështetën mbi masën me individë të palidhur me njëri – tjetrin në çfarëdolloj aspekti, ishin imitim i përpiktë i strukturës hierarkike të religjionit. Me të drejtë H. Arendt konstaton se "...tërheqja që Rusia Sovjetike ushtronte barabar mbi bashkudhëtarët intelektualë nazistë dhe komunistë, qëndronte tamam në faktin se në Rusi "revolucionari ishte një fe dhe një filozofi, jo thjesht një konflikt që lidhej me anën sociale dhe politike të jetës."⁶

Lëvizjet totalitare nuk ishin religjioze në plot kuptimin e fjalës, por ato panë tek sistemi religjioz modelin më të arrirë, që i ishte zbuluar njeriut në realizimin e misionit të mëkëmbësit mbi tokë. Udhëheqësit e lëvizjeve totalitariste adaptuan hierarkinë e religjionit, duke ia përshtatur interesave të tyre. Në mënyrë që udhëheqësi të kishte dorë të lirë në ushtrimin e pushtetit mbi gjithësa ishin nën pushtetin e tij, duhej larguar Zoti për t'u zëvendësuar nga udhëheqësi. Besimi tek Zoti u zëvendësua me besimin tek udhëheqësi, që frymëzon besimin tek të tjerët. Arendt thotë: "I vetmi grup i supozuar për të besuar ndershmërisht dhe tekstualisht në fjalët e udhëheqësit, janë simpatizantët, besimi i të cilëve rrethon lëvizjen me një atmosferë të ndershmërisë dhe mendjethjeshtësisë


5. Po aty: 489
6. Po aty: 436

dhe ndihmon udhëheqësin të plotësojë detyrën e tij, d.m.th të frymëzojë besim tek lëvizja."⁷ Pa besimin se udhëheqësi ka gjithmonë të drejtë, pa besimin tek ajo çfarë do të realizohej në të ardhmen e panjohur, lëvizjet totalitare nuk do të kishin shkuar përtej të qenit lëvizje politike konkrete, sikurse edhe partitë e tjera politike. Ishte ky besim, që nëpërmjet propagandës masive, vësh-tirësive, zyrtësisë, mungesës së traditave qeverisëse demokratike, që përjetonin shtetet respektive ku u zhvilluan lëvizjet totalitare, arriti të topisë masën, që përtej realitetit t'i besojë trillit të parajsës tokësore. Ishte pikërisht ky besim, për hir të të cilit njerëzit braktisën lirinë e tyre, duke besuar se udhëheqësi, jo vetëm që ka gjithmonë të drejtë, por udhëheqësi e di se çfarë është më mirë për ta, sesa ata për vetveten. Ishte besimi se vendimi final për çfarëdolloj çështjeje, e rëndësishme apo jo, i takon



vetëm udhëheqësit, që i bindi njerëzit se liria e tyre për të vendosur ishte bezdisje, dhe ajo i duhej deleguar udhëheqësit të pagabueshëm. Faza institucionale, e implementimit të lëvizjeve totalitare, pasi u arrit marrja e pushtetit si mjet për realizimin e rendit botëror, provoi se tashmë duheshin vendosur në përdorim mekanizma më konkretë, për të mbajtur të ngërthyer masën me lëvizjen. Mekanizmi themelor ishte policia sekrete, që përmes dhunës, terrorit, eliminimit, goditi dhe eliminoi çdokënd që ndërmendte t'i largohej lëvizjes apo që do të dyshonte në vërtetësinë e premtimeve për parajsën, këtu dhe tani. Faza institucionale ishte thyerje e magjishmërisë dhe misticitetit të lëvizjes dhe prandaj duhej të hynte më fuqishëm në veprim policia sekrete për realizimin e terrorit dhe frikësimit masiv, që masa të mbahej e ngërthyer në vazhdimësi nga frika e eliminimit. Veprimtaria e policive sekrete dhe milionat e viktimave të terrorit dhe frikësimit masiv dëshmuar egërsinë, barbarinë, pamëshirshmërinë, pangopshmërinë për gjak, bishëzimën e njeriut të ri dhe të kultivuar përmes darvinizmit social. Terrori dhe frikësimi masiv dëshmoi se çfarë është i aftë të realizojë njeriu, kur Zoti është zëvendësuar nga vet njeriu që nuk njeht zot më të lartë sesa uni tij, jo vetëm mbi tokë por në gjithë universin.

7. Po aty: 489



Falëndero Zotin!

Neslihan Nur Tyrk

A nuk është kjo humbja jote më e madhe? Ti nuk mund të gjesh kohë, për shkak të ankesave dhe, në këtë mënyrë, nuk mund të falënderosh. Por, nëse do ta falënderoje Zotin, nuk do të kishe kohë për asgjë tjetër. Prandaj, falëndero! Falëndero Allahun Teala që të bëri umet të Muhamedit, sallallahu alejhi ve sellem, i cili, me çdo gjendje të tij, është shembulli më i përkryer për njerëzinë.

Allahu të fali imanin dhe Islamin. Të dha fuqi për ta adhuruar atë dhe mëshirë për të bërë të mira. Ndërsa, përpara disa ditësh ti ankoheste "për shkak se nuk kishe një fëmijë", edhe pse të ka dhënë gjithë ato të mira.

Allahu të formoi ty nga një pikë e vogël. Të bëri të geshësh kur ishe foshnjë. Të bëri të ulesh, të ecësh dhe të rritesh. Krijoi shkaqet për t'u realizuar këto. Prindërit dhe ata që të donin, i stolisi me dhembshuri. Ndërkohë

që ti nuk dije asgjë rreth botës, ajo rrotullohej rreth teje. Ishe fëmijë, u bërë i ri dhe u rrite. Tani ndoshta je i moshuar apo pret të plakesh...

Sa herë që ke parë pasqyrën në çdo periudhë dhe gjendje, ke pasur një fytyrë për të parë. Allahu i Madhëruar të ka dhënë vetullat, sytë, hundën, nofullën, veshët dhe faqet. Ndërkohë që këtë mëngjes duhej ta falënderoje Allahun (xh.xh.), për këto, ti shqetësohesh për një puçërr të vogël që të ka dalë në faqe.

Ai të dha gjuhë. Të mësoi si të shprehësh hallin tënd. Të mori uria. Qave dhe të erdhi qumështi. Qeshe, u kënaqe dhe të erdhi buzëqeshja. Përballë ke pasur gjithmonë një bashkëbisedues. Shumicën e kohës që ke thënë se je vetëm, ke pasur pranë dikë. Ndoshta nuk e ke ndjerë, por edhe kur nuk ke pasur asnjë, ke pasur Allahun. Në fakt, asnjë çast nuk ke qenë vetëm. Të ka mbrojtur, të ka vëzhguar, të ka ushqyer dhe të ka dashur. Edhe për këtë, ka krijuar shkaqe.

Ai të ka vëzhguar edhe në momente kur je mërzitur e ke qarë, kur ke rënë në neglizhencë dhe ke bërë ga-

bime. Të fshehtën tënde nuk ia tregoi askujt, përveç atë që ka qenë në të mirën tënde. Ushqimet që t'i bëri kështu për sofrën tënde, i përtype me dhëmballët që të ka dhënë. Ëmbëlsinë e mirësive e shijove me gjuhën që të ka dhënë. Shpesh herë ke harruar, por bukën e ke zbutur me ndihmën e pështymës që ka krijuar ai.

Të ka dhënë një fyt, me anë të të cilit e gëlltit ushqimin. Të ka dhënë një stomak funksionues dhe e ke tretur atë. Të ka dhënë veshka e zorrë të shëndosha dhe e nxore jashtë trupit tënd tepricën e ushqimit. Ndërkohë që çdo muskul, i cili punon dhe çdo qelizë që shërben duhet të jetë shkak për ta falënderuar Allahun Teala.

Të dha flokët fije fije që ti i kreh dhe u jep formë. Ndërkohë ata të zbukurojnë. Ke një lëkurë të bukur e të mbrojtur nga plagët dhe sëmundjet. Të ka dhënë thonjtë të shëndetshëm. Këmbët e tua mund të ecin. Krahët të zgjaten. Gjunjtë dhe kyçet, mund të përthyhen. Gishtat e kyçet i ke pa mangësi dhe bërrylat nuk të dhembin. Ke një hundë që nuhat dhe një sistem nervor të mrekullueshëm që të mundëson të ndjesh të mirën duke u ndikuar nga e bukura.

Ke gjak që qarkullon. Ke mendje që të përzihet. Ke zemër që punon. Ndërkohë që ke gjithë ato mirësi, të cilat i zotëron pa dhënë asnjë mundim dhe pa paguar asnjë çmim, ti dje, me pretekstin se nuk ke një shtëpi më të madhe, ankoheshe për mysafirët që të erdhën.

Përsëri ti i bërë këto, edhe pse të ka dhënë mbulesë mbrojtëse për sytë, virtyt për fjalët, dashuri dhe vizion. Mbi të gjitha, të është bërë kështu namazi. Ti je njeri, madje mysliman. Allahu ta ka dhënë këtë përsosmëri. Nuk të krijoi mace. Ti nuk e kërkon ushqimin tënd nëpër koshat e plehrave. Shumë njerëz, në të njëjtën kohë, e nxjerrin ushqimin e tyre nga mbeturinat. Zoti nuk të krijoi qen. Ti nuk fle nëpër rrugë. Shumë njerëz, në të njëjtën kohë, flenë nëpër rrugë. Je në pëllëmbë të dorës. Shumë vëllezër të tu, në të njëjtën kohë, shtypen nën këmbët e tiranëve. Allahu ta vendosi emrin "krijesa më fisnike".

Krijuesi të tha "mëkëmbësi im".¹ Veshët të dëgjojnë, sytë të shikojnë dhe zemra të ndjen. Në të njëjtën kohë, shumë të tjerë si ti janë krijuar "bel hum edal".² Ndërkohë që mund t'i shtosh mirësitë duke e falënderuar Allahun Teala, ti ankohesh se nuk ke arritur kulmin dhe shumë gjëra të tjera. Ndërkohë që premtimi i Allahut është i qartë dhe shpërblimi për falënderimin është i bollshëm,³ pak më parë ankoheshe se nuk ke fituar më shumë para.

Në anën tjetër, ka robër që falënderojnë edhe për vështirësitë. Ka robër të devotshëm që falënderojnë edhe për varfërinë. Ata e pranuan të mirë çdo gjë që u vinte nga ai. Në çdo gjë që u ndodhte, panë mirësi. Ata e pranuan për mirësi atë që u jepej dhe atë që nuk u jepej. Falëndero Zotin! Ty nuk të kanë ndodhur fatkeqësi më të mëdha!

Ndërkohë që ti e kthen mirësinë në fatkeqësi me vesveset e tua, ka shumë robër që e kthejnë fatkeqësinë në mirësi duke menduar mirë për Zotin. Ka shumë robër që janë të kënaqur me urinë dhe sëmundjen, ndërkohë që ti nuk kënaqesh me te jngopjen dhe shëndetin...

Mos u habit nesër, nëse vonohet hyrja jote në xhenet. Falënderoje atë që të ka lajmëruar për këto që të mos ndodhë kjo vonesë dhe të bëhesh prej atyre që arrijnë rehatinë e përhershme. Mos u

fut te mosmirënjohësit që janë shumë, por futu te falënderuesit që janë pak.⁴ Nuk e di. Shumë njerëz kanë një sëmundje prej së cilës nuk mund ta ndiejnë të ngrohtë. Për këtë arsye, nuk mund ta kuptojnë edhe nëse u digjet lëkura. Ata e kuptojnë se janë djegur, kur nuhasin erën e mishit të djegur. Ndërkohë që duhet të falënderosh për trupin tënd që ndjen, verën e kaluar ankoheshe se koha ishte shumë e nxehtë.

Po ashtu, Zoti bëri që të flasin edhe gurët, në mënyrë që të kuptosh. Duhet të mendosh apo jo? Guri ametist është një gur i thjeshtë për atë që e shikon nga jashtë, por ai e ka të fshehur brenda fytyrën e tij shumë të

Allahu të formoi ty nga një pikë e vogël. Të bëri të qeshësh kur ishe foshnjë. Të bëri të ulësh, të ecësh dhe të rritesh. Krijoi shkaqet për t'u realizuar këto. Prindërit dhe ata që të donin, i stolisi me dhembshuri. Ndërkohë që ti nuk dije asgjë rreth botës, ajo rrotullohej rreth teje. Ishe fëmijë, u bërë i ri dhe u rrite. Tani ndoshta je i moshuar apo pret të plakësh...

1. (el-Bakara 30.)

2. (el-A'raf 179.)

3. (el-Fatir 30.)

4. (en-Neml 73.)



Falëndero në çdo lloj gjendjeje! Edhe kur të të gurëzojnë, më së paku ka dy shkaqe për të falënderuar: Nëse i ke merituar ata gurë, falëndero që ke njerëz besimtarë që të urrejnë për këtë. Nëse nuk i ke merituar, falëndero për shkak se të pastrojnë dhe të afrojnë te Allahu me anë të atyre torturave që të bëjnë t'i vuash! Mos u mërzit nga të mjaftuarit me atë që ke. Falëndero dhe gëzohu! Gëzohu dhe zbukurohu! Ndërkohë që zbukurohesh, përsëri falëndero! Kuptoje se asnjëherë nuk mund ta falënderosh Zotin aq sa duhet dhe përsëri falëndero!

bukur, për ata që e ndajnë atë me durim dhe besim.

Çdo gjë pret me mallëngjim njeriun që ta perceptojë urtësinë e saj. Duhet të mendosh apo jo? Përse Hizri e shpoi anijen? Përse e ngriti murin? Përse e goditi fëmijën?⁵

Falënderim i vërtetë, nuk është ai falënderim që bëhet vetëm kundrejt mirësive, por ai që bëhet edhe kundrejt vështirësive, sepse vështirësia nganjëherë të mbron nga fatkeqësi më të mëdha dhe nganjëherë të shpie te mirësi të reja më të mëdha. Mbi të gjitha, falënderimi kundrejt Allahut është falënderim për shkakun! Është perceptim i mirësisë që ndodhet në brendësi të ngjarjeve, sido që të jenë në aparençë dhe përkujtim i asaj që ke perceptuar. Ne nuk duhet të kënaqemi vetëm me atë që na jep, por edhe me atë që nuk na jep. Ndërkohë që duhet të veprojmë kështu, më parë ti ankoheshe se poshtë vetullës, ke syrin.

Je në të drejtë dhe mërzitesh se nuk mund ta marrësh të drejtën tënde. Falëndero! A është më mirë sikur të ishe ti i padrejti? Brengosesh se të ka ikur namazi. Falëndero! A do të ishte më mirë sikur të mos e kishe një hall të tillë? Falëndero për plagët dhe dhimbjet, që gjithmonë të bëjnë të thuash: "Aman o Zot!" A do të ishte më mirë sikur të ishe prej neglizhentëve që nuk kanë plagë?

Falëndero për varfërinë tënde! A do të ishte më mirë sikur të ishe prej të pasurve koprracë? Lëre tani, mos e shiko si fëmijë akulloren që e ka dikush në dorë dhe po e lëpin! Falëndero për bukën që ke në dorën tënde! Kujto, sepse po harron shumë shpesh: ka shumë njerëz të përmalluar për atë copë buke që ke. Për hir të Allahut, mendo! Ndërkohë që shumë njerëz nuk kanë shtëpi për t'u ngrohur, dimrin e kaluar, ti ankoheshe për shkak se shtëpia jote nuk ngrohej mirë.

Falëndero në çdo lloj gjendjeje! Edhe kur të të gurëzojnë, më së paku ka dy shkaqe për të falënderuar: Nëse i ke merituar ata gurë, falëndero që ke njerëz besimtarë që të urrejnë për këtë. Nëse nuk i ke merituar, falëndero për shkak se të pastrojnë dhe të afrojnë te Allahu me anë të atyre torturave që të bëjnë t'i vuash! Mos u mërzit nga të mjaftuarit me atë që ke. Falëndero dhe gëzohu! Gëzohu dhe zbukurohu! Ndërkohë që zbukurohesh, përsëri falëndero! Kuptoje se asnjëherë nuk mund ta falënderosh Zotin aq sa duhet dhe përsëri falëndero!

5. (el-Kehf 82.)

VËSHTRIMI I SHERIATIT ISLAM

ndaj padrejtësisë

(Mjetet e lejuara fetare për rezistencë ndaj padrejtësisë)

Dr. Jusuf El-Karadavi

Islami ka ardhur për të sjellë drejtësinë në tokë, ndërsa Kurani e ka konsideruar përhapjen e drejtësisë qëllim të të gjithë mesazheve hyjnore: **“Ne i dërguam të Dërguarit tanë me fakte të qarta, u dhamë librat dhe drejtësinë, që njerëzit të punonë me drejtësi”**. (Hadid: 25.) Drejtësi mbi të cilën u ngritën edhe qiejt e toka, prandaj padrejtësia është kundër të gjitha mesazheve hyjnore. I dërguari ynë, Muhamedi (a.s.), në një hadith kudsij thotë: *“O robërit e mi! Unë ia kam ndaluar padrejtësinë Vetes dhe e kam bërë atë të ndaluar edhe për ju, prandaj mos i bëni padrejtësi njëri-tjetrit”*.

Kurani e konsideron padrejtësinë bazë të të gjitha të këqijave, për këtë Allahu i lartësuar nuk i do zullumqarët dhe nuk e udhëzon popullin zullumqar. Zullumqarët janë banorë të zjarrit **“pastaj ne i shpëtojmë të devotshmit”** prej zjarrit **“dhe i lëmë zullumqarët të qëndrojnë ulur në të”**. (Merjem: 72.) **“Këto janë shtëpitë e tyre të rrënuara, për shkak të zullumit që kanë bërë.”** (Neml: 52.) **“Këto fshatra Ne i shkatërroam në kohën kur ata bënë zullum...”**; (Kehf: 59.) **“Kështu është dënimi i Zotit tënd, kur i dënon fshatrat që janë zullumqare. Dënimi i Tij është i dhimbshëm e i rëndë”**, (Hud: 102.) **“Duke u shkatërruar edhe njeriu i fundit prej atyre që bënë zullum. Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve”**. (En’amë: 45.)

Kurani është i mbushur me ajete, të cilat e ndalojnë myslimanin të bëjë padrejtësi ose t’i ndihmojë zullumqarët për të bërë padrejtësi. **“Mos anoni nga ata, të cilët bëjnë zullum, sepse pastaj do t’ju kapë zjarri”**, madje nuk lejohet në asnjë mënyrë të anojë me zemër

ose të heshtë ndaj padrejtësisë, sepse kjo gjë çon në shkatërrimin e vendit dhe të njerëzve.

Padrejtësia e brendshme është shkak ose i hap rrugën hyrjes dhe mbizotërimit të popujve të tjerë ndaj umetit islam. Në suren Isra Allahu (xh.sh.), tregon se, kur në një vend bëhet padrejtësi, kjo gjë mund të çojë në pushtimin (drejtimin) e vendit nga jashtë, ashtu siç ka ndodhur edhe me beni Israilët. Nga këtu, del edhe rëndësia e rezistencës së padrejtësisë së brendshme, për të mbrojtur vendin nga sundimi dhe drejtimi i tij prej njerëzve të huaj. Në një hadith, transmetohet se Pejgamberi (a.s.), ka thënë: *“Zotëria i dëshmorëve është Hamza, pastaj ai njeri, i cili ngrihet përpara udhëheqësit zullumqar, e urdhëron, nuk ndalet dhe e vret”*. Ndoshta një njeri nis për luftë në rrugën e Zotit, nuk vritet dhe kthehet shëndosh në shtëpinë e tij. Ndërsa, po të ngrihesh ndaj padrejtësisë tirane dhe të bësh rezistencë, nuk do të shpëtosh, prandaj është i madh interesimi i Islamit për bërjen e rezistencës. Në një hadith tjetër thuhet: **“Kur të shikosh umetin tim, të ketë frikë t’i thotë zullumqarit: «Ti je zullumqar», atëherë i është dhënë lamtumira”**. Ata që përhapin kulturën e dorëzimit ndaj zullumqarëve, janë sufistë të devijuar, sepse sufizmi i vërtetë e edukon besimtarin të jetë i fortë dhe të shpenzojë e të sakrifikojë në rrugën e Zotit, prandaj kemi parë shumë prej sufive, të cilët kanë bërë rezistencë të madhe ndaj kolonizatorëve dhe pushtuesve.

Përktheu nga arabishtja dhe përshtati në shqip

Imam Lavdrim Hamja

Wisconsin - USA



KRITERET e dashurisë për hir të ALLAHUT

Doç. dr. Sylejman Derin

Shumëkush e di se dashuria, mëshira dhe toleranca në marrëdhëniet me Allahun dhe me njerëzit e tjerë janë parimet e jetës, të cilave sufitë u kanë dhënë rëndësi parësore. Kjo gjendje përmbledhet me këto fjalë të Junus Emresë, "të duash krijesën për hir të Krijuesit". Nuk duhet harruar se dashuri e vërtetë nuk do të thotë dashuri që nuk njeh kufi. Feja islame është një fe e matur. Kurani i ka përcaktuar qartë kriteret për çdo lloj ndjesie, si për dashurinë, ashtu edhe për urrejtjen. Veçanërisht nakshibendizmi është një nga tarikatet që tregon kujdes maksimal në ruajtjen e kriterëve të Kuranit në të gjitha veprimtaritë e përditshme të jetës.

Nëse është ashtu, duhet që të qëndrohet larg kufrit, në mënyrë që të arrihet tek imani i vërtetë. Shkalla më e ulët e kësaj gjendjeje është distancimi me zemër nga kufri, ndërsa niveli më i lartë i saj është distancimi me zemër dhe me trup nga kufri. Distancimi qëndron në armiqësinë me ata me të cilët është armiqësuar edhe Allahu. Kjo vlen njësoj si në rastin kur distancohesh me zemër, pasi ke frikë nga ndonjë dëm që mund të të bëjnë ata edhe në rastin kur bëhet me zemër dhe me trup, sepse nuk ia ke frikën ndonjë dëmi që mund të të bëjnë. Ky

ajet i Kuranit e mbështet këtë që thamë: "O profet! Lufto kundër qafirëve dhe kundër mynafikëve dhe tregohu i rreptë me ta." (Letra 266)

Dashuria ndaj Allahut dhe ndaj profetit të Tij, profetit Muhamed, do të thotë kujdes në çështjen se kë dashurojmë në të vërtetë. Ashtu siç është shprehur edhe Musa Topbashi, "Unë dua çdokënd, me përjash-tim të personave të cilët dihen haptazi dhe në mënyrë të besueshme se janë armiqtë e fesë." Këto fjalë të tijat përmbledhin në mënyrën më të saktë kriteret e dashurisë. Të ushqesh dashuri ndaj atyre që ushqejnë armiqësi ndaj Allahut dhe profetit Muhamed, madje të miqësohesh me këta lloj personash, nuk mund të jetë kurrë shenja treguese e një myslimani të sinqertë dhe e dashurisë së vërtetë. Sipas imanit, ata që dashurojnë armiqtë e Allahut janë gënjeshtarë kur shprehen se e duan Zotin e Vërtetë. Shembulli më i bukur i kësaj të vërtete është profeti Ibrahim, i cili meritoi të quhej "miku i Allahut", (**Halilullah**). Profeti Ibrahim e pati fituar këtë etiketim pas luftës së hapur që u shpalli idhujve:

"Ju keni shembullin më të bukur tek Ibrahim dhe

ndjekësit e tij. Ata i patën thënë popullit të tyre: Ne jemi larg prej jush dhe prej idhujve tuaj. Ne nuk u njohim ju si të saktë. Jemi armiq të tuaj në besim, deri sa të besoni tek Allahu. (Mumtehine, 4)

Imam Rabani, e konsideronte veprën më të vyer tek Allahu dashurinë për hir të Allahut dhe urrejtjen për hir të Tij. Veçanërisht lufta kundër idhujve, të cilët i nxjerrin njerëzit nga rruga e drejtë përfshihet në këtë klasë: *Sipas meje, asnjë vepër nuk është më e rëndësishme me qëllim fitimin e pëlqimit të Allahut, më shumë sesa oponenca kundër qafirëve. Allahu është armiku i idhujve të rremë, siç janë kufri, qafirët, Lat dhe Uza. Ata që i adhurojnë këta idhuj janë armiq të drejtpërdrejtë të Zotit. Dënimi i këtij faji të shëmtuar do të jetë jeta në xhehenem në përjetësi. Ajeti i Kuranit se "Allahu nuk ua fal kurrë që t'i bëni shirk Atij."* (Nisa, 48.)

tregon se dënimi i qafirrit të pastër do të jetë xhehenemi i përjetshëm. Në qoftë se besimi është sa grimca, megjithëse mund të jetë gjynahqar i madh, ka për ta shpëtuar një ditë nga zjarri i xhehenemit.

Imam Rabani nuk qëndron pa i kritikuar edhe komentet e bëra nga disa personalitete mistike islame, siç është rasti i Ibn Arabiut, të cilët kanë bërë komente që mund të kuptohen si lehtësim i dënimit të xhehenemit që do t'u jepet qafirëve. Nisur nga ajeti se "**Gjithçka është përfshirë brenda Mëshirës së Zotit**" (Araf, 156.) Ibn Arabiu pati pretenduar se xhehenemi nuk do të jetë vendi i përhershëm i qafirëve, se xhehenemi do të shndërrohet në një vend prehjeje dhe qetësie për ta, pasi të kenë vuajtur periudhën e dënimit të caktuar. Këto lloj pohimesh, sipas imam Rabanit, tregojnë se Ibn Arabiu pati gabuar në transmetimin e frymëzimit mistik që pati përjetuar:

"Dënimi që përmendet në hadithin e Profetit, ku thuhet se "Mëshira e Zotit e tejkalon dënimin e Tij", është dënimi i Allahut për besimtarët gjynahqarë dhe nuk është dënimi që u takon idhujtarëve mushrikë. Mëshira e Allahut ndaj jobesimtarëve vlen për këtë botë. Madje edhe mëshira që ata përjetojnë në këtë jetë, në të vërtetë është

mëshirë vetëm nga pamja e jashtme dhe për nga forma. Në fakt, kjo është vetëm një kurth për ta. Këtë të vërtetë e shprehin qartë ajetet e Kuranit." "A pandehin ata se bëjmë ç'është e mundur për ta, duke u dhënë pasuri dhe pasardhës të shumtë. Jo ata nuk e kuptojnë thelbin e çështjes." (Muminun, 55-56.) "Lëri ata që i përgënjeshtrojnë këto fjalë. Ne do t'i afrojmë pak nga pak drejt dënimit të tyre. Ata do të kenë një afat të caktuar. Kurthet e Zotit janë shumë të mprehta." (Kalem, 44-45)

Me këto, fjalë imam Rabani dëshironte të pengonte myslimanët të mëshironin qafirët, në një mënyrë që binte ndesh me tekstet e shenjta të fesë. Mëshira e vërtetë që mund të tregohet ndaj jobesimtarëve është t'i ndihmohet të përfshihen brenda dritës së udhëzimit.

Sipas imanit, ata besimtarë që nuk veprojnë në këtë mënyrë, madje bëhen miq me jobesimtarët, janë duke vënë në rrezik edhe frymën e fundit të jetës së tyre, nëse do të vdesin me iman apo jo: *Njëherë pata vizituar një të sëmure që lëngonte në shtratin e vdekjes dhe, kur u përballa me pamjen e tij, kuptova se ai kishte përjetuar hije të rënda mbi vete. Sado që u përpoqa ta ndihmoja në ato momente që të largohehin retë e errëta prej botës së tij shpirtërore, nuk arrita të bëja gjë. Atëherë e kuptova se ato hije buronin nga një cilësi e fshehtë prej qafiri që kishte ai person brenda në zemrën e tij. Burimi i të këqijave tek ai person, qe miqësia që kishte pasur gjatë jetës së tij me qafirët. Më në fund, e kuptova se ishte e kotë të përpiqesha që t'i zhdukeshin ato hije. Ai do të shpëtonte prej tyre vetëm pasi të kishte vuajtur dënimin e merituar në xhehenem.*

Megjithatë, imam Rabani i kushtonte rëndësi imanit të atyre myslimanëve që kishin marrëdhënie miqësore me qafirët dhe mendonte se duheshin trajtuar si myslimanë. Në këtë mënyrë, nuk pritet shpresa se këta myslimanë që bëjnë këtë gabim kanë për t'u mëshiruar nga Allahu në ahiret. Allahu na mundësoftë që dashuria në zemrat tona të drejtohet ndaj atyre që e meritojnë dashurinë dhe na ruajtë të gjithëve nga dashuria me gjërat e gabuara. Amin!

Të ushqesh dashuri ndaj atyre që ushqejnë armiqësi ndaj Allahut dhe profetit Muhamed, madje të miqësohesh me këta lloj personash, nuk mund të jetë kurrë shenja treguese e një myslimani të sinqertë dhe e dashurisë së vërtetë.





DYQAN KËPUCËSH NË PAZARIN
Ë SHKODRËS - SH. PIGI 1945

FOTOJA E MUJAJIT



Një Ajet

*Me emrin e Allahut,
të Gjithëmëshirshmit, Mëshirplotit!*

“...shpejtoni për tek Allahu...” (edh-dharijat, 50)

Çdo periudhë e historisë së njerëzimit ka pasur kushtet e veta karakteristike, nën të cilat besimtarët gjithmonë janë përballur me një sërë pengesash dhe vështirësish. Por me gjithë vështirësitë, besimtarët i ka karakterizuar gjithmonë këmbëngulja për të adhuruar Allahun dhe përpjekja për një jetë të ndershme dhe fisnike. Vlen të theksohet se edhe sot në ditët tona, ata që adhurojnë ndaj Allahut e kanë bërë filozofinë e jetës së tyre përballen me shumë vështirësi. Orvajtjet për të formuar një identitet islam pasiv dhe për ta zhveshur islamin nga jeta reale, nuk kanë të sosur. Jeta shpirtërore e njerëzve vazhdimisht është cenuar, nëpërkëmbur. Të gjitha zhvillimet negative që ndodhin në botën e jashtme, krejt natyrshëm pasyrohen në botën e brendshme të njeriut me pavendosmëri, dyshime dhe për pasojë, vjen një ftohje nga ana shpirtërore. Në këtë proces ndjenjat e besimit dobësohen, ndjeshmëria ndaj normave morale bie.

Të gjendur përballë degjenerimit të personalitetit dhe humbjes së vlerave shpirtërore, një pjesë e besimtarëve kanë mbajtur një qëndresë të lartë, kurse një pjesë tjetër ka mbajtur një pozicion krejt indiferent. Allahu, me një bujari të papërshkruar, i ka ekspozuar para njeriut të gjitha mirësitë dhe bukuritë, kurse ai, në vend që të falënderojë, përkundrazi, zhytet gjithnjë e më shumë në vorbullën shkatërruese të rebelimit.

Atëherë, cila është rrugëzgjdhja? Përgjigjet mund të jenë të ndryshme, por një gjë është thelbësore, rishikimi i vetes sonë. Dhe, kur e shikojmë çështjen nga ky këndvështrim, gjëja e parë që duhet të bëjmë është të rishikojmë marrëdhëniet tona me Allahun e lartësuar, sepse kjo është thelbësore dhe të gjitha çështjet e tjera janë të varura prej saj. Në marrëdhëniet Allah-njeri, nga konceptet bazë është takvaja (devocioni). Takvaja në një mënyrë shpreh strehimin tek Allahu, sepse nga ana etimologjike fjala ka kuptimin mbrojtje, ruajtje. Kurse mbrojtja dhe ruajtja më e sigurt më e fortë dhe e vetmja e vërtetë, është mbrojtja e Allahut. Takvaja është ushqimi kryesor i shpirtit në rrugën e jetës.

Gjatë rrugës së jetës, me uljet dhe ngritjet e saj, besimtari nuk e shpëton për asnjë moment lidhjen që ka me Krijuesin, vazhdimisht i drejtohet dhe gjen strehim tek Ai. Në këtë mënyrë, nuk e humbet për asnjë çast gjallërinë shpirtërore, por i frymëzuar nga fjala e Allahut, vazhdon me gjithë përpjekjet për t'u ngjitur në majat më të larta. Siç shprehet edhe në ajetin kuranor, strehimi tek Allahu shpreh përpjekjen për ta bërë shpejt e sa më parë, kjo është shumë e arsyeshme, sepse fundja, vendqëndrimi i përhershëm është vetëm pranë Allahut. Ky vendqëndrim duhet të jetë synimi i çdo besimtari. Meqenëse fundi i kësaj rruge të çon tek Allahu edhe pëgatitjet duhet të jenë për të arritur finishin, si mysliman i palëkundur e i vendosur në arritjen e qëllimit kryesor, pa u ndikuar aspak nga zhvillimet negative rreth tij apo nga joshjet e përkohshme të kësaj bote. Siç e shpreh Jusufi (a.s.), në lutjen e tij drejtuar Allahut (xh.sh.): **“O Krijues i qiejve dhe i Tokës, Ti je Mbrojtësi im edhe në këtë botë, edhe në botën tjetër! Bëj që të vdes si mysliman dhe më shoqëro me punëmirët.”**

Një Hadith

*Transmetohet nga Aishja (r.a.)
se Resulullahi (s.a.v.s.) i ka thënë:*



*“Allahu është i kënaqur me atë që, kur kryen një punë,
e kryen në formën më të mirë të mundshme.”*

Nuk ka dyshim se puna që duhet të kryhet, duhet të jetë punë e mirë. Ai që e kryen punën e ngarkuar në formën më të mirë, ka sjellë në vend përgjegjësinë që ka pasur para Allahut dhe para shoqërisë. Një person i tillë është i qetë, sepse nuk ka gënjyer kënd, nuk i ka ushqyer fëmijët me ushqim haram. Kush e kryen punën si duhet, në çfarëdo lloj fushe qoftë, është i fituar, si në këtë botë, ashtu edhe në botën tjetër. Kurse një person që anashkalon punën, nuk e bën siç duhet, së pari ka gënjyer veten.

Zhvillimi dhe përparimi në çdo fushë, vjen duke bërë çdokush punën që i takon. Përparimin dhe zhvillimin e meritojnë vetëm ata që e kryejnë detyrën e dhënë në formën më të mirë. Allahu nuk e jep suksesin sipas përkatësisë fetare, por sipas punës që bëjnë pa dallim, myslimani apo jomyslimani, besimtarët apo jobesimtarët. Suksesi u takon atyre që, pas përpjekjeve dhe marrjes së masave që duhen për të pasur sukses në fushën përkatëse, mbështeten tek Allahut (xh.sh.).

Allahu nuk i jep sukses një populli vetëm se është besimtar, pa bërë përpjekjet e duhura. Gjendja e botës islame sot është një shembull tipik i kësaj të vërtete. Nëse suksesi sot ndodhet në duart e qytetërimit perëndimor, është tregues i dembelizmit dhe i cilësisë së dobët të punëve që bëjmë prej shumë shekujsh. Niveli i zhvillimit të një shoqërie është i ngjashëm me një grup provëzash që komunikojnë me njëra-tjetrën nëpërmjet gypave. Kur hidhet ujë në një provëz, niveli i ujit ngrihet në të gjitha provëzat.

E njëjta dukuri shfaqet edhe te niveli i zhvillimit të një shoqërie. Për shembull, mosfunksionimi siç duhet i institucioneve arsimore në një shoqëri, ndikon negativisht edhe tek individët e veçantë, por edhe tek institucionet e tjera. Për rrjedhojë, funksionimet e institucioneve në një shtet, janë të ndërrarura nga njëri-tjetri, nuk mundet që një pjesë e institucioneve të funksionojë mirë dhe pjesa tjetër keq.

Një person që nuk e kryen punën e ngarkuar siç duhet, nuk është i mirëpritur as nga Krijuesi, as nga shoqëria.

Mësimet që nxjerrim nga hadithi:

1. Besimtari duhet ta kryejë në formën më të mirë punën e dhënë.
2. Prej një pune pa cilësi nuk mund të merret një frut i mrekullueshëm.
3. Allahu kënaqet, kur njeriu e kryen detyrën e dhënë siç duhet.

Nga lulishita e zemrës

Osman Nuri Topbash



Në horizontin e miqësisë me Allahun

NDJESHMËRIA E BESIMIT

Ndjeshmëria e besimtarëve në kuptimin dhe zbatimin e islamit në jetën e tyre, është njësoj si besimi i tyre, shkallë-shkallë. Pra, shfaqet një përshkallëzim, nga besimtarët e thjeshtë, deri tek ata më të devotshmit. Dikush është i ndjeshëm si peshorja e argjendarit, dikush është pa ndjenja dhe i vrazhdë si kandari i druvarit. Për shkak të vlerës, peshorja e argjendarit ndjen edhe miligramin. Ajo është aq e ndjeshme, sa që edhe fryma jonë ndikon në të. Kjo është edhe arsyeja që argjendarët punojnë në vende të mbyllura, ku nuk i kap era. Kurse kandari i druvarit, jo miligramin, por edhe po t'i vëmë disa kile më tepër, nuk ndjen gjë. Kjo, sepse vlera e argjendit apo floririt, nuk mund të krahasohet me vlerën e druve.

Korrektësia dhe ndjeshmëria në respektimin e urdhrave dhe ndalesave hyjnore, shtohet në bazë të afërsisë së robit ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij (a.s.) dhe pakësohet në bazë të largësisë ndaj tyre. Për këtë arsye, dikush e mban fenë në pozitën më të ulët të jetës së tij dhe vepron vetëm sipas fetvave (gjykime fetare). Kurse dikush tjetër, vepron me devotshmëri të lartë dhe me nënshtrim e respekt të thellë, e lidh jetën e vet pas Kuranit dhe Sunetit. Sigurisht që edhe pozita e robit pranë Allahut, vlerësohet sipas shkallës së kësaj devotshmërie.

FETVAJA APO TAKVAJA (DEVOTSHMËRIA)?

Njëherë, Imami Ebu Hanife (Allahu e mëshiroftë), po mendohej të pastronte një njollë shumë të vogël papastërtie në rrobën e tij. Ata që e panë, e pyetën:

“O imam! Sipas fetvasë që keni dhënë, kjo njollë e vogël nuk është një papastërti që e pengon namazin. Pse po mundoheni kaq shumë për ta hequr?”

Imam Ebu Hanife, përgjigjet duke thënë:

“Ajo është fetva, kurse kjo është takva!..”

Robërit e dashur të Allahut Teala, tregohen jashtëzakonisht korrektë dhe të përpiktë në lidhje me besimin e tyre. Kurse njerëzit e shkujdesur, që nuk e kanë fituar ende afërsinë me Allahun, përballë të vërtetave hyjnore, gjendjen e tyre e vlerësojnë në vija të trasha. Ata e krahasojnë veten e tyre me nivelet më të cekëta të shoqërisë. Gjithashtu, ato pak punë të mira që bëjnë, i shohin si të mjaftueshme dhe me këtë e mashtrojnë veten në lidhje me shpëtimin në botën tjetër. Ata e mendojnë Allahun vetëm me cilësitë e Tij si “Rrahman, Rrahim, Settar, Gaffar”, por harrojnë se në të njëjtën kohë, Ai është edhe “Muntakim dhe Kahhar”, cilësi këto që shprehin madhësinë dhe zemërimin e Tij. Ja pra, kjo gjendje nuk ndryshon aspak nga pakujdesia e peshimit të të vërtetave jashtëzakonisht delikate, me kandarin jopreciz të druvarit.

Për këtë arsye, besimtarët e sinqertë, gjithmonë dhe në çdo çështje, e peshojnë veten me vlerat hyjnore. Kriteri i tyre nuk është shoqëria, por Profeti ynë (a.s.), shokët e tij të ndershëm dhe miqtë e Allahut Teala. Ashtu si këta robër të dashur të Allahut, edhe ata shfaqin sakrificat më të mëdha në lidhje me adhurimet, veprat dhe moralin, por këto përpjekje i konsiderojnë një “hiç” dhe zemrat e tyre dridhen nga shqetësimi i frymës së fundit. Prandaj, ata e mbajnë gjithmonë shpresën në mëshirën dhe faljen hyjnore. Pra, besimtarët e përsosur e vlerësojnë gjendjen e tyre me peshoren shumë të ndjeshme të argjendarit, sepse në atë peshore edhe vlera e miligramit është shumë e çmueshme.

LLOGARIA E MADHE E THËRMIJAVE

Në një ajet fisnik urdhërohet:

“Kush ka bërë ndonjë të mirë, qoftë sa një thërmijë, do ta shohë atë e, kush ka bërë ndonjë të keqe, qoftë sa një thërmijë, do ta shohë atë.” (ez-Zelzele, 7-8.)

Domethënë, në peshoren hyjnore do të llogariten edhe thërmijat. Ndërsa thërmijat peshohen me peshoren e ndjeshme të argjendarit dhe jo me kandarin e druvarit.

Ndonjëherë, një thërmijë shumë e vogël, mund të peshojë shumë rëndë në një-rën anë të peshores. Për këtë arsye, asnjë sevab dhe asnjë gjynah nuk duhet konsideruar i vogël dhe i parëndësishëm. Mëshira dhe zemërimi i Allahut, ndonjëherë mund të shfaqen në çështje të mëdha, ndonjëherë në çështje të mesme, por ndonjëherë edhe në çështje që duken të vogla.

Bilal bin Sa’d (r.a.), i cili ishte prej Tabiinëve, ka thënë, duke na tërhequr vërejtjen:

“Mos shiko vogëlsinë e gjynahut, por shiko se kujt i ke ngritur krye dhe ndaj kujt e ke bërë atë gjynah!”

Në syrin e një besimtari, zemra e të cilit është e gjallë me frikë-respektin dhe dashurinë ndaj Allahut, edhe gjynahet më të vogla nuk ndryshojnë nga një copë prushi që digjet. Për këtë arsye, robërit e sinqertë, jo vetëm që nuk zhyten në gjynahe, por ata as që kalojnë nga vendet ku bëhen gjynahet, sepse gjendja e keqe



Ndjeshmëria e besimtarëve të devotshëm në lidhje me ruajtjen nga gjynahet, shihet tek dëshira e tyre e jashtëzakonshme për të fituar sevape. Kjo, sepse ata përpiqen çdo çast të jetës së tyre t’i shtojnë veprat e tyre të mira, me vetëdijen se në ditën e gjykimit njeriu do të ketë nevojë edhe për mirësinë më të vogël.

e atyre vendeve u shkakton mërzë dhe vuajtje shpirtërore. Por zemra e një njeriu të shkujdesur, që është larg Allahut, nuk ndjen as shqetësimin më të vogël edhe po të bëjë gjynahet më të mëdha. Madje, gjynahet i duken si një melodi e këndshme, sepse bota e zemrës së tij e ka humbur të gjithë ndjeshmërinë dhe ndjeshmëria, e cila duhet të vajtojë nga vuajtjet që i shkaktojnë gjynahet, ka degjeneruar plotësisht.

Abdullah ibën Mes’udi (r.a.), e shpjegon kështu ndryshimin në ndjeshmërinë e konceptimit të gjynaheve midis një njeriu të devotshëm dhe një njeriu të shkujdesur:

“Besimtari e sheh gjynahun si një mal nën të cilin është ulur dhe në çdo moment ka

rezik t’i bjerë mbi kokë. Ai rri gjithmonë me frikën se mos ai mal i madh i bie mbi kokë. Kurse i shkujdesuri, e sheh gjynahun si një mizë që po kalon mbi hundën e tij.” (Buhari, Deauat, 4; Muslim, Teube, 3.)

Ndjeshmëria e besimtarëve të devotshëm në lidhje me ruajtjen nga gjynahet, shihet tek dëshira e tyre e jashtëzakonshme për të fituar sevape. Kjo, sepse ata përpiqen çdo çast të jetës së tyre t’i shtojnë veprat e tyre të mira, me vetëdijen se në ditën e gjykimit njeriu do të ketë nevojë edhe për mirësinë më të vogël.

Në një hadith fisnik, Rasulallahu (a.s.), na ka bërë të

ditur vlerën e madhe që do të kenë edhe punët më të vogla në ditën e gjykimit:

“Në ditën e kijametit, njerëzit do të vendosen në rreshta. Ndërkohë, një nga njerëzit e xhehenemit takon një nga njerëzit e xhenetit dhe i thotë:

– “O ti filan! A më mban mend? Njëherë kërkove ujë prej meje dhe unë të dhashë.”

Ndërsa besimtari ndërmjetëson tek Allahu për atë njeri.

Një tjetër (prej njerëzve të xhehenemit) shkon pranë njërit prej atyre të xhenetit dhe i thotë:

– “E mban mend, një ditë të kam dhënë ujë për të marrë abdest?” (pastaj kërkon ndërmjetësim prej tij) dhe ai ndërmjetëson për të.

Përsëri, njëri prej njerëzve të xhehenemit, i thotë njërit prej atyre të xhenetit:

– “O ti filan! A e mban mend atë ditë kur më dërgove për një punë dhe unë shkova për ty?” Pastaj edhe ky xhenetli ndërmjetësoi tek Allahu për të.” (Ibën Maxhe, Edeb, 8.)

Sigurisht që ndërmjetësimi i këtyre besimtarëve do të bëhet me vullnetin dhe lejen e Allahut Teala. Nëse Ai dëshiron, fal. Nëse nuk dëshiron, nuk fal.

Për këto arsye, nuk dihet se cila prej punëve mund të bëhet shkak i shpëtimit tonë në botën tjetër. Prandaj, duhet të nxitojmë në punë të mira pa thënë e vogël apo e madhe. Duhet ta shfrytëzojmë kohën në mënyrën më të mirë dhe sa jemi në këtë botë, lodhjen dhe mundin për hir të Allahut duhet ta konsiderojmë si mirësinë më të madhe dhe punën më të mirë.

MPREHTËSIA E EDUKATËS NË ATMOSFERËN E AFËRSISË ME ALLAHUN

Robërit e dashur të Allahut, me të cilët Ai është i kënaqur:

- Janë të devotshmit që jetojnë duke treguar kujdes të madh edhe ndaj sevapit, edhe ndaj gjynahut më të vogël.

- Janë besnikët, që nga dëshira e madhe për të qenë robër të devotshëm të Allahut dhe ndjekës besnikë të Profetit (a.s.), tregojnë përpikmëri të jashtëzakonshme, me qëllim që jetët e tyre të mos dalin aspak nga rruga e Kuranit dhe Sunetit.

- Janë të sinqertët, të cilët, për t’u bërë pjesë e përmbajtjes së hadithit fisnik: *“Njeriu është së bashku me atë që do!”* (Buhari, Edeb, 96.), përpiqen t’i ngjajnë Profetit të Allahut (a.s.), në ndjenja, në mendime dhe në vepra.

- Janë besimtarët, që me përlujtë plotë përpiqen të ndjekin gjurmët e Rasulallahut, ashtu siç ndiqen gjurmët e dikujt që ecën nëpër dëborë.

Imam Neveviu, i cili ishte prej të devotshmëve, dijetarëve të hadithit dhe njëkohësisht edhe prej muxtëhdëve, për shkak se në asnjë hadith të Profetit (a.s.), nuk

kishte hasur mënyrën se si Profeti ynë (a.s.), e kishte ngrënë shalqinin (bostanin), gjatë gjithë jetës së tij nuk e hëngri asnjëherë atë frut. Përpjekja e tij për të qenë plotësisht në gjurmët e Profetit (a.s.), i cili kishte pushtuar të gjithë jetën e tij, e bëri të qëndronte larg edhe ndaj ngrënies së shalqinit, vetëm se kishte rrezik të largohej nga mënyra e sjelljeve të Profetit (a.s.).

Një nga njerëzit e dashuruar pas Profetit (a.s.), Ahmed Jesevi, për shkak të dashurisë së madhe që ndjente ndaj Rasulallahut (a.s.), i cili ndërroi jetë kur ishte 63 vjeç, pasi i mbushi 63 vjet, hoqi dorë nga jeta e përditshme mbi tokë dhe, derisa i erdhi vdekja, për dhjetë vjet me radhë qëndroi i nguluar në një vend si varr, duke kryer vetëm adhurime.

Imam Rabbani ka thënë:

“Njëherë, kur po hyja në abdeshe, nga pakujdesia u futa me këmbën e djathtë. (Për shkak të këtij veprimi, që nuk përshtatej me sunetin) atë ditë u privova nga të gjitha ëmbëlsitë shpirtërore.”

Përsëri, Imam Rabbani i thotë një ditë njërit prej nxënësve të tij:

“Më sill pak karafil nga qesja!” Ai shkoi dhe solli gjash-



të karafila. Kur e pa, Imam Rabbani në një mënyrë paksa të mërzhitur, tha:

“Nxënësit tanë, ende nuk tregojnë kujdes ndaj fjalës së Profetit (a.s.), që thotë: *“Allahu është tek dhe e do tekun.”* (Buhari, Deauat, 68.) Të tregohesh i kujdesshëm ndaj këtij hadithi, është veprim mustehab (i pëlqyeshëm). Çfarë kujtojnë njerëzit se është mustehab!? Një vepër e tillë mustehab, me të cilën kënaqet Allahu, nuk ndërrohet, edhe nëse të jepet e gjithë kjo botë dhe bota tjetër.” (Ebu'l-Hasan en-Nedvi, Imam Rabbani, fq. 180-181.)

Siç shihet, në një atmosferë të tillë kaq pranë Allahut, përkrah farzeve, vaxhibeve dhe suneteve, edhe veprat mustehab kanë vlerë të madhe. Lëri haramet dhe mekruhet (vepra e papëlqyeshme), por është e domosdoshme të largohemi edhe prej gjërave të dyshimta. Kjo, sepse ajo atmosferë ku mbizotëron dashuria, është aq e pastër dhe delikate, saqë nuk pranon as papastërtinë më të vogël.

Për këtë arsye, me qëllim që të hyjnë në atmosferën e afërsisë me Allahun, të dashurit e Allahut kanë kaluar nga një sitë e imët edukate dhe nga një rreth i rëndë vuajtjesh. Ashtu siç nuk mund të jenë pa stuhi e furtuna majat e maleve, ashtu edhe majat e afërsisë me Allahun nuk janë pa sprova e vështirësi. Prandaj, ata që ndodhen në këto maja të larta shpirtërore, nuk mund të sillen lirshëm dhe në mënyrë të pakujdesshme si ata që ndodhen poshtë tyre. Ata janë të detyruar të tregojnë më tepër kujdes ndaj sjelljeve dhe veprave të tyre, sepse një hap i gabuar që mund të hidhet në ato maja, konsiderohet një gabim shumë i rëndë. Shumë gabime, të cilat mund të arsyetohen nëse bëhen nga njerëz të thjeshtë, për ata njerëz të mëdhenj bëhen shkak i privimeve të mëdha. Sjelljet e njerëzve të thjeshtë nuk u kanë hije atyre robërve të mirë, sepse ato nuk përshtaten me marrëdhënien speciale të miqësisë me Allahun.

Sa bukur e shpreh kjo ndodhi këtë të vërtetë:

Përhapet një thashethem se Sheh Muhamed Nurul Arabiu, nga mistikët e kohës së fundit, kishte mohuar vullnetin e pjesshëm, domethënë, **vullnetin njerëzor!**¹ Kur e dëgjon këtë, Sulltan Abdylmexhid Hani urdhëron që prijësi shpirtëror të thirret në mësimet që zhvilloheshin në audiencën sulltanore dhe që atje ai të pyetej për këtë çështje. Urdhri i sulltanit zbatohet dhe Sheh Muhamed Nurul Arabiu thirret në audiencë. Pastaj, atje, kur u pyet për thelbin e kësaj çështjeje, ai dha këtë përgjigje:

1. Në origjinal: xhuz'í irade, vullnet i pjesshëm; besherí irade, vullnet njerëzor.

“Sigurisht që tek njeriu ka një vullnet të pjesshëm. Ky është edhe burimi i përgjegjësisë. Vetëm se jo te gjithkush dhe në çdo kohë. Për shembull, unë sigurisht që kam një vullnet të pjesshëm. Por erdha me urdhër të padishahut. Kurse nuk e kam në dorë të ngrihem e të ik. Na thuhet “eja”, vijmë, na thuhet “shko”, shkojmë. Kjo do të thotë se në këtë rast, në një specifikë të caktuar, vullneti im nuk ekziston. Gjithashtu, meqë ndodhem në audiencë të padishahut, lëvizjet dhe veprimet që mund të bëj janë të kufizuara. Edhe disa njerëz, ashtu si në këtë shembull, jetojnë vazhdimisht me vetëdijen se ndodhen në audiencën e Zotit të tyre. Kurse shumë të tjerë, megjithëse Allahu me Dëgjimin, Shikimin, Fuqinë dhe Dijen e Tij ndodhet në çdo vend i pranishëm dhe vëzhgues², vetëm në namaz e pranojnë se ndodhen në audiencën hyjnore³. Mirëpo, ata që janë lartësuar në një gradë shpirtërore të caktuar, jetojnë me vetëdijen se ndodhen në çdo çast në audiencën hyjnore. Tani ejani dhe vlerësojeni ju se ka apo s'ka tek këta njerëz vullnet të pjesshëm!”

Në një ajet kuranor urdhërohet:

“...Ai është me ju kudo që të gjendeni...” (el-Hadid, 4)

Siç e shohim, edhe rregullat e afërsisë me Allahun, edhe sprovat, edhe shpërblimet, edhe dënimet janë plotësisht ndryshe.

SPROVA E DURIMIT TË MIRË

Jakubi (a.s.), ishte një nga profetët më të rëndësishëm të Allahut Teala. Ky profet i madh, prej të gjithë fëmijëve të tij, deshi më shumë Jusufin (a.s.), sepse tek ai shihte cilësi të mira. Prandaj dhe zemra e tij ishte shumë e lidhur me të. Mirëpo, për arsye se kjo dashuri e tepërt ndaj tij kishte rrezik të linte në hije dashurinë ndaj Allahut, u detyrua të përballej me një ndarje të gjatë.

Në fakt, çdo baba ndjen dashuri për fëmijën e tij. Por disa baballarë kanë dashuri jashtëzakonisht të tepruar ndaj fëmijëve të tyre. Megjithatë, shumica e tyre nuk sprovohen me mallin ndaj fëmijës së tyre, ashtu siç u sprovua Jakubi (a.s.), sepse Jakubi (a.s.), ishte një profet dhe mik i Allahut. Për njerëzit e thjeshtë që nuk i nënshtrohen kësaj marrëdhënieje të nivelit të lartë të miqësisë me Allahun, dashuria e tepruar ndaj fëmijëve nuk përbën ndonjë problem. Por për atë profet të madh të Allahut, ky fakt u bë shkak i një sprove të vështirë. Ndërkohë, Jakubi (a.s.), i cili u sprovua vazhdimisht me fatkeqësi të ndryshme, duke shfaqur një durim që i ka hije një miku të Allahut dhe me një dorëzim të plotë,

2. Shih. El-Muxhadile, 7.

3. Në origjinal: huzur-i ilahí.

tha: *"...ajo që më takon mua, është vetëm një durim i mirë / i bukur (sabrun xhemil)..."* (Jusuf, 18.)

SPROVA E MIQËSISË

Në zemrën e Ibrahimit (a.s.), nuk kishte vend për diçka tjetër veç Allahut Teala. Për këtë arsye, Allahu e kishte zgjedhur dhe e kishte quajtur "Halil", mik të Vetin. Megjithatë, Allahu Teala e sprovoi atë në tri çështje. Në veten e tij (nefsin e tij), në pasuri dhe fëmijë. Ndërsa Ibrahim (a.s.), duke i kaluar me sukses këto sprova arriti të përforconte meritën e tij për të qenë "Halil", mik i Allahut Teala. Ai u hodh në zjarr për shkak të përpjekjeve dhe luftës së tij me Nemrudin zullumqar, me qëllim që të triumfonte Teuhidi (njësia e Allahut). Kështu që tregoi se, kur të ishte nevoja, do të jepte edhe shpirtin për hir të Allahut. Ai e dhuroi të gjithë pasurinë e tij, duke mos u frikësuar aspak nga varfëria. Me këtë, ai shprehu se pasuria e kësaj bote nuk do ta pengonte atë nga adhurimi dhe përkujtimi i Allahut dhe se adhurimi i Allahut për të ishte më me vlerë se e gjithë bota. Gjithashtu, duke e çuar djalin e tij të vetëm e të dashur për ta bërë kurban për hir të Allahut, tregoi dhe provoi se dashuria për Allahun e kalonte çdo lloj dashurie tjetër të përkohshme dhe se dashuria për fëmijën kurrë nuk do ta linte në hije dashurinë për Allahun Teala. Pra, duke shfaqur dorëzim pa kushte, kënaqësi, sakrificë dhe dashuri, të cilat ishin tregues të rëndësishme të miqësisë me Allahun, doli faqebardhë në të gjitha sprovat.

Megjithatë, ky profet i madh nuk u mjaftua me këto cilësi të larta dhe këto vepra të mira, por duke pranuar dobësinë e tij, u strehua në mëshirën dhe faljen e Allahut, me qëllim që të bëhej rob i merituar i Tij. Ai, me një shqetësim të madh për fundin e vet, i përgjërohet Allahut, duke thënë:

"Mos më turpëro në Ditën, kur do të ringjallen njerëzit" (esh-Shu'ara, 87.)

Pra, me shtimin e gradës së robit tek Allahu Teala, shtohet edhe doza e sprovave. Allahu Teala i sprovon robërit e Tij më të dashur, me durim, me dorëzim e nënshtrim. Kjo është edhe urtësia që vuajtjet dhe fatkeqësitë më të mëdha bien më shumë mbi profetët,

pastaj mbi të dashurit e Allahut, pastaj shkallë- shkallë mbi besimtarët e sinqertë.

Njerëzit e ditur dëshirojnë prej Allahut shëndet dhe mirësi. Megjithatë, kur u pakësoheshin vështirësitë dhe vuajtjet, të cilat do të bëheshin shkak për ngritjen e gradës së tyre tek Allahu, ata shqetësoheshin për gjendjen e tyre dhe shtonin teubet dhe kërkimin e faljes.

Me ngritjen e robit në lartësitë shpirtërore edhe gjendja e devotshmërisë së tyre bëhet më delikate dhe më e hollësishme. Kjo i ngjan ndryshimit në gjerësinë e shikimit të horizontit të dikujt që qëndron në katin e parë dhe dikujt që qëndron në katin e dyzetë të një ndërtese të lartë. Ndërkohë që kjo botë duket përherë e më e madhe për atë që i afrohet asaj dhe zhytet në të, për atë që largohet prej saj fizikisht apo shpirtërisht, duket përherë e më e vogël. Pra, afërsia dhe largësia, lartësia dhe ultësia njësor si në botën materiale, ashtu edhe në botën shpirtërore vlejnë për të shprehur të njëjtat ndryshime dhe për të kuptuar të vërtetat në thellësi të ndryshme.

FALËNDERIMI PËR TË CILIN U BË TRIDHJET VJET TEUBE

Një prej dijetarëve të hadithit, i nderuari Serijj-i Sakati, ishte duke u lexuar nxënësve të tij hadithin fisnik: *"Ai që nuk u qan hallet besimtarëve, nuk është prej nesh!"* (Shih. Hakim,

IV, 352; Hejthemi, I, 87.), kur ndërkohë vjen një nga nxënësit dhe i thotë:

"Mësues! U dogj çarshia e Bagdadit dhe vetëm dyqani juaj ka shpëtuar. Përgëzime!"

Pas kësaj që dëgjoi, për të falënderuar këtë mirësi të Allahut Teala, tha:

"Elhamdulillah!"

Mirëpo, menjëherë i erdhi në mendje hadithi që po u mësonte nxënësve të tij dhe, duke u zhytur thellë në fshehtësinë e urtësisë së këtij hadithi, bëri teube të madhe. Kjo, sepse për një çast pakujdesie që tregoi, nuk i erdhi ndërmend fatkeqësia e besimtarëve të tjerë dhe si pasojë, në atë moment nuk e zbatoi urdhrin profetik në lidhje me qarjen e hallevë të besimtarëve.

Nuk dihet se cila prej punëve mund të bëhet shkak i shpëtimit tonë në botën tjetër. Prandaj, duhet të nxitojmë në punë të mira pa thënë e vogël apo e madhe. Duhet ta shfrytëzojmë kohën në mënyrën më të mirë sa jemi në këtë botë.

Ai u mërzit aq shumë për këtë, sa që nuk e harroi këtë ndodhi për shumë vite dhe, pas tridhjetë vjetëve, pëndesën që kishte në zemër ia shpreh një mikut të tij, duke i thënë:

“Kam tridhjetë vjet që po bëj teube për një çast, kur u tregova i pakujdesshëm ndaj fatkeqësisë së vëllezërve të mi besimtarë...”

Shumë njerëzve as që u bie ndërmend të bëjnë teube për neglizhencën që tregojnë në marrëdhëniet me vëllezërit e tyre besimtarë, për indiferencën dhe për padrejtësitë që bëjnë. Kurse një i dashur i Allahut me zemër të ndjeshme, për një “elhamdulillah” që tha në një çast pa menduar të tjerët, kërkon falje prej Allahut që tridhjetë vjet. Pra, ndryshimi i horizontit të shpirtit, ndryshon edhe botëkuptimet, edhe konceptet.

KONCEPTI I SHKOLLIMIT TEK DIJETARËT DHE TEK NJERËZIT E THJESHTË

Një burrë erdhi për të takuar të nderuarin Mahmud Sami Ramazanoglu, me qëllim që të merrte duanë e tij dhe ta njihte me nipërit e tij, të cilët i kishte marrë me vete. Burri ia prezantoi nipërit e vet dhe tha:

“I nderuar! Këta djem të rinj kanë studiuar në Amerikë dhe janë bërë inxhinierë. Dëshirojmë të marrim ndonjë dua prej teje!”. I nderuari, duke buzëqeshur, u tha:

“Edhe unë jam diplomuar në Daru’l Funun (Universitet). Por shkollimi i vërtetë, është shkollimi në njohjen e Allahut.” (Shih. Mustafa Eriş, Mahmûd Sâmî Efendi’den Hâtıralar, I, 20-21.)

Nga kjo kuptojmë se të gjitha njohuritë dhe dijet, marrin vlerë vetëm me njohjen e Allahut dhe se një shkollim larg njohjes së Allahut nuk mund të ketë dobi në lidhje me shpëtimin e përjetshëm.

I nderuari Sami Efendi, e ka mbaruar fakultetin e Juridikut në Daru’l Funun me nota të larta dhe në një

kohë kur ishte shumë e vështirë të hyje në atë universitet. Nëse do të kishte dëshiruar, mund të kishte vazhduar një nga profesionet e lidhura me juridikun, i cili ishte shumë i kërkuar. Por për arsye se druhej se mos i bënte padrejtësi ndokujt, hoqi dorë nga kjo e drejtë që kishte. Ndërkohë, për të siguruar jetesën, zgjodhi të bëhej llogaritar i një firme.

Por të sqarojmë edhe një gjë:

Kjo zgjedhje e Sami Efendiut nuk duhet të kuptohet sikur nuk duhet të ushtrohen këto detyra të rëndësishme. Në të vërtetë, kjo shpreh faktin se sa me korrektësi duhet të veprojnë ata që merren me këto lloj profesione.



Si përfundim, çdo gjendje e miqve të Allahut, të cilët janë të dashuruar pas Allahut dhe të Dërguarit të Tij, pasqyron ndjesitë e larta të një shpirti, brenda të cilit ziejnë dashuria, dija, sinqeriteti dhe devotshmëria. Ajo që në të vërtetë e bën robin të vlefshëm tek Allahu, është pikërisht një jetë e jetuar me ndjesi të tilla. Prandaj dhe të dashurit e Allahut, gjithmonë na kanë mësuar dhe nxitur ndjesitë e devotshmërisë dhe frikë-respektin ndaj Allahut. Edhe Allahu Teala dëshiron që ne të përipiqemi për t’u bërë si ata njerëz të mirë. Ai dëshiron që edhe ne të përfitojmë prej myzhdesë që u ka dhënë

robërve të tij të dashur në atë ditë të tmerrshme kur do të kërcasë kijameti: **“Pa dyshim, miqtë e Allahut nuk do të kenë arsye për t’u frikësuar dhe as për t’u dëshpëruar.”** (Junus, 62.) Dhe na bën të ditur se kjo mund të arrihet vetëm me një jetë të devotshme.

Allahu na bëftë të gjithëve prej robërve të sinqertë, zemrat e të cilëve janë zbukuar me ndjesitë e devotshmërisë dhe që jetojnë në rrugën e drejtë, në gjurmët e profetëve, sahabëve fisnikë dhe miqve të Allahut. Gjithashtu, na e bëftë të mundur të jetojmë dhe të vdesim si myslimanë dhe të ringjallemi së bashku me njerëzit vepërmirë.

Amin!...



Dr. Adem Ergyl

Dashuria, sipas konstatimeve të *njerëzve të gnosës* (ehli irfan), është qëllimi i parë i ekzistencës. Zoti ynë, një prej emrave të bukur të të Cilit është: “el-Vedud”¹, ka krijuar gjithësinë, kur deshi të shfaqte Vetveten. Ndaj dhe burimi i parë i dashurisë është Zoti i Madhëruar. Ai i ka dhuruar thesarin e dashurisë esencës së gjithë qenies. Bazuar në këtë enigmë, do të thotë që në themelin e çdo strukture pozitive në tërë gjithësinë, ka nga një pjesë të dashurisë. Kudo që ka bashkim, paqe, qetësi, energji pozitive dhe ndërtime materiale dhe shpirtërore, shihet që në themelin e saj ka një pjesë nga dashuria. Dhe kudo që ka prishje, shpërbërje, energji negative, shkatërrime dhe asgjësime aty mungon dashuria.

Eliksiri i dashurisë për ndërtimin në drejtim pozitiv të personalitetit, ka një efekt përcaktues. Për t’u formuar ndjenjat dhe mendimet dhe, rrjedhimisht, për t’u formësuar veprat dhe sjelljet, shpeshherë është e lidhur me këtë. Për këtë arsye, Krijuesi i Madhëruar i ka qortuar

1. “el-Vedud”: Ai që dashuron shumë dhe që dashurohet shumë prej të tjerëve.

gjithnjë njerëzit e vet që të mos e drejtonin kiblenë e dashurisë nga drejtimi i gabuar:

“Thuaj: “Nëse etërit tuaj, bijtë tuaj, vëllezërit tuaj, gratë tuaja, farefisi juaj, pasuria juaj që e keni fituar, tregtia për të cilën keni frikë se nuk do të shkojë mirë dhe shtëpitë ku e ndjeni veten rehat, janë më të dashura për ju sesa Allahu, i Dërguari i Tij dhe lufta në rrugën e Tij, atëherë pritni deri sa Allahu të sjellë vendimin (dënimin) e Tij. Allahu nuk e udhëzon në rrugën e drejtë popullin e pabindur.”” (Teube, 24)

Ajeti fisnik tregon se nuk është e pakuptueshme e as e panevojshme dashuria që ndjen njeriu për sendet, por ky ajet shpreh gabimin që bëhet duke i zënë vendin kjo dashuri, dashurisë ndaj Zotit dhe Pejgamberit (s.a.s.). Është e natyrshme dashuria ndaj nënës, babait, fëmijëve, gruas dhe pasurisë, por asnjë nga këto nuk duhen dashuruar më shumë se Allahu dhe i Dërguari i Tij (s.a.s.). Dëshira e asnjërit prej tyre, nuk duhet të sfidojë urdhrat e Allahut. Nëse janë armiq të Allahut, atëherë ata nuk e meritojnë

dashurinë. Kjo situatë është e rëndësishme për nga aspekti i të shprehurit të dashurisë sipas një radhe të duhur.

Dashuria më e madhe duhet të jetë ndaj Allahut dhe Pejgamberit (s.a.s.). Dashuritë e tjera mund të zënë vend sipas kësaj qendre. Të duash krijesat për hir të Krijuesit të tyre, në fakt është dashuri ndaj Krijuesit. Kështu pra, sikur dashuria të drejtohet mirë, edhe dashuritë e natyrshme (fikri) lartësohen deri në atë shkallë sa të arrijnë dashurinë hyjnore. Madje, të duash pasurinë dhe dynjanë për hir të Allahut, pranohet si një dashuri e lartë.

Nëse kibleja ndryshon në dashuri, atëherë krijohen perëndi të tjera. Kjo gjë bën të krijohet gabimi në dashuri dhe njeriun e bën të vishet me një identitet *mushriku*, nga identiteti i tij *muvahhid*. Ajeti fisnik shpjegon këtë të vërtetë:

“E megjithatë, disa njerëz zgjedhin (për të adhuruar) në vend të Allahut (zota) të tjerë, (duke i konsideruar) si të barabartë me Atë dhe duke i dashur siç duhet Allahu. Por ata që besojnë, e duan shumë më tepër Allahun (se sa ç’i duan idhujtarët idhujt e tyre). Sikur keqbërësit të shihnin që tani çastin kur të përballen me ndëshkimin, do ta kuptonin se e tërë fuqia i përket Allahut dhe se dënimi i Tij është fort i ashpër.” (Bakara, 165)

Ky ajet regon se drejtimi i gabuar në dashuri të bën të hysh në kategorinë e njerëzve zullumqarë. Përdorimi i thesarit të dashurisë në vendin e gabuar, është një zullum që njeriu i bën edhe dashurisë edhe vetes së vet. T’ia dedikojë dikujt tjetër dashurinë që njeriu duhet t’ia dedikojë Allahut, është gjithashtu një zullum i bërë edhe ndaj Allahut. Ka dallim mes të bërit sikur e do Allahun dhe të duash për hir të Allahut.

Ne i duam për hir të Allahut, pejgamberët, dijetarët, *arifët* dhe *salihët*. Kësisoj, këto lloj dashurish, konsiderohen si dashuri ndaj Allahut, sepse themeli i kësaj dashurie është për arsye të dimensionit të tyre si të dërguarit e Zotit, si të afërmit e Zotit, të bindurit e Zotit dhe të devotshmit e Zotit, përndryshe nuk është një dashuri absolute. Nuk duhet harruar asnjëherë kjo vijë e *Tevhidit* në dashuri. Nuk duhet kaluar caku, ashtu sikurse bënë të krishterët, duke e bërë zot Hz. Isain. Por, sa e sa të dashuruar ka në botë që janë të dhënë pas pasurisë dhe postit, në një marrëdhënie idhujtarie dhe që kanë neglizhuar dashurinë ndaj Allahut?! Kurrë s’duhet të dyshojmë se këto lloj dashurish janë *shirk*. Sado pak të jetë devijimi në drejtimin e dashurisë, kjo gjë bëhet shkaktare e sa e sa fatkeqësive!

Edhe ky ajet fisnik flet pikërisht për këtë:

“Dhe mos anoni nga ata që bëjnë të këqija, përndryshe do t’ju përcëllojë Zjarri. Ju nuk do të keni mbrojtës tjetër përveç Allahut dhe nuk do të ndihmoheni.” (Hud, 113)

Shkaku i parë i shkatërrimit të popujve mund të thuhet se është për arsye të shkëputjes së lidhjes së duhur me Zotin. Imani është emri i një lidhjeje me bazë dashurinë. Është pikërisht kjo dashuri, që mundëson nënshtrimin ndaj Zotit e ndaj gjithçkaje që vjen prej Tij.


Sikur të mos ishte kjo dashuri, njeriu nuk do të kishte as prestigjin e as meritën që të ishte mëkëmbës i Zotit dhe ta dëshmonte Atë në rruzullin tokësor.

Atëherë, do të lindë nevojën për banimin e popujve të tjerë në vendin e tyre. Ja pra, kjo shprehje e Zotit tonë, kjo e fshehtë e madhe e Tij dhe ky *sunetullah*, u shpallet të gjithë besimtarëve:

“O besimtarë! Nëse ndokush prej jush braktis besimin e vet, dijeni se Allahu do të sjellë njerëz, që i do dhe që e duan; të përlulur me besimtarët dhe të ashpër me femohuesit; që luftojnë në rrugën e Allahut dhe nuk i tremben qortimit të asnjë qortuesi. Kjo është mirësia e Allahut, të cilën Ai ia jep kujt të dojë. Allahu është Bujar i madh dhe i Gjithëditur.” (Maide, 54)

Njeriu, i cili është krijuar me detyrën që të jetë dëshmuesi dhe mëkëmbësi i Zotit në rruzullin tokësor, do ta realizojë meritën ndaj kësaj detyre me të qenët i përkohshëm në *muhabetullah*, sepse dashuria është një magji që përcjell tek i dashuruari gjendjen dhe cilësinë e atij që dashurohet, përbërja shpirtërore që e shprehën *arifët* me fjalët “të edukohesh me edukatën e Allahut”. Duke i zbatuar farzet dhe nafilet, njeriu arrin të meritojë dashurinë e Allahut. Kur arrin të lidhet me Zotin me një lidhje dashurore (ashk), të shprehurit me fjalë thuajse arrin në një kuptim të pamundshëm. Shprehja hyjnore në hadithin kuds: “Kur Unë e dua robin Tim, i bëhem syri që shikon, veshi që dëgjon, dora që kap dhe mendja që arsyeton (akl).”, pikërisht për këtë status e ka fjalën. Sikur thesari i dashurisë, që u bë shkak të arrihet një shkallë kaq e lartë, të mos ishte me qendër Zotin, ngado që mund të drejtohej, në të vërtetë do të ishte i humbur dhe i shpërdorur. Atëherë, për të drejtuar përherë nga Zoti kiblenë e dashurisë, nuk ka rrugëdalje tjetër përveçse të përgjërohemi:

“Dua dashurinë Tënde, Zoti im! Dëshiroj nga Ti, dashurinë e dashuruesit dhe dashurinë e asaj vepre që më shpie në dashurinë Tënde.”





Dynjaja është ara e ahiretit

Musab Këjlyogllu

Falënderimet më të përzemërta i takojnë Allahut (xh. xh), i cili është autoriteti i vetëm, i cili dëshiron vetëm mirësi për robërit e tij dhe i cili është sunduesi i ditës së llogarisë.

Salavatet dhe selamet qofshin për atë që plotësoi moralin e lartë, Hz. Muhamed Mustafanë, sallallahu alejhi ve sellem, për familjen e tij dhe për shokët e tij të nderuar.

Të gjitha krijesat që ndodhen në tokë e në qiej, janë krijuar me një rregull dhe synim. Një njeri që mediton mbi këtë rregull, do të shikojë se ka një harmoni të mrekullueshme. Kështu, shikohet qartë se të gjitha krijesat ekzistojnë prej shekujsh me një rotacion dhe rregull të përsosur. Të gjitha kanë nga një detyrë. Njeriu ka pozitën më të veçantë dhe është krijesa më e nderuar ndërmjet të gjitha të tjerave.

Të gjitha krijesat e tjera janë vënë nën urdhrin dhe shërbimin e njeriut. Veçoria më e rëndësishme që e ndan njeriun nga krijesat e tjera, është mendja dhe sprovimi. Domethënë, qëllimi i ardhjes sonë në dynja, është adhurimi i Allahut Teala dhe jo të ngrënët, të pirët, të shëtiturit dhe të jetuarit sipas dëshirave e pasioneve vetjake pa asnjë përgjegjësi.

Atëherë, njeriu është i detyruar të bëjë ibadet dhe vepra të mira, duke e ndarë të vërtetën nga e gabuara. Allahu, xhelle xhelaluh, në Kuranin Fisnik, thotë:

“Ai i ka krijuar jetën dhe vdekjen, për t’ju provuar se

kush prej jush do të veprojë më mirë. Ai është i Plotfuqishmi dhe Falësi i madh.” (el-Mulk 67/2.)

“Xhindet dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të Më adhurojnë.” (edh-Dharijat 51/56.)

Allahu Teala i ka dhënë njeriut mendjen dhe nefsin. Megjithatë, e ka sprovuar edhe me pengesën e djallit të mallkuar. Krahas gjithë këtyre pengesave, Allahu (xh. xh.), ka krijuar jetën dhe vdekjen për të nxjerrë në pah se kush bën më shumë vepra të mira. Përsëri Allahu i madhëruar, thotë:

“Ne i kemi krijuar qiejt dhe Tokën dhe çfarë gjendet midis tyre, me qëllim të plotë dhe me afat të caktuar.” (el-Ahkaf 46/3.)

Përgjatë këtij procesi, njeriut i është dhënë një kohë e shkurtër. Sado që të jetojë njeriu, jeta që ka jetuar në këtë botë është një hiç i madh kundrejt jetës së përhershme të ahiretit. Po ashtu, njeriu nuk e di sa do të jetojë. Por për fat të keq, njeriu është dhënë pas kësaj dynjaje sikur nuk do të vdesë asnjëherë, edhe pse kjo e fundit është e shkurtër. Veçanërisht, pasi të vdesë, ai do ta kuptojë se sa e shkurtër është koha e jetës së kësaj bote, por atëherë ka kaluar çdo gjë.

Koha e jetës së kësaj bote, është sa koha që një udhëtar qëndron për të pushuar nën hijen e një peme dhe pastaj çohet e vazhdon rrugën. Njerëzit e mençur e kanë pranuar si një sjellje tronditëse mundin që jep njeriu për

një vend, në të cilin do të qëndrohet kaq pak. Allahu i lartësuar, thotë:

“Ditën, kur të vijë Ora (e Kiametit), keqbërësit do të betohen se kanë qëndruar (në tokë) veçse për një kohë të shkurtër. Kështu, ata shmangen nga e Vërteta.” (er-Rum 30/55.)

“Ditën kur do ta shohin atë, (njerëzve) do t’u duket se kanë qëndruar (në tokë) veç një mbrëmje apo një mëngjes.” (en-Naziat 79/46.)

Ibn Mes’udi (r.a.), transmeton: “Hyra te i Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem. E gjeta duke fjetur mbi një hasër. Hasri kishte lënë shenja në pjesët anore të trupit të tij (që ishin zbuluar). I thashë:

- O i Dërguari i Allahut! Sikur të të sillnim një mbulesë, ta vendosnim mbi hasër në mënyrë që të të mbronte nga ashpërsia e saj!” Ai më tha:

- Kush jam unë dhe kush është kjo botë? *Shembulli im me dynjanë, është si shembulli i një udhëtari që ulet nën hijen e një peme për të pushuar dhe pastaj vazhdon rrugën.”* 1

Megjithëse i është dhënë një jetë kaq e shkurtër, njeriu e neglizhon ahiretin dhe ditën e llogarisë. Në këtë mënyrë, kapet fort pas kësaj bote dhe e shikon si të lejuar çdo lloj përpjekjeje për të fituar pasurinë e kësaj bote dhe për të shijuar dëshirat vetjake. Ndërkohë që i premtohet xheneti, i cili është i mbushur plot me shpërblime të pafundme, e lë atë mënjanë dhe pothuajse e hedh veten në zjarr duke zgjedhur jetën e kësaj bote, që është shumë e shkurtër. Allahu Teala thotë:

“Dijeni se jeta në këtë botë, nuk është tjetër veçse lojë, dëfrim e zbukurim, si dhe mburrje ndërmjet jush e rivalitet për më shumë pasuri dhe fëmijë! Ajo i shëmbëllen bimës, e cila pas shiut, rritet dhe i gëzon bujqit, por më vonë zverdhet, thahet dhe mbetet pa vlerë. Në botën tjetër ju presin vuajtje të mëdha ose falja e Allahut dhe kënaqësia e Tij. Ndërsa jeta në këtë botë është vetëm kënaqësi e rreme.” (el-Hadid 57/20.)

“Jeta e kësaj bote është vetëm lojë e argëtim, kurse bota tjetër, pa dyshim që është më e mirë për ata që i frikësohen Allahut. Pra, a nuk po mendoni?” (el-En’am 6/32.)

Kur fillon jeta e kësaj bote, mbyllen perdet me ahiretin. Kur njeriu të vdesë, do të ringjallet në ahiret. Të gjitha perdet do të hapen, pasi të ringjallet i hutuar si ai që zgjohet nga gjumi. Ai do ta konceptojë se jeta që ka jetuar ishte

shumë e shkurtër si një ëndërr dhe do ta kuptojë gabimin që ka bërë. Ai do të kërkojë t’i jepet edhe një shans që të vijë në këtë botë për të bërë ibadet, por ky pendim nuk ka kompensim, sepse kjo gjë do të jetë e pamundur.

“Sikur t’i shohësh keqbërësit se si para Zotit të tyre kokulur do të thonë: “O Zoti ynë, pamë dhe dëgjuam, andaj, kthena (në atë botë) që të bëjmë vepra të mira! Ne tashmë besojmë me bindje!” (es-Sexhde 32/12.)

Shumë hadithe janë transmetuar nga Pejgamberi, sallallahu alejhi ve sellem, të cilat tregojnë në mënyrë të dukshme se sa e pavlerë është jetë e dynjasë.

Sehl ibn Sa’d (r.a.), transmeton se i Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, ka thënë:

“Sikur bota te Allahu (xh.xh.), të kishte vlerë sa fleta e një grerëze, nuk do të lejonte asnjë qafir që të pinte qoftë edhe një gllënjikë ujë.” 2

Ibn Umeri, radijallahu anh, transmeton: “I Dërguari i Allahut (s.a.s.), më kapi në supe dhe më tha:


-Ji në këtë botë si një i huaj apo si një udhëtar! Ndërsa vetë Ibn Umeri (r.a.), thoshte: “Nëse e arrin mbrëmjen, mos e prit mëngjesin. Nëse e arrin mëngjesin, mos e prit mbrëmjen. Përderisa të jesh mirë, përgatitu për sëmundjen, ndërsa, sa je gjallë, përgatitu për vdekjen.” 3

“Dynjaja është e ëmbël dhe e mirë. Allahu (xh.xh.), do t’ju bëjë trashëgimtarë të saj dhe do të shikojë se si veproni. Atëherë, kini kujdes nga dynjaja dhe gratë, sepse fitneja e parë e Beni Israilëve ka ndodhur për shkak të grave.” 4

Allahu, xhelle xhelaluh dhe i Dërguari i tij, sallallahu alejhi ve sellem, i paralajmërojnë njerëzit duke u treguar atyre se jeta e kësaj bote është diçka boshe dhe se një ditë do të merren në llogari për çdo gjë që kanë vepruar. Por kjo botë ka rëndësi të madhe, për shkak se është rrugë kalimi dhe arë e ahiretit. Për shkak se kjo botë është vendi ku fitohet ahireti, kësaj jete duhet t’i japim shumë rëndësi dhe duhet të shfaqim çdo lloj përpjekjeje që do na mundësojë të fitojmë ahiretin.

Ne nuk duhet të heqim dorë krejtësisht nga kjo botë, por edhe ndaj botës tjetër nuk duhet të jepemi plotësisht, duke e neglizhuar dynjanë. Domethënë, të gjitha ushqimet që do të na duhen në jetën e ahiretit, duhet t’i fitojmë sa jemi në këtë botë dhe çantën e ushqimit të ahiretit duhet ta mbushin plot me vepra të mira.

Njeriu nuk është krijuar pa synim. Një ditë, patjetër do



Ne nuk duhet të heqim dorë krejtësisht nga kjo botë, por edhe ndaj botës tjetër nuk duhet të jepemi plotësisht, duke e neglizhuar dynjanë. Domethënë, të gjitha ushqimet që do të na duhen në jetën e ahiretit, duhet t’i fitojmë sa jemi në këtë botë dhe çantën e ushqimit të ahiretit duhet ta mbushin plot me vepra të mira.

të merret në llogari. Siç korr grurë ai që mbjell grurë dhe siç korr elb ai që mbjell elb në këtë botë, edhe në ahiret njeriu patjetër do të korrë atë që ka mbjellë në dynja. Sigurisht se një njeri që ia ka dedikuar jetën rrugës së Allahut Teala, që ka përbulluar çdo lloj vështirësie, madje ka dhënë edhe shpirtin për të, nuk do të jetë i njëjtë te Allahu me atë që e ka kaluar jetën në dynja sipas dëshirave dhe tekave vetjake.

Allahu i madhëruar do t'i ndajë robërit dhe secilin do ta fusë në xhenet apo xhehenem ashtu siç e ka merituar. Askujt nuk do t'i bëhet padrejtësi. Kush të ketë bërë një të mirë sa grimca apo një të keqe sa grimca në këtë botë, do të japë llogari për të. Allahu i madhëruar, në Kuranin Fisnik, thotë:

“Kush ka bërë ndonjë të mirë, qoftë sa një grimcë, do ta shohë atë dhe kush ka bërë ndonjë të keqe, qoftë sa një grimcë, do ta shohë atë.” (el-Zelzele 99/7-8.)

Gjithmonë kanë dalë njerëz dhe shoqëri që quhen myslimanë, por që janë të ndryshme nga emri, për shkak se në zemrat e tyre nuk është vendosur siç duhet çështja e besimit. Ata njerëz që, kur pyeten apo kur ngelin në vështirësi thonë se janë myslimanë dhe që nuk shkojnë më tutje me atë stil jete që kanë përvetësuar, njoftohet se nuk do të shpëtojnë nga llogaria dhe nuk do të hyjnë në xhenet.

“A mendoni se do të hyni në Xhenet, pa i provuar Allahu ata që kanë luftuar prej jush dhe ata që kanë duruar?” (Al Im-ran 3/142.)

“A mendojnë ata që bëjnë vepra të këqija, se do t'i shpëtojnë dënimit Tonë?! Sa keq që gjykojnë ata!” (el-Ankebut 29/4.)

Kjo punë nuk mbaron duke thënë vetëm besuam, por duhet të vërtetohet me vepra të mira e të bëra me sinqeritet. Është e pamundur të bëjë keq një njeri, i cili e di se një ditë do të merret në llogari, qoftë edhe për një mirësi apo ligësi të vogël. Përkundrazi, ai kërkon të bëjë sa më shumë vepra të mira dhe qëndron larg ligësive, saqë nuk lëndon qoftë edhe një milingonë.

Dita e gjykimit, do të jetë një ditë e madhe, ku dhia pa brirë do të marrë hakun e saj nga dhia me brirë dhe njeriu i dhunuar do të marrë qoftë edhe hakun më të vogël që i është marrë në këtë botë. Siç gëzohen ata që kalojnë me sukses provimet në këtë botë, po kështu do të gëzohen atje edhe ata që u peshon rëndë peshorja e veprave të mira dhe do të humbin ata që u peshon rëndë peshorja e veprave të këqija.

Le të mos harrojmë se provimi i botës tjetër është shu-

më më i vështirë se provimi i lehtë i kësaj bote. Ajo do të jetë një ditë llogarie, ku mendja do të hutohet, aq sa nëna dhe babai nuk do ta njohë fëmijën e tij. Allahu i madhëruar e përshkruan kështu këtë ditë të tmerrshme:

“O njerëz! Frikësojuni Zotit tuaj dhe frikësojuni Ditës, kur prindi nuk do ketë mundësi ta ndihmojë aspak fëmijën, e as fëmija nuk do ketë mundësi ta ndihmojë sado pak prindin! Premtimi i Allahut është vërtet i sigurt, prandaj mos e lini jetën e kësaj bote dhe djallin që t'ju mashtron për Allahun.” (el-Lukman 31/33.)

“Frikësojuni Ditës, kur askush nuk do ketë mundësi të bëjë asgjë për askënd dhe, kur prej askujt nuk do të pranohet ndërmjetësim e shpërblësë dhe as që do të ndihmoheni.” (el-Bakara 2/48.)

Kur njeriu të japë frymën e fundit dhe kur të hapen perdet me kalimin në ahiret, do të kuptojë çdo gjë dhe do të pendohet. Kur të shikojë gëzimin dhe lumturinë e atyre që e japin llogarinë dhe e kanë bërë hak xhenetin dhe kur ta shpjen në xhehenem, ku do të ndëshkohet me një pikëllim të madh, do të dëgjojë zhurmën e xhehenemit dhe do të thotë: “Ah, sikur të isha dhé!” Por këtë mundësi nuk ka për ta pasur.


“Me të vërtetë, Ne ju kemi paralajmëruar se është i afërt dënimi, Ditën, kur njeriu do të shohë se ç'kanë bërë duart e tij dhe, kur jobesimtari do të thotë: “Ah, sikur të isha pluhur!” (en-Nebe 78/40.)

Nuk ka asnjë krijesë që të mos e përkujtojë Allahun (xh.xh.), dhe të mos i bindet atij. Çdo krijesë e përkujton Allahun e madhëruar sipas mënyrës së saj.

Ato, siç i binden plotësisht Allahut, po ashtu i kryejnë me përpikëri të gjitha detyrat e tyre. Krijesa e vetme që mëkaton ndaj Allahut, që e ka harruar adhurimin dhe që largohet nga synimi i krijimit, është njeriu. Allahu i madhëruar shprehet kështu:

“Por, pas kësaj, zemrat tuaja u forcuan e u bënë si gurë, madje edhe më të forta. Në të vërtetë, ka gurë nga të cilët burojnë lumenj, ka të atillë që çahen e nga të cilët rrjedh ujë, madje ka edhe syresh që rrëzohen nga frika e Allahut. Allahu nuk është i pavëmendshëm ndaj veprimeve tuaja.” (el-Bakara 2/74.)

Ata që jetojnë në këtë botë pa e njohur Allahun (xh. xh.) dhe që e shohin si të lejuar çdo lloj padrejtësie, krimi, dhunimi dhe imoraliteti, pa menduar fare për ditën e llogarisë, sigurisht se një ditë do të vdesin dhe do të hyjnë në dhe. Pasuria që kanë fituar, do t'u ngelet trashëgimtarëve, ndërsa mëkatet e saj, do tu shndërrohen në halle të më-



dha ditën e gjykimit. Allahu i madhëruar thotë:

“O ju që keni besuar! Mos e përvetësoni pasurinë e njëri-tjetrit në mënyrë të palejueshme, përveç rastit kur ajo është tregti me pëlqim të dyanshëm dhe mos e vrisni veten (e njëri-tjetrin)! Vërtet, Allahu është i Mëshirshëm me ju. Kushdo që e bën këtë me dhunë dhe padrejtësi, Ne do ta hedhim në zjarr. Kjo është shumë e lehtë për Allahun.” (en-Nisa 4/29-30.)

Ai që është dhunuar, do të vijë dhe do t’i marrë sevapet atij që e ka dhunuar. Kur t’i mbarohen sevapet, i jep mëkatet. Kjo llogari, sigurisht se do t’i zvarrisë në falimentim ata që bëjnë padrejtësi. Kur, pas kësaj llogarie të dërgohen në xhehenem, ata nuk mund t’i shpëtojë askush. Atëherë, ata që zgjedhin një fund të tillë kundrejt mirësive të pafundme, nuk i kanë bërë padrejtësi askujt përveç vetes së tyre. Allahu i madhëruar e shpreh kështu këtë gjendje:

“Atë që i paraqitet Zotit të vet si keqbërës, sigurisht që e pret Xhehenemi, ku as nuk do të vdesë e as nuk do të jetojë.” (Taha 20/74.)

“Sa për atë që dëshiron këtë botë, Ne shpejtojmë t’i japim çfarë të dëshirojmë atij që duam. Pastaj ia caktojmë atij xhehenemin, në të cilin ai do të përvëlohet, duke qenë i turpëruar dhe i dëbuar.” (el-Isra 17/18.)

Njeriu që nuk mund t’i rezistojë zjarrit më të lehtë në jetën e kësaj bote dhe që shqetësohet për shkak të një djegieje, duhet të mendojë se si mund t’i rezistojë zjarrit të turbuar të xhehenemit dhe duhet të përpiqet shumë për të bërë çdo gjë që e largon nga xhehenemi.

“Sikur t’i shohësh ata kur të vihen para zjarrit, duke thënë: ‘Ah! Sikur të ktheheshim pas, nuk do t’i mohonim shpalljet e Zotit tonë dhe do të bëheshim besimtarë!’” (el-En’am 6/27.)

“Thuaj: ‘E vërteta është nga Zoti juaj. Kush të dojë, le të besojë e kush të dojë, le të mohojë’ Ne kemi përgatitur për mohuesit keqbërës një zjarr, që do t’i rrethojë nga të gjitha anët (si çadra). Nëse do të kërkojnë ndihmë, do t’u jepet një ujë si xehja e shkrirë, që do t’ua përcëllojë fytyrat. Sa pije e tmerrshme është ajo e sa strehim i keq është ai (zjarri)!” (el-Kehf 18/29.)

“Mëkatarrët do t’i shtyjme në Xhehenem, si tufë e etur.” (Merjem 19/86.)

“Ata do të gulçojnë dhe nuk do të dëgjojnë (asgjë).” (el-Enbija 21/100.)

“Zjarri do t’ua përcëllojë fytyrat dhe buzët (aq sa do t’u duken dhëmbët).” (el-Mu’minun 23/104.)

“Ata që bëjnë vepra të këqija dhe mbuloen nga fajet e veta, do të jenë banorë të Zjarrit (të xhehenemit), ku do të qëndrojnë përgjithmonë.” (el-Bakara 2/81.)

“O ju që keni besuar! Ruajeni veten dhe familjet tuaja nga zjarri, lënda djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët. Atë e mbikëqyrin engjëj të fuqishëm e të ashpër, të cilët kurrë nuk i kundërshtojnë urdhrat e Allahut, por i zbatojnë menjëherë.” (et-Tahrim 66/6.)

Allahu i madhëruar ka përgatitur mirësi të pafundme në xhenet për ata që kanë bërë vepra të mira në këtë botë. Jeta e xhenetit, në të cilën nuk ka sëmundje, ftohje, depresion, teshtitje, nevojë për banjë, dhimbje, përgojim, ligësi, krim, asnjë lloj shqetësimi, shëmtire apo ndonjë vështirësi tjetër më të vogël dhe në të cilën ka vetëm mirëqenie, po pret besimtarët e devotshëm.

“Ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, Ne do t’i shpiem në kopshte të xhenetit, nëpër të cilat rrjedhin lumenj. Aty do të qëndrojnë vazhdimisht e përgjithmonë. Ky është premtimi i vërtetë i Allahut. Kush është më i vërtetë se Allahu në fjalë?!” (en-Nisa 4/122.)

“Ndërsa ata që i janë frikësuar Zotit, do të çohen grupe-grupe në xhenet. Kur t’i afrohen atij, dyert do të hapen e rojtarët e tij do t’u thonë: ‘Shpëtimi qoftë mbi ju! Ju keni qenë njerëz të mirë, andaj hyni në të dhe qëndroni përgjithmonë!’” (ez-Zumer 39/73.)

“Pikërisht atyre u përket xheneti i Adnit, nëpër të cilin rrjedhin lumenj. Ata do të stolisen atje me byzylykë ari dhe do të vishen me rroba të gjelbra prej mëndafshi të hollë dhe armaçi, duke ndenjtur të mbështetur në shtretër të lartë. Sa shpërblim i mrekullueshëm dhe sa vendbanim i bukur!” (el-Kehf 18/31.)

“Ata do të thonë: ‘Falënderimet qofshin për Allahun, që përmbushi premtimin e tij dhe na dha në trashëgim xhenetin, ku të vendosemi si të duam!’ Sa i mrekullueshëm është shpërblimi i atyre që kanë vepra të mira!” (ez-Zumer 39/74.)

“Ja përshkrimi i xhenetit që u premtohet të përkushtuarve (ndaj Allahut): Një vend, ku ka lumenj me ujë të pandotur, lumenj qumështi me shije të pandryshuar, lumenj vere me shije të këndshme për ata që e pinë dhe lumenj prej mjalti të kulluar. Ata do të kenë aty lloj-lloj frutash dhe falje prej Zotit të tyre. A mund të krahasohet ky shembull me xhehenemin, ku gjynahqarët do të qëndrojnë përherë në zjarr dhe do t’u jepet ujë i valuar, që ua copëton zorrët?!” (Muhammed 47/15.)

“Pa dyshim, ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira,



“Sa për atë që dëshiron këtë botë, Ne shpejtojmë që t’i japim çfarë të dëshirojmë atij që duam. Pastaj ia caktojmë atij xhehenemin, në të cilin ai do të përvëlohet, duke qenë i turpëruar dhe i dëbuar.”

(el-Isra 17/18.)

Allahu do t'i shpjerë në xhenete, nëpër të cilat rrjedhin lumenj. Ndërsa ata që nuk besojnë dhe kënaqen e hanë ashtu siç gëlltisnin bagëti, do të kenë zjarrin si vendbanim!" (Muhammed 47/12.)

Allahu (xh.xh.), i paralajmëron robërit e tij të mos bëjnë mëkate, por të bëjnë vepra të mira dhe të kenë frikë nga xhehenemi. Allahu i madhëruar që është shumë i mëshirshëm, ua ka hapur derën e pendimit robërve të tij, derisa të vijë fryma e fundit, sado që të hyjnë në mëkat.

Nëse njeriu e hedh veten në zjarr dhe, nëse e jep frymën e fundit para se të pendohet duke mos e vlerësuar këtë mundësi që ia ka dhënë Allahu Teala, edhe pse mëkaton shumë, atëherë është vetë ai që e ka hedhur veten në zjarr dhe në ahiret nuk do të ketë asnjë justifikim.

Allahu i madhëruar u jep aq shumë atyre që besojnë, sa që një njeriu që bën mëkat i shkruhet një gjynah, ndërsa kur bën një të mirë, i jepet shpërblim dhjetë fish, madje edhe më shumë, pra, deri në shtatëqind fish. Krahas kësaj, Allahu (xh.xh.), premton se, kur robi të pendohet sinqerisht për të mos i bërë më ato mëkate, të këqijat do t'ia shndërrojë në të mira. Në ajetin fisnik, thuhet:

"Ndërsa, ai që pendohet dhe bën vepra të mira, do të kthehet te Allahu me pendim të pranuar." (el-Furkan 25/71.)

I Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, thotë: *"Ai që pendohet për mëkatin e tij, është si ai që nuk ka mëkate fare."* 5 Ndërsa, Allahu Teala në Kurandin Fisnik, thotë:

"Vërtet, Allahu nuk fal që të adhurohet dikush apo diçka tjetër veç Atij, por gjynahet e tjera më të vogla ia fal kujt të dojë. Kushdo që i bën shok Allahut (në adhurim), ka bërë gjynah të madh." (en-Nisa 4/48.)

Allahu i lartësuar premton se do të na i falë mëkatet.

I Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, e përkufizon kështu pendimin e vërtetë: *"(Pendim i vërtetë do të thotë që) robi të ndjejë pishmanllëk për mëkatin që ka bërë, t'i kthehet plotësisht Allahut Teala dhe të mos kthehet më të mëkati, ashtu siç nuk kthehet përsëri qumështi në gj."* 6

Nisur nga kjo, nëse njeriu akoma kërkon xhehenemin krahas gjithë këtyre mirësive e nderimeve dhe, nëse nuk ia vendos gishtin kokës e ta kthejë drejtimin nga Allahu, atëherë nuk do të ketë të drejtë të parashtrojë asnjë arsye.

Jeta e kësaj bote është si një grua e moshuar që ka bërë makijazh. Bukuritë e saj janë të përkohshme. Njeriu mundohet me të gjitha mundësitë të fitojë pasuri në dynja,

duke e harruar ahiretin dhe duke u zhytur në pasionet mashtruese të jetës së kësaj bote, e cila nuk dihet se ku dhe kur do të marrë fund. Sado që të fitojë, ai mundohet edhe për më shumë.

Transmetohet nga Abdullah ibnu Zubejr (r.a.), se kur mbante hytben në minber në Mekë, thoshte: -O njerëz! i Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, ka thënë: *"Sikur birit të Ademit t'i ishte dhënë një luginë e mbushur me flori, ai do të dëshironte t'i jepej edhe një luginë e dytë. Nëse i jepej edhe e dyta, do të kërkonte të tretën. Birin e Ademit e ngop vetëm dheu. Allahu e pranon pendimin e atij që pendohet për lakminë."* 7

"Sikur biri i Ademit të kishte dy lugina plot me pasuri, do të kërkonte edhe një luginë të tretë. Asgjë përveç tokës nuk mund ta mbushë barkun e birit të Ademit, por Allahu e pranon pendimin e atij që pendohet." 8

Si përfundim, çfarëdo që të ketë bërë njeriu apo sado që të ketë hyrë në mëkat, kjo nuk ka rëndësi, mjafton që ai të pendohet para frymës së fundit.

Jeta e kësaj bote, nuk i ka ngelur askujt deri më sot; edhe në të ardhmen nuk ka për t'i ngelur. Njeriu, i cili do të harrohet pas dy ose tre brezave, duhet t'i japë më shumë rëndësi fesë së Allahut se sa dynjasë, ndërkohë që rend me një lakmi të madhe për të fituar sa më shumë pasuri.

Ndërkohë që përpiqet me të gjitha mundësitë për interesat e kësaj bote, ai duhet të përgatitet për ditën e llogarisë në ahiret dhe gjithmonë duhet të shqetësohet për dhënien e llogarisë së atyre që ka bërë. Asnjë njeriu dhe asnjë gjallesë nuk duhet t'i bëjë padrejtësi dhe çantën e udhëtimit për në ahiret, duhet ta mbushë plot për plot me vepra të mira.

Asnjë mëkat nuk ka rëndësi te Allahu (xh.xh.). Çfarëdo mëkati që të ketë bërë ai që pendohet, Zoti do t'i thotë: *"Ku ngele o robi im?"* dhe jo: *"Me çfarë fytyre më ke ardhur?"* Sa më shpejt që të kthehemi nga gabimi dhe mëkati, aq më mirë do të jetë. Ndërsa, ata të cilët nuk dëgjojnë dhe nuk e pranojnë rrugën e vërtetë krahas gjithë këtyre argumenteve, nuk i bëjnë dëm askujt, përveçse vetes së tyre.

Shënimet:

- [1] Tirmidhi ka thënë se hadithi është sahih.
- [2] Tirmidhi, Zuhd 13, (2321); Ibn Maxhe, Zuhd 11, (2410).
- [3] Buhari, VII, 170, Rikak 3.
- [4] Muslim, Dhikr 99; Tirmidhi, Fiten 26; Ibn Maxhe, Fiten 19.
- [5] Ibn Maxhe, Sunen, vëll. 2, fq. 1420.
- [6] Ahmed b. Hanbel, Musned, 1/446.
- [7] Sahihu'l-Buhari, vëll. 14, fq.6374.
- [8] Muslim, hadith nr: 1048; Sahihu'l-Muslim, përkth dhe shpjg, 5/46.





ISTIKAMETI

Duran Ekizer

Një ditë, në Fakultetin Teologjik të Universitetit Marmara, ishim në orën e Hadithit. Erdhi profesori dhe na bëri një pyetje, për të cilën nuk kishim dëgjuar e as kishim menduar ndonjëherë:

“Cila është veçoria themelore që kryeson në jetën e Resulullahut (s.a.s.)?”

U shtangëm. Për një farë kohe shikuam njëri-tjetrin dhe dhamë përgjigje të ndryshme. Njëri thoshte “ibadeti”, tjetri “xhihadit” e kështu me radhë. Profesori ynë na tha se të gjitha përgjigjet që kishim dhënë ishin të sakta, por duhej parë më në përgjithësi jeta e të Dërguarit të Zotit (s.a.s.) dhe shtoi:

“Veçoria që bie më shumë në sy, kur shikohet në tërësi jeta e Profetit tonë të dashur (s.a.s.), është **istikameti**.” Realisht, ishim shokuar. Në fakt, ashtu është. Hz. Muhamedi, ishte shëmbëlltury e njerëzimit për “istikametin”, si para shpalljes, ashtu edhe pas shpalljes.

Vetë kuptimi i fjalës “istikamet” e shpjegon këtë. Nga arabishtja, *istikame* do të thotë të ngrihesh në këmbë, të qëndrosh drejt, të ngrihesh (për ujin) etj. Pra edhe kuptimi etimologjik i fjalës, përfshin “të qenët i qëndrueshëm në çfarëdolloj vendi apo situatë”. Po ashtu edhe fjala *ikame*, që rrjedh nga e njëjta fjalë, do të thotë: “Të ngrihesh në këmbë, të vazhdosh diçka dhe të vendosesh diku.” Të bësh *ikame* në namaz, do të thotë gjithashtu “të vazhdosh namazin dhe të mos e ndërpresësh atë”. Komentatorët e Kuranit e kanë sqaruar ajetin “**bëjeni ikame namazin**”, duke bërë paralelizëm me ajetin “**Namazi të ruan nga shthurja dhe nga çdo vepër e shëmtuar**” të sures Ankebut, që do të thotë se, sipas këtij shpjegimi, qëllimi është pasqyrimi në jetë i vetëdijes së ibadetit, që krijohet gjatë kohës së namazit dhe që të vazhdohet mbi istikamet vetëdija e të qenit njeri i Zotit.

Përsa i përket fjalës *istikame*, e cila është edhe tema

jonë, kjo fjalë është në kuptimin e drejtimit në rrugën e vërtetë, të qenit i ekuilibruar dhe i drejtë, si dhe njëkohësisht është edhe në kuptimin të qenët të qëndrueshëm. Fjala “kavam”, e cila rrjedh nga e njëjta rrënjë, do të thotë “drejtësi”. Pra, istikamet do të thotë: të zbatosh urdhëresat hyjnore dhe, duke u bërë i qëndrueshëm me këtë vetëdije, shpreh vazhdimin e jetës brenda një ekuilibri dynja dhe ahiret. (Muhtar-us-sihah, f. 557 – 558.)

Nën rrezën e njohurive që jepen deri këtu, na dalin përballë tre elementët më të rëndësishëm të istikametit. Këto janë: **të qenit të qëndrueshëm, drejtësia** (ekuilibri apo rruga e mesme) dhe **orientimi i vazhdueshëm nga e vërteta**.

Të gjitha kuptimet e përbashkëta të tyre i vërejmë në jetën e Resulullahut (s.a.s.), pasi ai (s.a.s.), edhe atëherë kur ende nuk i ishte shpallur Kurani, ishte në krahun e së vërtetës dhe të së mirës. Për shembull, ai (s.a.s.), është bërë pjesë e Hilful-fudulit, pra, ka qenë pjesëtar në marrëveshjen e virtyeteve, në të cilën ka dinjitetin e tij, duke treguar qëndresë ndaj padrejtësisë. Atëherë kur ishte në krye të karvanit të tregtisë së Hz. Hatixhe (r.anha), ka shfaqur shembullin e drejtësisë dhe, si rezultat i këtyre veçorive, është njohur si “**el-Emin**”. Edhe pasi është bërë resul, nuk ka devijuar aspak nga istikameti dhe me personalitetin e veçantë shembullor të çdo gjendjeje të tij, i ka shprehur ymetit istikametin. Me këtë veçori të palëkundshme që ka shfaqur në Bedir, në Uhud, në Hendek, në Tebuk dhe në beteja të tjera, ai vazhdon të jetë shembull për ne. Ai na la pas një “**sunet**”, që do të na ndriçojë, jo vetëm në luftëra, por në çdo fushë të jetës.

Atëherë ajo që na bie përsipër të bëjmë, është të besojmë pa asnjëfarë neglizhence, sikurse ai (s.a.s.), me një istikamet të palëkundur, të vazhdojmë gjithmonë me këtë vetëdije dhe të mos e nxjerrim nga zemra jonë këtë dua: “**Zoti ynë, jepna istikamet!**” Amin!

Çfarë përfitoi njerëzimi prej tij?

Dr. Rexhep Osdirek

Hz. Muhamedi është dërguar në një kohë kur njerëzimi ishte në depresion. Ai i rregulloi projektoren njerëzimit, që po shkonte drejt falimentimit dhe vetasgjësimit. Kushdo, që sado pak merr informacion rreth jetës, veprimtarisë së tij dhe rreth asaj çfarë ai i solli njerëzimit, mbetet padyshim i impresionuar prej tij. Natyrshëm, ata që mendjen dhe zemrën i kanë të zëna nga rrjeta e fanatizmit, nuk kanë çfarë të përfitojnë prej tij. Ç'dobi ka drita për ata që kanë burgosur veten e tyre në errësirat më të thella të injorancës. Ajo çfarë përfitoi njerëzimi nga Muhamedi (a.s.), nuk mund të përshkruhet. Ne po shkëpusim vetëm ca pjesëza të vogla:

1. Muhamedi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, është themeluesi i Qytetërimit Islam. Në shoqërinë, tregtinë, artin, ekonominë, arkitekturën, muzikën dhe në çdo pjesë të Qytetërimit Islam, mund të vërehen gjurmët, fjalët e arta dhe ndikimi i tij i ndritur. Në themelet e solidaritetit, vëllazërisë dhe humanitetit të asaj shoqërie mund të vëreni vëllazërinë që ka krijuar Muhamedi, alejhis-selam, mes ensarëve dhe muhaxhirëve. Të gjithë njerëzit me emrat Ahmet, Muhamet, Mehmet, Mahmud dhe Mustafa, janë një manifestim i dashurisë që kanë pasur prindërit e tyre për Muhamedin (a.s.).

2. Një prej gjërave më të rëndësishme që myslimanët i mësuuan njerëzimit, është higjiena. Megjithëse Muhamedi (a.s.), jetonte në një zonë ku uji kishte vlerën e floririt, për arsye se gjendej shumë pak, solli një fe që e ka bazë marrjen e abdestit për t'u falur pesë herë në ditë. Ndaj dhe besimtari, duhet të marrë abdest çdo kohë të namazit ose duhet të mbajë abdestin deri në kohën tjetër të namazit dhe të bëjë kujdes higjienën e tij. Megjithë këtë vlerë që kishte uji, i kushtojmë mjaft kujdes edhe ndaj shpërdorimit të tij. Porosia: *"Mos e shpërdorni ujin, edhe sikur të jeni pranë një lumi"*, as ambientalistëve të sotëm nuk u shkon në mendje. Me këtë, ai ka sinjalizuar myslimanët e së ardhmes. Higjiena

e dhëmbëve është një prej pastërtive që Muhamedi, alejhis-selam, i mësoi njerëzimit. Para tij, njerëzit nuk e njihnin këtë higjienë. Stomatologët e sotëm nuk kanë se ç'bëjnë tjetër, veçse të përkulen me respekt para kësaj përpjekjeje të tij para 15 shekujsh.

3. Muhamedi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, arriti të krijojë një shoqëri të shkencës dhe gnosës (irfan), nga një popull analfabet dhe injorant, që nuk kishte shkollë, bibliotekë e as libër, nomadë dhe gjysmë nomadë që jetonin në shkretëtirë mes skamjes dhe pamundësisë. Komunikimi i parë i Allahut të Madhëruar me Muhamedin (a.s.), ishte në formën **"Lexo!"**. Ndaj dhe leximi, shkrimi, arsimimi dhe edukimi janë bërë karakteristikat kryesore të kësaj feje. Hz. Muhamedi ka thënë: *"Dituria është obligim për çdo mysliman"*. Myslimanët, për të respektuar këtë urdhër, u treguan mjaft rigorozë ndaj studimit, arsimimit dhe edukimit. Sufja, që gjendej pranë xhamisë së Profetit, ishte shkolla e parë e myslimanëve. Pejgamberi (a.s.), aty edukoi studentët më me fat të të gjitha kohëve, që ishin sahabët e nderuar. Myslimanët që ndoqën rrugën e ndritur të tij, pranë xhamive të qyteteve që kishin ndërtuar apo marrë, ndërtuan shkolla dhe biblioteka të tëra. Në këto shkolla, krahas diturive fetare mësoheshin edhe shkenca të tjera, si: mjekësia, gjeografia, matematika, astronomia etj. Myslimanët që e morën si një udhërrëfyes shprehjen e tij *"Diturinë duhet shkuar për ta marrë, qoftë edhe në Kinë"*, kanë garuar për të mbledhur trashëgiminë shkencore të kohës.

4. Muhamedi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, njëkohësisht është themelues i një shteti. Ai themeloi shtetin islam brenda një kohe të shkurtër prej 23 viteve, por ky shtet vazhdoi për shekuj me radhë.

5. Muhamedi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, është dalluar edhe si drejtues. Rreth tij ishte një ushtri e tërë që e donin më shumë se veten e tyre. Në themelin e kësaj lidhjeje ishte

dashuria dhe besimi. Për këtë arsye, shumë liderë i realizojnë me vështirësi, me forcë dhe me dhunë idetë e tyre, kurse Muhamedi (a.s.), këtë e ka bërë me dashuri dhe me respekt. Ai u është drejtuar me respekt dhe dashuri të gjithë sahabëve, pa bërë dallim mes meshkujve dhe femrave, mes të pasurve dhe të varfërve, mes arabëve dhe joarabëve, ai e donte secilin prej tyre. Si përgjigje e kësaj dashurie, ata bënëin çdo dëshirë të tij.

6. Muhamedi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, në një kohë që lidhja e gjakut ishte mjaft e rëndësishme, i mësoi njerëzimit se lidhja e besimit dhe e mendimit është më e rëndësishme. Shoqëria që ai ndërtoi, ia mësoi këtë të gjithë njerëzimit, duke e jetuar vetë. Ai kishte zgjedhur skllëvërit dhe të varfrit myslimanë, në vend të të pafeve të Mekës, që ishin të pasur dhe fisnikë. Vetë ai kishte pranuar si një anëtar të familjes së tij skllavin nga Irani, Selman el-Farisiun. Kurse xhaxhain e vërtetë të tij, Ebu Lehebin, e kishte refuzuar. Ebu Bekrin, që ishte një nga më fisnikët e Mekës, e bëri vëlla me Bilalin, skllavin nga Abisinia. Hz. Ebu Bekri e bleu Bilal Habeshiun, i cili po torturohej, ngaqë ishte skllav dhe i dha lirinë. Pas shumë vitesh, në një rast, në njërin krah kishte Ebu Bekrin dhe në tjetrin Bilal Habeshiun. Ua shtrëngoi duart të dyve dhe u tha: "Ebu Bekri është zotëria juaj, ai ka shpëtuar një tjetër zotëri tuajin." Kështu i tregoi të gjithë botës se si lidhja e besimit i lidhi këta dy njerëz.

7. Muhamedi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, njëkohësisht është edhe një komandant. Ushtria dhe ushtarët për një shtet janë të domosdoshëm. Nuk mund të mendohet ndonjë shtet në rruzullin tokësor pa ushtri dhe polici. Ndaj dhe Profeti ynë (a.s.), që ishte kryetar i shtetit islam, njëkohësisht ishte edhe kryekomandanti i ushtrisë islame. Muhamed Hamidullahu ka bërë një studim lidhur me betejat e Profetit. Në këtë punim, ai ka nxjerrë në pah një situatë shumë interesante. Betejat ishin shumë të përgjakshme, ngaqë në atë kohë luftërat bëheshin me shpatë, mburojë, shtizë e shigjetë. Ushtria që humbiste në luftë, vritej e gjitha, bëhej një masakër e vërtetë. Thuaje nuk lihej njeri i gjallë nga kundërshtarët. Kur bën krahasimin mes luftërave të asaj kohe dhe luftërave ku merrte pjesë edhe Profeti ynë (a.s.), Hamidullahu vërteton se ishin krejtësisht të ndryshme. Në betejat ku Profeti ynë (a.s.), ishte komandant, si nga radhët e myslimanëve, ashtu edhe nga radhët e kundërshtarëve, të vdekurit ishin shumë të paktë, krahasuar me rezultatet e luftërave të tjera të kohës.

8. Muhamedi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, njëkohësisht ishte edhe kryetar shteti. Kryetarët e shteteve përgjithësisht ishin njerëz që përdornin pasurinë shtetërore për interesat vetjake dhe jetonin në një luks dhe pasuri të paimagjinueshme. Kurse Muhamedi, alejhis-selam, jetonte si më i varfri i popullit. Hz. Aisheja (r.a.), tregon kështu kohën e Profetit: "Nganjëherë kalonin edhe tri ditë që në shtëpinë e Muhamedit (a.s.), nuk ndizej oxhaku për të bërë diçka për të ngrënë. Ajo çfarë kishim për të ngrënë, ishte vetëm një hurm i thatë ose një copë buke prej elbi."

9. Muhamedi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ishte dërguar

për të përsosur edukatën e bukur. Ai e përsosi këtë edukatë me jetën e tij dhe me brezin shembullor që kishte edukuar pranë vetes. Ne myslimanët, mësuam nga ai të ulemi, të ngrihem, të ecim, të hamë, të pimë, komunikimin me njerëz, të flemë, të zgjohemi dhe gjithçka tjetër që mund të bëjmë gjatë jetës. Ai na mësoi mirësjelljen me njerëzit. Vetëm ato çfarë shpjegoi ai lidhur me mirësjelljen, mjaftojnë për të kuptuar se ishte njeriu më i madh i tëra kohëve.

10. Ai i mësoi njerëzimit për të drejtat e skllëvërve, që trajtohehin si kafshë, duke i shtypur dhe dhunuar. Në shoqërinë islame, skllëvërit nuk janë shtypur e as që janë torturuar. Liria e tyre është urdhëruar në forma të ndryshme dhe është bërë një përpjekje e madhe në këtë pikë.

11. Muhamedi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, i dha femrës të drejtën që meritonte. Në një kohë kur femra konsiderohej si e klasës së ulët, diskutohej gjoja shkencërisht dhe intelektualisht nëse ka apo nuk ka shpirt; është apo nuk është njeri, Muhamedi (a.s.), kishte shtrirë nën këmbët e nënave xhenetin, duke thënë "*Xheneti ndodhet nën këmbët e tyre*". Zonjat myslimane janë shtylla kurrizore e qytetërimit islam dhe aorta e shoqërisë islame. Qëllimi i ndalesës së marrëdhënieve seksuale jashtë kurore, ndalesës së shpifjes ndaj femrës së ndershme, obligimit për mbulesën e saj dhe i shumë gjykimeve të tjera hyjnore, janë për të shmangur mendimet dhe veprimet e shëmtuara ndaj femrës myslimane. Ndërkohë që, para ardhjes së Profetit (a.s.), ardhjen në jetë të një vajze njerëzit e konsideronin si fatkeqësi, ai i konsideronte femrat si një mënyrë e lehtë dhe e bukur për të hyrë në xhenet, duke thënë: "*Kush ka tri vajza ose tri motra, dy vajza ose dy motra, nëse i trajton mirë ato dhe ka frikë nga Zoti për çdo gjë lidhur me to, si shpërblim të kësaj ka xhenetin.*" (Ebu Davud, Edeb, 130.)

12. Muhamedi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka vendosur ligjin islam, e ka praktikuar në popullin e tij dhe ka sjellë shoqërinë më të kujdesshme në botë ndaj të drejtave dhe ligjeve. Ligji islam nuk i është drejtuar vetëm mendjes së njeriut, por edhe aspektit të tij shpirtëror. Ndërkohë që njerëzit e sotëm shkelin ligjin aty ku nuk i sheh apo i njuh njeri, myslimanët e asaj kohe bënëin një përpjekje të madhe për të zbatuar ligjin islam, jo vetëm kur dhe ku nuk gjendej ndonjë autoritet i shtetit, por edhe në situata krejtësisht të veçanta dhe private. Çdo njeri është i barabartë për të zbatuar ligjet që ka sjellur Islami. Ndërkohë që disa njerëz po përpiqeshin të ndërhyjnë për t'i falur apo lehtësuar dënimin për prerjen e dorës për vjedhje një femrës, ngaqë ishte nga një fis fisnik, siç ishin Kurejshitë, Muhamedi (a.s.), i dha mësim tërë njerëzimit duke thënë: "*Sikur këtë faj ta kishte bërë edhe vajza ime, Fatimja edhe asaj do t'ia prisja dorën*".

Lidhur me Muhamedin, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, mund të vazhdonim të flisim shumë gjatë. Sa bukur që e ka lëvdur vetë Zoti atë: "**Ne nuk të kemi dërguar ty (o Muhamed), veçse si mëshirë për botët.**" Me ardhjen e tij, bota ka marrë nga mëshira e tij dhe kështu ka gjetur veten.

Rënkova shumë

Hatixhe Ezkan

*Unë kam rënkuar
në çdo shoqëri, jam bërë shok
me atë që kishte
cilësi të këqija dhe me atë
që kishte cilësi të mira.*

Në këto vargje, Hz. Mevlana vazhdon ta vërë fyellin në rolin e folësit. Në të vërtetë, është njeriu i përsosur ai që flet. Është vetë njeriu, ai që rënkon dhe që kërkon zgjidhje. Historinë e fyellit e kemi shpjeguar në bejtet e mëparshme. Le të kujtojmë shkurtimisht se çfarë thotë fyelli. Së pari dëgjo... Dëgjo, që të kuptosh. Kupto, që të flasësh.

Sikur nuk ishte një bisedë ajo që kërkohej për t'u dëgjuar.

Ajo ishte një klithmë që shprehte pikën e fundit të dhimbjes. Dhimbja ishte ndarja që të gjithë janë të paaftë ta perceptojnë. Një ndarje shumë e hidhur. Ajo ishte ndarja nga Zoti, nga esenca dhe nga vetja jonë. Mallëngjimi për atdheun ia dogji zemrën njeriut. Tashmë, vuajtjet e kurbetit po i vinin shumë rëndë. Ai që ka halle të rënda, fjalët i ka shumë të urta. Imam Rabbani thoshte:

"Çdo dëshirë e madhe lind nga një hall i madh." Sprovat dhe fatkeqësitë që vijnë nga Allahu, e afrojnë njeriun te Allahu. Durimi ndaj këtyre vuajtjeve është argument për nënshtrimin ndaj Allahut. I Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, ka thënë:

"Të thuash se e dua Allahun, është një pohim. Vërtetimi i këtij pohimi, është durimi ndaj sprovave dhe fatkeqësive. Të thuash se e dua Pejgamberin, edhe ky është një pohim. Vërtetimi i këtij pohimi, është durimi ndaj sprovave dhe vështirësive." Sprovimet dhe fatkeqësitë më të mëdha, Allahu Teala ua ka dhënë profetëve, sepse fatkeqësitë nuk e lejojnë njeriun t'i hedhë sytë nga dynjaja.

Fatkeqësitë e angazhojnë njeriun vetëm me Allahun. Shiu i sprovave, pas pejgamberëve, bie mbi njerëzit e përsosur dhe mbi evliatë (njerëzit e dashur të Allahut). Përsosmëria është një proces që vazhdon duke përballuar vuajtjet.

Për të biseduar, nuk mjafton vetëm të dish. Njerëzit e papjekur mund t'u mësojnë dije njerëzve të tjerë në shoqëri, por nuk mund t'i përsosin ata, sepse ata nuk e kanë arritur të fshehtën "isha i papjekur, u poqa dhe u dogja". Për këtë arsye, ata nuk mund të tregojnë udhë dhe nuk mund të zgjidhin

probleme. Hallet figurative, janë një derë e hapur ndaj hallit të vërtetë. Mexhnuni së pari tha "Lejla", pastaj tha "Zoti". Të vuash për Allahun, është shumë ndryshe nga hallet e tjera.

Dëshira për të shpëtuar nga hallet e kësaj bote, përsëri lind nga një dëshirë vetjake apo dëshirë e kësaj bote. Kur halli bëhet hall i njeriut, ai fiton një dimension shumë sublim. Çfarë detyre më të lartë mund të ketë (halli), sesa fakti që bëhet shkak për t'i rregulluar marrëdhëniet e njeriut me Zotin e tij?

Të Dërguarit të Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, i ka ardhur shpallja e parë në shpellën Hira. Kur e pa Xhebrailin, alejhisselam, në formën e tij të vërtetë, u frikësua dhe shkoi në shtëpi. Nënës sonë, Hazreti Hatixhes, radijallahu anha, i tha: "Më mbuloni! Më mbuloni!" Pas shpalljes së parë, përjetoi kohën e fetretit (ndërprerjes së shpalljes).

Edhe pse disa dijetarë thonë se ka zgjatur tre vjet, mendimi më i zgjedhur është ai që thotë gjashtë muaj. Përgjatë kësaj kohe, Allahu Teala e bëri të dashurin e tij ta mbartë shpalljen hyjnore. Sipas mendimit të shumicës së dijetarëve, pas periudhës së ndërprerjes së shpalljes, ajetet e para që zbritën, ishin ajetet e para të sures el-Muddeththir. Në këto ajete, Allahu i Madhëruar, thotë:

"O ti i mbështjellë!"

"Çohu dhe paralajmëro!" (el-Muddeththir 1-2.)

I Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, i cili u rrit me vuajtje që nga fëmijëria, u sprovua me hallin më të madh. Atij iu dha profetësia. Në qafë iu hodh litari i një halli që nuk mbaronte, derisa të ndërronte jetë. Para se të fillonte këtë detyrë, Zoti (xh.xh.), e përgatiti atë dhe e urdhëroi të ishte i vendosur.

"Madhëro vetëm Zotin tënd!" (el-Muddeththir 3.)

Kuptimi i fjalës "mbështjellje", siç mund të jetë shtrirja në shtrat e të Dërguarit të Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, ngaqë kishte shumë vështirësi për shkak të shpalljes, është pastrimi dhe shpëtimi nga çdo gjë që mbulon dhe pengon shërbimin për hir të fesë së Allahut (xh.xh.).

Allahu i Madhëruar i ka thënë Davudit, alejhisselam:

"O Davud! Më duaj mua! Duaji ata që më duan mua dhe bëji robërit e mi që të më duan!"

Davudi, alejhisselam, u përgjigj kështu:

"O Zoti im! Ty të dua. Po ashtu i dua edhe ata që të duan, por si t'i bëj robërit e tu të të duan?"

Allahu Teala i tha:

"Tregoju robërve të mi, argumentet, mirësitë dhe sprovat që mund t'u bëj atyre. O Davud! Nëse ndonjëri prej robërve e ndihmon dikë që i është bërë padrejtësi (nëse përpiqet ta mbrojë në çështjen e padrejtësisë që i është bërë), do t'ia forcoj këmbët në rrugën e drejtë, ditën kur ato rrëshqasin."

Të gjithë pejgamberët dhe trashëguesit e tyre, do të vazhdojnë të flasin, të rënkojnë dhe të bërtasin, derisa të ndodhë kiameti, në mënyrë që t'i bëjnë njerëzit ta duan Allahun Teala. Edhe Hazreti Mevlana, i cili ishte njëri prej atyre që e harxhoi gjithë jetën e tij në këtë rrugë, flet në këtë bejt për rënkimin. Të rënkosh, do të thotë të flasësh në dhimbje dhe brengosje.

Në rënkim ka një dëshirë të madhe për t'u kuptuar. Në rënkim ka dhembshuri dhe mëshirë. Për këtë arsye, rënkuesit nuk i rënkon rregullimi i fjalive apo mënyra e të shprehurit, por zemra dhe shpirti. Një njeri që ka arritur këtë gjendje, nuk mund të bëjë ndarje ndërmjet njerëzve.

Gjendjet dhe fjalët e disa njerëzve, gjithmonë u kanë ardhur të çuditshme njerëzve të tjerë. Njerëzit e tillë, kur ishte vendi dhe koha e duhur, kanë hyrë në vende ku bëhej mëkat e ndërmjet njerëzve që bëjnë mëkate dhe u kanë folur për Allahun e Madhëruar. Hazreti Mevlana, i cili shprehet

se ka rënkuar në çdo shoqëri, gjithmonë ka vepëruar sipas rregullit "e dua krijesën për hir të Krijuesit".

Kur njerëzit luftonin në kohërat e kaluara, kurrizin e mbështesnin te një gur i madh, për t'u mbrojtur nga çdo lloj sulmi që mund të vinte nga pas. Me kalimin e viteve, guri ku mbështetej kurrizi, u quajt "guri i kurrizit" (shok). Me atë që nuk ka shok, nuk mund të qahen hallet. Po ashtu, atyre nuk u dëgjohen këshillat. Kur Hazreti Mevlana thotë se "jam bërë gur i kurrizit", synon këtë:

"Ata nuk i pashë si njerëz të larguar nga mëshira e Allahut. Allahu mund t'i falë çdo çast me mëshirën e tij të pafundme. Jo vetëm që i fal, por i bën edhe miq. Ku mund ta di unë se si do të jetë gjendja e këtyre mëkatarëve! Atëherë, atyre u vendos kurrizin dhe i mbështes. Unë bëj predikimin dhe thirrjen, ndërsa udhëzimin e pres nga Allahu Teala.

"Tregoju robërve të mi, argumentet, mirësitë dhe sprovat që mund t'u bëj atyre. O Davud! Nëse ndonjëri prej robërve e ndihmon dikë që i është bërë padrejtësi (nëse përpiqet ta mbrojë në çështjen e padrejtësisë që i është bërë), do t'ia forcoj këmbët në rrugën e drejtë, ditën kur ato rrëshqasin."

A e përliqj qëllimi aktin

Bynjamin Zeran

Degjenerimi i mendimit e tërheq drejt tatëpjetës njeriun dhe arritjet e tij të deriatëhershme. Degjenerimi i mendimit të njeriut ka disa shkaqe. Një nga shkaqet e këtij degjenerimi është edhe mendimi absurd “qëllimi është i mirë, e rëndësishme është çka është në zemër”. Mendim, i cili shërben si parim për formimin e gjykimit apo opinionit për shumë njerëz. Të gjitha mendimet pretendojnë se ofrojnë alternativën më të mirë. Të gjitha ideologjitë e njerëzimit që përmbajnë “izma”, pretendojnë më të mirën. Kurse fetë hyjnore, në aspektin e vërtetësisë dhe saktësisë janë përtej “izma-ve”. Dhe nga fetë hyjnore që predikon me zë të lartë të vërtetën, është feja islame, sepse burimi dhe metoda e fesë islame janë hyjnore. Referencat që përdor feja, janë fjalë të Allahut të komunikuar përmes profetëve. Prandaj, Islami nuk mjaftohet vetëm me qëllimin e mirë. Qëllimi i një veprimi të gabuar, sado i mirë qoftë, në Islam nuk lejohet, sepse, nëse shkelet një herë kufiri në emër të qëllimit të mirë, atëherë nuk mund të bëhet fjalë për kufijtë e Allahut. Shembujt nga Kurani janë të shumtë, në mbështetje të kësaj që thamë. Por këtu do mjaftohemi duke e konkretizuar çështjen vetëm me dy shembuj. Një herë, kur Pejgamberi (a.s.), po u predikonte Islamit aristokratëve të Mekës, vjen aty pranë Abdullah Ummu Mektum, duke i kërkuar Pejgamberit (a.s.), t’i tregonte për fenë islame, por Pejgamberi nuk i kushtoi vëmendje dhe vazhdoi të fliste me aristokratët e Mekës. Sepse, nëse paria e Mekës pranonte fenë, Islami forcohej më shumë dhe rruga drejt suksesit përfundimtar bëhej më e lehtë, kurse pranimi i Islamit nga një njeri i verbër nuk sillte ndonjë përfitim apo kontribut në suksesin e mëtejshëm të fesë. Një mendim mjaft qëllimshëm dhe i mirëlligjor. Por

nuk vonoi qortimi, madje i rëndë, i Allahut për Pejgamberin (a.s.). Pse? Sepse do t’i predikosh Islamit vetëm atij që dëshiron. Sepse përfundimi i saktë arrihet me metodë të saktë. Metoda është po aq e rëndësishme sa edhe përfundimi. Shembulli i dytë është rasti i Nuhit. Nuh (a.s.), u lut për djalin e tij. Një veprim me një qëllim shumë fisnik, por përsëri merr qortim nga Allahu, sepse, megjithëse qëllimi është i mirë, qëndrimi nuk i përshtatet shpalljes. Në këtë mënyrë, Kurani na tërheq vëmendjen në rëndësinë e përputhshmërisë së qëllimit me shpalljen hyjnore. Pra, nuk është vetëm qëllimi i rëndësishëm, po aq i rëndësishëm është edhe akti, madje në pikëpamjen e vërtetimit të qëllimit, është edhe më i rëndësishëm.

Kjo sëmundje është shumë e përhapur në mesin e shoqërisë sonë. “Mos shiko se nuk fal namaz, zemrën e kam shumë të pastër, kjo është e rëndësishme.” Fjalë të tilla i dëgjojmë shpesh nga miqtë dhe të afërmit tanë. Por ata nuk e kuptojnë që moskryerja e namazit është shenjë hipokrizie. Sepse këta njerëz janë ushqyer me mendimin se për të hyrë në xhenet, mjafton zemra e pastër. Ky mendim është jashtë perceptimit Islam mbi tevhidin. Besimi i zemrës së pastër që dominon tek njerëzit, po i shtyn drejt humbjes së ndjeshmërië ndaj Allahut dhe ibadeteve. Me këtë mendim, njerëzit po përliqjin çdo skandal që bëjnë. Sepse, sipas këtij mendimi, e rëndësishme është zemra. Por Allahu e konsideron të padrejtë këtë.

Një nga gabimet e bëra në të kaluarën, në emër të qëllimit të mirë, ka qenë edhe përqendrimi tek përfundimi. Sipas këtij mendimi, sheriatit i Allahut duhet vendosur mbi tokë me çfarëdo mjeti apo mënyre.

Metodat e përdorura për vendosjen e shtetit shariatik nuk para diskutoheshin. Nuk ishte shumë e rëndësishme çrrënjësia e besimeve të gabuara përmes daveetit (thirjes), por përhapja e kufijve të shtetit, ndërkohë që një pjesë e mirë e shoqërisë vazhdonte e zhytur në besime të gabuara. Kurse Allahu në Kuran, i jepte përparësi një shoqërie që urdhëronte për mirë dhe pengonte nga e keqja. Shoqëria dhe ata që drejtonin shoqërinë, përvetësuan një sërë idesh që binin në kundërshtim me Kurandin. Një shembull konkret i kësaj, është revolucioni islamik i Iranit. Fanatikët shia, në emër të mbrojtjes së institucioneve, shkelën një sërë çështjesh themelore të fesë. Këtë ide, por në versione të ndryshme, po e organizojnë shumë fondacione, organizata dhe shoqata, të cilat në emër të qëllimit të mirë, po shkelin mbi disa tema themelore të fesë islame. Prandaj, jemi të detyruar që qëllimin dhe metodën ta bëjmë islame, përndryshe do vazhdojmë të kryejmë një sërë veprash me mendimin se janë të sakta dhe të vlefshme, por që në ditën e gjykimit nuk do të kenë asnjë vlerë. Asnjë besimtar i vetëndërgjegjshëm nuk do dëshironte të përballej me një situatë të tillë në ditën e gjykimit. Parimi "veprat vlerësohen sipas qëllimit", tregon se adresa e qëllimeve është Islami dhe veprimet nuk mund të bien ndesh me këtë adresë. Pra, metoda dhe përfundimi nuk mund të kundërshtojnë njëra-tjetrën.



Një nga shkaqet e humbjes së destinacionit fillestar të shumë organizatave islame, është keqpërdorimi i qëllimit, thënë ndryshe, përdorimi i qëllimit të mirë si pretekst për të justifikuar një veprim që bie në kundërshtim me fenë. Dëshmori Sejjid Kutub, kur tha "Siç është hyjnore kjo fe edhe metoda e saj duhet të jetë hyjnore", u nis nga disa veprime negative të konstatuara nga ai në disa organizata islame që ushtronin aktivitet në atë kohë në Egjipt. Përdorja e metodave joislame ka çuar në përligjien e shumë veprimeve joislame. Nëse besimtarët vazhdojnë kështu, fillojnë të flasin me gjuhën e skicuar për ta. Por gjuha e modernizmit është gjuhë pragmatiste/utilitariste. Kurse gjuha e Islamit është themeluar mbi parimin e Tevhidit. Përpara duhet ecur me metodat dhe veprimet e përcaktuara nga vetë sistemi. Besimtarët nuk i mbështesin veprimet e tyre mbi sisteme joislame, sepse e dinë që kjo nuk sjell sukses. Suksesi është i

sigurt vetëm përmes rrugës së treguar nga Allahu në Kuran. Përpjekja për të krijuar hapësira me një mendësi pragmatiste, sjell me vete miratimin, komplimentet dhe servilizmin ndaj atyre që kanë pushtetin, i cili është despotik, madje edhe mbështetjen e tyre për përfitime. Kurse besimtari nuk e mbështet despotizmin dhe padrejtësinë, sepse është haram për besimtarin ky veprim.

Besimtarët duhet të jenë shumë të vëmendshëm përballë këtyre nismave të rrezikshme, që synojnë transformimin e besimtarëve dhe krijimin e një gjendjeje kaosi në përdorimin e qëllimit për të përligjur veprimet e ndaluara sipas Islamit. Besimtarët nuk duhen gënjyer nga fshehja e veprimeve pas qëllimeve.

Në fakt, veprat që shprehin vazhdimësi e nxjerrin në pah qartë qëllimin e personit. Përndryshe, nëse vazhdojmë të përligjim veprat tona me justifikimin se qëllimet janë të mira, atëherë shumë shpejt do ta shohim veten jashtë rrugës sonë.

Shumë shkarje të fundit janë bërë si pasojë e pragmatizmit dhe keqpërdorimit të qëllimit. Nëse qëllimet dhe aktet nuk përputhen me njëri-tjetrin, atëherë do të ndodhin shkarje akoma më të mëdha. Në metodën profetike ka predikim të vazhdueshëm dhe durim, nuk ka numra, numrat janë relativë. Në Islam ekzistojnë kufijtë e Allahut, të cilët duhen respektuar. Çdo individ do t'i dalë për zot kufirit që i është përcaktuar. Islami më tepër preferon të vazhdojë rrugën me një person me besim të drejtë, sesa një turmë të madhe, por të thatë. Mjafton që ky person t'i kryejë me rigorizitet përgjegjësitë e veta. Allahu i jep sukses këtij personi, sepse ai nuk flet me gjuhën e modernizmit, e cila karakterizohet nga pragmatizmi. Ai është plotësisht i vetëdijshtë se, sado i mirë të jetë, qëllimi nuk e justifikon veprimin.

"Atij që shmanget nga Këshilla e të Gjithëmëshirshmit (Kurani), Ne do t'ia caktojmë një djall, që do t'i bëhet shok i pandashëm. Në të vërtetë, djajtë i shmangin jobesimtarët nga rruga e drejtë, ndonëse ata mendojnë se janë të udhëzuar drejt. Dhe, kur të vijë te Ne, (jobesimtari) do t'i thotë (djallit që e kishte shok): "Ah, sikur të kishte qenë largësia midis meje dhe teje sa ajo mes lindjes e perëndimit! Sa shok i keq paske qenë ti!" (Zuhruf, 35/36/37.)

El Haku Mutekathur

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit, Allahut të Vetëm, pa shok e falënderojmë dhe vetëm prej Tij ndihmë dhe falje kërkojmë. I lutemi të na ruajë nga e keqja, e cila nuk është gjë tjetër vetëm pasojë e vetes dhe e veprave tona. Atë që Allahu e udhëzon në rrugë të drejtë, nuk ka kush ta devijojë prej saj dhe cilindo që devijon nga udha e drejtë, nuk mund ta udhëzojë askush, përveç Allahut (xh.sh.). Dëshmoj dhe deklaroj se nuk ka të adhuruar më të drejtë përveç Allahut të vetëm dhe të pa shok, dëshmoj dhe deklaroj se Muhamedi është rob i Zotit dhe i Dërguarit të Tij, paqja mirësitë, begatitë e Allahut qofshin mbi të dhe mbi të gjithë ata që ndjekin rrugën e tij deri në ditën e Gjykimit.

Allahu (xh.sh.), u drejtohet myslimanëve në Kuran, kur thotë: ***“O ju që keni besuar! Frikësojuni Allahut, ashtu siç e meriton Allahu t’i frikësoheni dhe vdekja t’ju gjejë vetëm duke qenë myslimanë.”***

Gjithashtu, Allahu (xh.sh.), apelon mbarë njerëzimin, kur thotë: ***“O njerëz! Frikësojuni Zotit tuaj, i cili ju krijoi prej një veteje të vetme, prej tij krijoi bashkëshorten dhe prej të dyve bashkë krijoi shumë burra dhe gra. Frikësojuni Allahut, me emrin e të cilit përbetoheni, ruajini lidhjet farefisnore midis jush. Padyshim, Allahu është mbikëqyrës mbi ju.”***

Gjithashtu Allahu (xh.sh.), veçon besimtarët myslimanë në Kuran, kur thotë: ***“O ju që keni besuar, frikësojuni Allahut dhe flisni vetëm mirë dhe drejt. Nëse do të flisni mirë dhe drejt, Allahu (xh.sh.), do t’ju falë gjynahet dhe do t’ju mundësojë të kryeni vepra të mira. Kush i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij, Muhamedit (s.a.v.s.), padyshim që do të fitojë lumturinë e vërtetë.”***

Kur njeriu lind, me të lind edhe libri i jetës së tij. Ai libër është i bardhë dhe është njeriu, i cili e nxin atë me të mirat ose me të këqijat. Në të shkruhet çdo gjë që njeriu bën në jetën e kësaj bote, prej fjalëve, shprehjeve dhe sjelljeve. Allahu (xh.sh.), tregon në Kuranin Famëlartë se jeta e kësaj bote funksionon nën moton: Allahu është Zoti i vetëm dhe i vërtetë, i Cili meriton adhurimin dhe askush përveç Tij nuk meriton të adhurohet. Ai do t’ju bashkojë, do t’ju ringjallë dhe do t’ju mbledhë përsëri në Ditën e Gjykimit, për të cilën nuk ka dyshim.

Njeriu gjatë gjithë jetës së tij, zhvillohet në shtatë faza. Tri janë jashtë mundësisë së njeriut për t’i arritur dhe kuptuar. Edhe tri të tjerat janë jashtë njeriut për t’i arritur dhe kuptuar.

Bota e parë ose momenti i parë, momenti i mosekzistencës, momenti i dytë është momenti i krijimit të shpirt-rave, momenti i tretë është momenti i krijimit të njeriut në barkun e nënës, momenti i katërt është jeta e kësaj bote, për të cilën Zoti (xh.sh.), thotë: ***“Zoti është Ai, i cili krijoi jetën dhe vdekjen për t’ju provuar.”*** Më pas vjen bota e pestë, që është bota e varrit, pastaj vjen bota e gjashtë që është bota e Ditës së Gjykimit dhe e daljes përpara Zotit (xh.sh.) dhe momenti i fundit, ku një grup njerëzish do të përfundojnë në Xhenet dhe pjesa tjetër do të përfundojë në Xhehenem, Zoti na ruajtë të gjithëve prej tij. Allahu (xh.sh.), angazhimin e njeriut në jetën e kësaj bote e ka përzgjedhur në një kapitull Kuranor, që quhet El Tekathur: “Angazhimi i njeriut në shumim”.

E kemi parë njeriun kudo tek ecën e mbledh si ajo milingona e pangopur, punon e rropatet, shet dhe blen, ruan dhe nuk harxhon, madje kërkon t’i ruajë diku gjetkë, atje ku nuk ia merr askush, që nga poshtë jastëkut e deri në bankë, por atje si për mallkim nga Zoti për kamatën, i ndodh shpesh të mos ngopet sërish dhe sërish e shikon tek përballet me mundësi e pamundësi, si dhe ku, vetëm të “shtojë”.

Njeriu do të angazhohet me çdo gjë dhe ky lloj angazhimi e privon atë nga adhurimi i Zotit (xh.sh.). Ky angazhim është i urryer, edhe pse në pamje të jashtme duket sikur është i pëlqyeshëm. Çdo lloj angazhimi, çdo lloj preokupimi i njeriut në jetën e kësaj bote, që bëhet shkak të harrojë Zotin, të harrojë se ka një ditë kur do të dalë përpara Zotit, të harrojë se ka Melaike që shkruajnë në të djathtën dhe në të majtën e tij, të harrojë se kjo tokë mbi të cilën shkel nuk është gjë tjetër vetëm se një mirësi e Zotit dhe një ditë do të dëshmojë për njeriun ose kundër tij dhe harron që ky qiell, i cili është kupolë për të dhe për gjithçka, do të jetë një ditë dëshmi për të ose dëshmi kundër tij dhe harron se ky trup i tij dhe kjo lëkurë e tij, ky mish i tij dhe kockë e tij një ditë do të jenë dëshmitarë për të ose kundër tij.

Çdo angazhim që e largon nga Zoti (xh.sh.), nuk është gjë tjetër vetëm se humbje, edhe nëse është i hajrit në pamje

të jashtme. Për këtë arsye, themi se esenca dhe parimi bazë i besimit është pastrimi i zemrës dhe i shpirtit, singëriteti, çiltërsia ndërmjet robit dhe Zotit (xh.sh.). Transmetohet se njëri prej nxënësve të Jahja Ibnu Mainit thotë: "Iu vura një hadithi për të zbuluar rrugët e transmetimit dhe e nxora këtë hadith nga dyqind transmetime, dyqind rrugë. U kënaqa me veten time, sepse m'u duk sikur kisha bërë diçka të madhe. Atë natë në ëndërr m'u shfaq profesori im dhe më tha: «Filan Hadith e ke mbledhur nga filan zinxhir, nga dyqind transmetime, nga dyqind rrugë» I thashë po. Qëndroi pak dhe pastaj tha: «Kam frikë se të ka përfshirë thënia e Zotit (xh.sh): *El Haku Mutekathur*. Ju angazhoi dëshira për shtim dhe grumbullim ndaj Zotit (xh.sh.) dhe kënaqësisë së Zotit (xh.sh.)»". Normalisht, njeriu më shumë angazhohet në jetën e kësaj bote me grumbullimin e pasurisë. Deri këtu nuk ka asgjë të keqe. Sepse dashuria për pasuri dhe për shtimin e pasurisë është pjesë e natyrës së njeriut. Dhe natyrën e mbledhjes dhe grumbullimit njeriu e fillon qysh në momentin e parë që del nga barku i nënës. Vetëm një moment shihet njeriu me duar të hapura: atëherë kur largohet nga jeta e kësaj bote.

Abdullah Ibnu Shekir, një prej shokëve të Pejgamberit (s.a.v.s.), thotë: "Shkova një ditë te Pejgamberi (s.a.v.s.), i cili po lexonte pikërisht ajetin që thamë më lart. Pejgamberi (s.a.v.s.), tha: *El Haku Mutekathur*. Pastaj shtoi: Biri i Ademit thotë: Pasuria ime, «Pasuria ime, pasuria ime». O biri i Ademit, ty nuk të takon prej pasurisë, vetëm ajo me të cilën ushqehesh, dhe mbaron, ajo që ti e vesh dhe konsumon, vetëm se ajo që ti e jep si sadaka, lëmshë dhe bamirësi dhe Zoti ta depoziton, përndryshe do të jetë trashëgimi e trashëgimtarëve të tu." Pejgamberi (s.a.v.s.), thotë për njeriun dhe natyrën e njeriut: "Është për t'u çuditur me njeriun. Sikur të kishte një luginë të mbushur me ar, do të dëshironte të kishte bashkë me të edhe një tjetër dhe, nëse do të kishte dy, do të dëshironte të kishte dhe një të tretë. Gojën e njeriut e mbush vetëm dheu në varr." Për këtë arsye, Pejgamberi (s.a.v.s.), thotë: "Plaket njeriu, por dy cilësi ose dy veçori rino-hen vazhdimisht, vigjilenca për të grumbulluar sa më shumë dhe shpresa se do të jetojë, harresa se do të largohet nga kjo botë." Zoti në Kuran thotë: "Ju angazhoi preokupimi me grumbullim dhe mbledhje në jetën e kësaj bote. Deri kur, o Zot? Deri në momentin që vizituar varrezat."

Varri bën përshtatjen e njeriut, se njeriu kështu siç është nuk mund të kalojë direkt në botën tjetër, ka nevojë për një kohë parapërgatitjeje, ka nevojë të ushtrohet, sepse ajo është botë tjetër. Bëhet fjalë për Xhenet dhe Xhehenem, bëhet fjalë për të kënaqur krijuesin tonë, Zotin (xh.sh.).

Për këtë arsye, qëndron në botën e ndërmjetme, që quhet jeta e varrit.

Pejgamberi (s.a.v.s.), ka thënë: "Nëse vdes biri i Ademit, e shoqërojnë tri gjëra, pasuria, familja dhe veprat e tij. Dy prej tyre kthehen dhe një qëndron me të, kthehet familja, fëmijët shoqëria, njerëzit, pasuria, sepse askush nuk e ka marrë me vete dhe qëndrojnë veprat e tij. Nëse ka bërë mire, lum për të ç'farë do të jetë dhe ç'farë e pret dhe, në qoftë se nuk ka



bërë mirë, i rroftë angazhimi për trashëgimtarë.” I Dërguari i Allahut (s.a.v.s.), i këshilloi një ditë njerëzit për këtë realitet dhe i porosiste vazhdimisht: “Sikur ta dinit, o njerëz, atë që di unë, do të kishit qeshur shumë pak dhe do të kishit qarë më shumë.” Më pas Zoti (xh.sh.), u drejtohet njerëzve: “Po, do ta dini dhe do ta njihni shumë mirë, dhe përsëri po jua them. Njeriu do ta njohë, do ta kuptojë në momentin kur do të dëgjojë njerëzit që do të largohen nga varri i tij dhe do t’i vijnë dy melekë. Ose do të jenë melekë të mëshirës së Zotit (xh.sh.), që do ta pyesin me mirësi dhe rehati, do ta përshëndesin e varri i tij do të ndriçohet, melekët do ta përshëndesin me selam dhe do ta pyesin me tri pyetje e njohura, ose do t’i ngushtohet varri dhe do t’i vijnë dy melekë të zymtë dhe të errët, ngjyra e të cilëve është blu e errët, Zoti na ruajtë!”

Aty njeriu do ta kuptojë dhe, prapë do ta kuptojë më mirë në Ditën e Gjykimit, në atë moment kur njerëzit do të shohin Xhehenemin, i cili i vërsulet fushës së Mahsherit. Xhehenemi ka shtatëdhjetë e dy mijë frëre. Në çdo fre ka shtatëdhjetë e dy mijë melekë, që e mbajnë dhe do t’u vërsulet njerëzve Ditën e Gjykimit, derisa të futet në tokën e Mahsherit. Në atë moment nuk do të mbetet melek prej melekëve të Zotit, nuk do të mbetet peygamber prej peygamberëve të Zotit dhe nuk do të mbetet njeri prej njerëzve që Zoti (xh.sh.), ka krijuar, vetëm se do të ulet në gjunjë prej frikës. Do të shohësh çdo popull në gjunjë atë Ditë. Aty njerëzit do ta kuptojnë më mirë, do ta kuptojnë më mirë se ajo që Zoti paska lajmëruar, paska qenë e vërtetë dhe se ky burrë, Muhamedi (s.a.v.s.), nuk ka folur nga vetja e tij. Çdo gjë që ka thënë, e ka thënë me frymëzim nga Zoti (xh.sh.). Dijetarët e tefsirit, Zoti i mëshiroftë, thonë: “Këto dy ajetet përfshijnë të dyja grupet, grupin e jobesimtarëve herën e parë dhe grupin e besimtarëve herën e dytë. Sikur Zoti (xh.sh.), u drejtohet të dyja kategorive dhe u thotë: Ju do të shihni, do ta dini këtë të vërtetë dhe do ta kuptoni se ç’do të ndodhë. Po edhe ju o besimtarë, që keni vuajtur në jetën e asaj bote dhe jeni dënuar në jetën e asaj bote, dhe i jeni përkushtuar Zotit (xh.sh.), jeni lodhur e lodhur në jetën e asaj bote, do ta kuptoni se e gjithë lodhja dhe mundimi i kësaj bote nuk është asgjë. Një futje në Xhenetin e Zotit (xh.sh.), e bën njeriun t’i harrojë të gjitha dhimbjet dhe mundimet e kësaj bote, ashtu si dhe një futje në Zjarrin e Xhehenemit do ta bëjë njeriun t’i harrojë të gjitha mirësitë e jetës së kësaj bote. Zoti na ruajtë prej Zjarrit të Xhehenemit. O Allah, na përfshij me Mëshirën tënde të pafund! O Zot, ne besojmë se Mëshira jote e ka kapluar zemërimin dhe hidhërimin Tënd, o Zot



ne besojmë se jemi mëkatarë dhe gjynahqarë, po prapë besojmë tek falja jote dhe Mëshira jote, se Ti veten Tënde e ke quajtur i Gjithëmëshirëshmi. O Allah, na mëshiro me mëshirën Tënde.

Njeriu kalon disa faza në jetë, kalon fazën e dyshimit, pastaj kalon një fazë tjetër, që është faza ku e ndan të bardhën nga e zeza, ka Zot apo nuk ka Zot, ka botë tjetër apo nuk ka botë tjetër. Vjen një moment që njeriu e ndan. Në momentin që e ndan dhe zgjedh për veten e tij ose të “vështirën” ose “të lehtë”, do ta shohë premtimin e Zotit në botën tjetër. “Xheneti,- thotë Muhamedi (s.a.v.s):- është i rrethuar me gjëra të vështira, ndërsa Xhehenemi është i rrethuar me qejfe dhe me epshe, kështu që njeriu e ka më të lehtë të zgjedhë rrugën e Xhehenemit në jetën e kësaj bote.” Ndërsa e ka shumë të vështirë t’i futet rrugës së Xhenetit, se nuk është e lehtë të çohesh në mëngjes e të falësh sabahun në kohën e vet, nuk është e lehtë për njeriun t’i largohet haramit, nuk është e lehtë për njeriun të agjërojë, nuk është e lehtë për njeriun të japë prej pasurisë se tij për ata që e meritojnë. Mirëpo, në momentin që njeriu është prej xhenetlinjve, të gjitha këto nuk i ka asgjë. Madje, nëse besimtarit i ikën namazi nga koha e vet, duket sikur qielli i shtatë i ka rënë në kokë, sepse është krijuar për Xhenet dhe punët e xhenetlinjve për të janë shumë normale. Dhe në momentin që pengohet prej diçkaje, qoftë dhe jashtë dëshirës së tij nga punët e Xhenetit, i duket shumë e madhe dhe e rëndë. Ndërkohe, ai që është krijuar për diku tjetër, e ka shumë të lehtë të mos falet, e ka shumë të lehtë të mos lutet, e ka shumë të lehtë të hajë haram, të veshë haram dhe të jetojë në haram. Por themi: kur Zoti e paska krijuar këtë për Xhenet dhe atë për Xhehenem, e ka ditur se ky do të veprojë si xhenetli, se dija e Zotit është absolute. E ka krijuar këtë tjetrin për Xhehenem, se Zoti me dijen e Tij absolute e ka ditur se ky njeri do të meritojë Xhehenemin. Zoti (xh.sh.), thotë: **“Ne nuk u kemi bërë padrejtësi njerëzve, por kanë qenë njerëzit që i kanë bërë padrejtësi vetes të tyre.”** Njeriu kalon disa faza: fazën e dyshimit, fazën e prekjes dhe, nëse njeriu kalon këto faza, vjen faza tjetër, që është faza e shikimit. Do të shohë të gjitha ato gjëra që ne myslimanët i kemi besuar si botë e fshehtë, melekët, xhindët, jetën e varrit, Xhenetin, Xhehenemin, Urën e Siratit, peshoren e veprave, shpërndarjen e Librave, takimin me Zotin në Ditën e Gjykimit dhe shikimin e Zotit në Xhenet. Allahu na bëftë prej të lumturuarve në këtë botë dhe në jetën e botës tjetër. Zoti (xh.sh.), thotë: **“E kur të dilni përpara Zotit, normalisht do të pyeten për çdo të mirë që Ai u ka dhënë në jetën e kësaj bote.”**

Lënia e xhihadit sipas, Ebu Ejubit (r.a.), është fatkeqësi e madhe

M. Sami Ramazanogllu

Allahu i madhëruar, në Kuranin Hakim, u drejtohet besimtarëve:

“Dilni në luftë, qofshi të shëndoshë ose të sëmurë dhe luftoni me pasurinë e jetën tuaj në rrugën e Allahut! Kjo është më mirë për ju, nëse e dini!” (Sureja et-Teube, 41.)

Sevapi i luftës ju përket juve. Qëndrimi me pasurinë, fëmijët dhe në qetësi, është një gjendje e përkohshme në këtë botë provizore. Sevapi i luftës dhe rehatia e lumturia që është përgatitur në xhenet për shkak të tij, janë të përhershme. Atëherë, o besimtarë, keni shumë apo pak armë, keni apo nuk keni fëmijë, jeni këmbësorë apo kalorës, të rinj, të moshuar, të pasur e të varfër, të gjithë luftoni në rrugë të Allahut Teala pa hezituar aspak. Kjo është shumë e mirë për ju.

Në tefsirin e Hazinit, nga Muxhahidi, rahimehullah, transmetohet:

Për shkak se Ebu Ejubi, radijallahu anh, kishte marrë pjesë në Luftën e Bedrit e në të gjitha luftërat e tjera dhe nuk ishte ndarë asnjëherë nga i Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, e pyetën:

“O Ebu Ejub! Përse e ke dhënë veten pas xhihadit në rrugë të Allahut?” Ai, radijallahu anh, u përgjigj:

“Tashmë unë nuk kam mundësi ta lë luftën, pasi kam lexuar urdhrin hyjnor në Kuranin Fisnik, i cili thotë: **“Dilni në luftë, qofshi të shëndoshë ose të sëmurë dhe luftoni me pasurinë e jetën tuaj në rrugën e Allahut!”**

Sipas Ebu Ejubit, radijallahu anh, myslimanët e kanë obligim insistimin dhe vazhdimin e xhihadit në rrugë të Allahut Teala, sepse xhihadi është një farz aq i rëndësishëm, saqë obligueshmëria e tij është e ligjëruar në Kuran, në Sunet dhe në konsensusin e umetit.

Allahu i Madhëruar, në ajete të ndryshme në Kuranin Fisnik, ka treguar fazat dhe detajet e xhihadit. Allahu Teala, thotë:

“Shpenzoheni pasurinë në rrugën e Allahut dhe mos e

çoni veten tuaj në shkatërrim, por bëni të mira; Allahu me të vërtetë i do bamirësit.” (el-Bakara 195.)

Sepse ju jeni ata që do të siguron armët e domosdoshme dhe harxhimet e muxhahidëve në luftë. Nëse tregoheni koprracë në këtë çështje, armiqtë kanë për t’ju mposhtur. Domethënë, bëheni shkak për shkatërrimin e pasurisë dhe të jetës suaj.

Sipas komenteve që bëhen në literaturën e tefsirit, Ebu Ejubi, radijallahu anh, thotë:

“Një ditë po bisedonim me disa sahabë fshehtas nga i Dërguari i Allahut dhe deshëm të vendosim: ‘Tashmë Allahu e ka forcuar Islamin. Ndihamat po shtohen nga çdo vend. Nëse e lëmë luftën dhe i rregullojmë vreshtat e bahçet tona të shkatërruara duke qëndruar në krye të tyre, do të ishte më mirë.’ Kur menduam për ta lënë luftën dhe xhihadin, Allahu i Madhëruar i refuzoi imagjinatat tona, duke zbritur këtë ajet. Atëherë e kuptuam se mendimi ynë ishte i gabuar dhe binte në kundërshtim me vullnetin hyjnor.

Pas zbritjes së këtij ajeti fisnik, Ebu Ejub el-Ensariu, radijallahu anh, nuk la asnjë luftë pa marrë pjesë, qoftë në kohën e të Dërguarit të Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, qoftë në kohën pasi ndërroi jetë Pejgamberi (s.a.s.) dhe trupin e tij ia pati përkushtuar xhihadit.

Në kohën e Hazreti Ebu Bekrit, Hazreti Umerit, Hazreti Osmanit dhe Hazreti Aliut, radijallahu anhum, vrapoi nga një betejë në tjetrën, mbajti premtimin kundrejt Allahut të Madhëruar dhe të Dërguarit të Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, u bë komandanti i atyre që e kishin zemrën të lidhur me Allahun Teala dhe që luftonin për lartësimin e fesë së bukur Islame e për paqen e umetit të Muhamedit, sallallahu alejhi ve sellem. Ai ra dëshmor gjatë rrethimit të Kostantinijes (Stambollit), e cila ishte lufta e fundit për të.

Varri i tij fisnik që gjendet në Stamboll, vizitohet nga myslimanët e të gjithë botës me një lidhje dhe dashuri që vjen nga besimi dhe zemra.

Qytetnimi musliman, përshtypjet ndërkombtare, shkaqet e prapavajtjes

Qytetnimi musliman me tanë bukurit e përparimet e vet kishte bâmë efektin mâ të madhë në shekullin qi kishte lemun nga i teti deri në të dyndhetin shekull pas lemjes së H. Isas, n'ëmën të qytetnimit q'u përket kohnave të vjetra nuk kish ngelun tjetër për veç qytetnimeve muslimane e Bizanse. Fuqia zgjeruëse e qytetnimit muslimane mbasi ishte mâ e shum ka qënë përhapun n'Asi, Europë e Afrikë dhe qi nga Kini deri n'Ispanje.

Qytetnimi musliman kishte lemun mbasi takoj me qytetnimin oksidental, mbi të cilin kishin bâmë efektet mâ të gjalla qytetnimi i Persisë dhe i Greqisë; Persia në kohën e Sasanive kishte kaluë një periudhë mjaftë përparimtare; ky vend tue përfituë nga pozita gjeografike, plotë katër shekuj u-bâ qandra e shkembimit të mendjes së njeriut midis Bizansit Kinesë dhe në literaturën Persianë ishin tue rrjedhun burimet e mendimeve t'Indisë.

Priftnit e Nesturivet, nxânsit e shkollave t'Athinës e t'Aleksandrisë q'ishin të lidhun me filosofinë e Platonit, kishin ardhun të gjith në Persi dhe këtu kishin përkthye tanë veprat e dijetarvet, Filosofëvet Helenikë.

Në Siri, pas Selefqivet, Patllamjosevet e Partëvet, edhe Sasanitë kishin shërbyë për

përhapjen e veprave mendore Persiane. Arabët kur pushtuan Mezopotamin, Egjiptin e Sirinë, këtë qytetnim e kishin gjetun si kish qënë krijuëm; mbasi pushtuan Anadollin këtu takuan me Bizantinjit, me ndërmjetësinë e Persianëve sikurse kopjuanë qytetnimet Indiane e Kineze dhe me mjetimin e Bizansitë përkuptuan zheninë helenike; n'Egjipt e Mezopotami kishin hasun në vepra kujtimore e të vlefshime të kohrave të vjetra të cilat kishin ngelun nën pluhurin e harrimit si një thesar i pshehun.

Kur Perandoria Arabe kishte arritun kulmin e zhvillimit, ka qënë respektuë feja e tyne, ka qënë përgoju një gjuhë, kanë qënë në aplikim një farë llojë ligjësh.

Midis aqe kombeve qi përbanin shtetin musliman kishte një bashkëpunim të fortë; kto kombe kundrejtë njeni tjetrit ishin lidhun nga pikëpamjet tregtare, shetitare, luftare, morale e fetare të cilat ishin për tâ, mjetet e përhapjes të mendimevet dhe brumi q'ishin gatue tue u perpjekë ma pas tue u pleksun e tue u bashkuë.

Secili prej ktyne kombeve i kishte brumëzue në një landë tradicionet, historit dhe kapacitetet naturale; por nuk ishte vetëm qytetnimi Arabe qi përbaresh prej kombeve të

ndryshëm në racë e natyrë; ky qytetnim ishte i ranjosun si mbas ambjentit qi ndodhesh, e si mbas shquanjës qytetnimit qi imitohesh, në ngjyra helenike, Persiane, mezopotamike, Egjiptiane, Indiane dhe Perendimore; por përmbi gjithë këto faktorë ishte urdhuëse fuqia Arabe.

Arabët nuk kishin ndermjetsuë vetëm për të përhapunit n'Afrikë, Ispanje dhe në kombet llatine t'Europës mjeshtërit e bukura, ditunit e vlefshime të lemjes s'afërme, por kishin gjetun edhe rrugën e punimit me një trajtë të veçantë të sendevet, vepravet q'i kishin gjetun krejtë të shpërndame e të shkatrume, kishin krijum vepra të reja tepër të gjallshime, e të përfitushme si mbas pëlqimit e zhenisë së t'yne.

Ky qytetnim i shkelqyëm kish ndritun n'Orient dhe prap atije kish arritun kulmin e perparimit. Qandrat ma me randësi kanë pas qenë: Shami, si kryegjyteti Emevivet q'ishte istolisun anë e kanë me pemë të gjelberta e njomshtore, me kopshte të zbukrume me lloj-lloj lulesh qi kundërmonin me erëra të zbavitshme. Bagdati qi ka qenë qandra madhshtore e bujës t'Ab-basivet; Kahireja qi veçohesh nga shoqet me pallatet, Falëtoret, Shkollat, Biblioteket, observatoret astronomike; por madhështi e naltësi e Kortabasë (Cordoues) e kishte kalue kairen; Emevit e Ispanjes mbasi kishin emigruë prej Sirije as pakë nuk i kishin ndamë vështrimet nga lemja; Kryeqytetet e t'yne i kishin ngrefun si ato të Shamit dhe vjershëtorët, mjeshtërit, dijetarët q'ishin stolija e pallatevet i kishin

pruë prej Bagdatit.

Arabët në orjent kishin përhedhun një influencë efektuëse; ndonse lemja kish qenë pushtuë prej Persianve, Helenve, e Romakëvet, por influenza e këtyne në lemje ka pas qenë vetëm një përfutje politike; këta përveç qyteteve qi kishin pushtuë vetë drejtë për drejtë, nuk kishin mundun me i detyruë ose me i tërhequn mbas vedi qytetet e tjerë për me pranuë fét, gjuhënat e mjeshterinat e tyne.

Sikur se në kohë të Romakvet edhe në kohë të Patllamjozevet Egjipti i kish ngelun besnik i kurdohershim të shkuëmes ose të kaluëmes vetë; Fés, gjuhës, mjeshtërisë Egjiptiane mâ tepër nga të mundunit i kanë qenë përlun mundësit. Arabët shum shpejtë dhe pa përdorun shtrëngat u treguën të zotnit me i bamë ato gjana në Lemje të cilat nuk kishin mujtun me i bâmë Përsianit, Elinet, dhe Romakët. Përshe mbëllë Egjipti ishte një vënd ndër ato qi pushtoj pushteti Arab me lehtësi kurse ky ka pas qenë një vënd qi futesh me shum mundime n'influencën e të huajve; edhe një i tillë vënd si e pushtojë Amer-bin-el-asi, harroj qytetnimit shtat mijë vjeçar tue u përhedhun në një fé të ré në një gjuhë të ré dhe në një mjeshtri ma me ndryshime. Ndonse dhe një herë tjetër Egjiptianët për mbi insistimin e Perandoreve të Bizansit kishin pas ndërrum fënë, por në pranim të fésë muslimane kanë treguë ma të madhen dëshirë shpirtënore.

Marrë nga "Zâni i Nalte", fq. 101.

Arti i Kaligrafisë dhe Tez'hibit në botën Islame

*Husn-khat*¹, arti i kaligrafisë në botën islame, është një lloj arti pamor që shpeshherë përdoret me qëllim dekorativ, duke përdorur sistemet dhe mjetet shkrimore kryesisht të gjuhës arabe, por edhe të gjuhës osmane dhe perse.

Para ardhjes së Islamit, arabët kishin të zhvilluar artin e poezisë, por nuk mund të thuhet e njëjta gjë për kujdesin ndaj kulturës së shkruar, pasi ishte një kulturë me bazë të folurën. Me ardhjen e Islamit, me rëndësinë që iu kushtua diturisë², u shtuan shkrimtarët (katib) dhe në mënyrë të natyrshme teknika e shkrimit u zhvillua dita-ditës.

Kaligrafia në botën islame ka disa standarde dhe teknika që duhen ndjekur, të caktuara ndër shekuj nga mjeshtrit e mëdhenj të artit të kaligrafisë islame. Këto standarde janë të lidhura me madhësinë e germave, formën e tyre, hapësirën mes tyre, bashkimin ose mosbashkimin e disa germave, përdorimin ose mospërdorimin e disa shenjave, vendosjen njëjën mbi tjetrën të germave apo rrotullimin e tyre në drejtime të caktuara.

Fillimisht pranohet se shkrimi arab ishte në stilin "*ma'kili*", që përbëhej nga vija të thjeshta dhe të drejta. Më pas, mendohet se Hz. Aliu ishte nismëtar i kaligrafisë "*kufi*", teknikë e cila ishte më e avancuar dhe më e sistemuar se stili "*ma'kili*". Pikërisht ky stil i bukurshkrimit arab, u bë burim i shumë llojeve të tjera të *husn-khat*-it. Sipas radhës, ato janë *gjashtë kalem-et (aklami-sitte)*: *Thuluth, Neskh, Muhakkak, Rejhani, Tevki* dhe *Rikaa*. Por, krahas tyre, u zhvilluan edhe shumë variante të tjera të kaligrafisë në botën islame, ndër të cilat mund të veçojmë si më të rëndësishmet përveç gjashtë teknikave të mësipërme: *Ta'lik, Xheli, Ixhaze, Divani* etj.

Stilin *thuluth* dhe *nesikh* pranohet që e ka zbuluar Ibni Mukle (885-940). Ndërsa stilin *muhakkak* dhe *rejhani* e ka zbuluar bagdadasi Ahmed Ibnul Fadl, që ka jetuar në shekullin XI. Kurse stilin *ta'lik* të kaligrafisë islame, me-

1. *Husn-khat* (arab.): bukurshkrim; Kaligrafi, *Kallos + graphe* (greq.): bukur - krim.

2. Profeti Muhamed është përkujdesur për ata që dinin të shkruanin dhe të lexonin, si dhe ka nxitur në forma të ndryshme myslimanët që të praktikonin shkrim-këndimin. Gjithashtu edhe në Kuran vërejmë se akti i shkrimit përbën një rëndësi më vete. Në shumë versete përmendet se duhet praktikuar shkrimi, duhen regjistruar gjërat. Madje, edhe në pesë versetet e para të shpallura përmendet si leximi po ashtu edhe shkrimi (Sureja Alak, 1-5).

ndohet se e ka zbuluar Hoxha Ebul-Ali.

Arti i kaligrafisë islame u zhvillua edhe më shumë me kalimin e kësaj teknike tek turqit dhe persët. Në kohën e selçukëve dominonte përdorimi i stileve *thuluth, nesikh, muhakkak* dhe *rejhani*. Kurani i shkruar në stilin *muhakkak* dhe *rejhani* nga Ebulizz Umer bin Ali (1206), i ekzpozuar në Muzeun Mevlana, është një nga ekzemplarët e kohës së selçukëve.



Nga fundi i shekullit XV, arti i *husn-khat*-it njohu një zhvillim të rëndësishëm nga mjeshtrit osmanë të kaligrafisë arabe; Ahmed Shemseddin Karahisari, Jakut el-Mustasimi dhe Shejh Hamdullah (1429 – 1520), i cili arriti të themelojë edhe shkollën e tij: Stili Shejh i *Khat*-it. Më pas, në pjesën e dytë të shekullit XVII u hap edhe një tjetër shkollë e stilit të ri të kaligrafisë arabe, nga Hafiz Osman (1642 – 1698).

Shkrimet që bëhen më të mëdha se normalja, quhen *xheli*. Për shkrimin *xheli*, përdoren vetëm teknikat *muhakkak, thuluth* dhe *nesikh*. Shembujt e parë të shkrimit *xheli* në historinë osmane janë kaligrafitë e brendshme të Xhamisë së Madhe (Ulu Camii) dhe Xhamisë së Jeshiltë

(Yesil Camii) të qytetit të Bursas. Shkrimi *xheli* është zhvilluar nga Ali bin Jahja Sofi. Në shekullin XIX gjendeshin dy shkolla të teknikës *xheli* të kaligrafisë arabe; shkolla e Mustafa Rakim dhe shkolla e Mahmut Xhelalettin.

Teknika *talik* e shkrimit, është zbuluar nga persët dhe është zhvilluar nga Dervish Abdiu nga Buharaja. Gjithashtu edhe mjeshtrit e kaligrafisë; Mehmet Efendi Jesariu dhe i biri Mustafa Izzet Efendiu, ndihmuan shumë në përparimin e këtij arti.

Stili *divani*, që është teknika e shkrimit të vendimeve që merreshin në Divan, u zbulua në shekullin XV nga mjeshtri i kaligrafisë me emrin Taxhuddin dhe në shekullin XIX dhe të XX është zhvilluar në mënyrë mjaft të bukur.

Sikurse stili *divani*, po ashtu edhe stili *rik'a* u zbulua nga osmanët dhe që në fillim të shekullit XIX është zhvilluar mjaft.

Ky kontribut që dhanë turqit për kaligrafinë arabe, ka bërë që të thuhet "Kurani u zbrit në Hixhaz, u këndua në Egjipt dhe u shkrua në Stamboll".

nga motivet e natyrës, bimët, kafshët, shpendët dhe retë. Megjithëse kjo gjë ndryshon, por zakonisht në *Tez'hib* bëhet një kombinim mes ngjyrës së artë me ngjyrën e blu të mbylltë. *Tez'hibi* zakonisht përdoret për kapakët dhe fletët e librave të ndryshëm, kryesisht ata fetarë dhe artistikë, si dhe për tablotë e ndryshme islame; esamulhusna etj. Madje, në fermane dhe firmat e sulltanëve është përdorur me mjeshtëri *Tez'hibi*.

Motivet dhe kompozicionet që përbëhen përmes stilimeve dhe kombinimeve të ndryshme, kanë kuptim simbolik. Ngjyra blu, që përdoret në *Tez'hib*, simbolizon pafundësinë dhe qetësinë; kurse kompozicionet e rumbullakëta, si dielli i artë, flatrat e zogut me motive *rumi*, bimët *hatai* dhe *penç* simbolizojnë botën. Kurse përsëritja e këtyre motiveve në një kompozicion, ka domethënie të ritmit dhe dinamikës së botës.

Në kohën e selçukëve hasim në punime *Tez'hibi* me epërsi figurat gjeometrike, por arti i *Tez'hibit* është zhvilluar në shekullin XV. Sulltan Mehmet Fatihu, me kujdesin që kishte ndaj artit dhe ndaj artistëve, ka luajtur një rol të



Sot e kësaj dite, artin e kaligrafisë arabe ne mund ta shohim në libra, në fermane, diploma, në pjesët e brendshme dhe të jashtme të xhamive, në ndërtesa të ndryshme, në gurët e varreve, në kapakët e dritareve apo në dyer, qilima, vazo, pjata e shumë objekte të tjera.

ARTI I TEZ'HIBIT

Fjala *Tez'hib* në osmanisht rrjedh nga fjala *dheheb* (ar) në arabisht dhe ka kuptimin e arthurjes, pra një proces dekori që bëhet përmes arit. Bojërat që përdoren në artin e *Tez'hibit* janë bojëra me bazë ujë, kurse ari, pasi shtypet, përdoret me ujë me xhelatinë. *Tez'hibi* kryesisht ka një funksion veshjeje të shkrimit të thjeshtë arab apo të kaligrafisë islame dhe për të stilizuar këtë, frymëzohet

rëndësishëm për zhvillimin e këtij arti. Më pas, po ashtu edhe në kohën e Sulltan Bejazidit II, *Tez'hibi* u zhvillua mjaft. Kurse koha e Sulltan Sulejmanit, ashtu sikurse për të gjitha artet, edhe për artin e *Tez'hibit* është koha e artë. Në këtë kohë, artistët e *Tez'hibit*, krahas përdorimit në mënyrë mjeshtrorë të motiveve klasike, nisin të përdorin edhe gjysmëstilizimin e tulipanit, trëndafilin, karafilin, zymbylit dhe luleve të tjera, si dhe të pemës së selvisë. Më pas, në gjysmën e dytë të shekullit XVII, në artin e *Tez'hibit* vërehet ndikimi i stilit natyralist të perëndimit.

Sot, arti i *Tez'hibit* mësohet në degët e arteve tradicionale të universiteteve në Turqi, në kurset që kanë hapur bashkitë dhe Ministria e Arsimit e Turqisë.



TË DREJTAT DHE OBLIGIMET E FEMRËS

“O Pejgamber, kur të vijnë besimtarët të të japin besën se nuk do t’i shoqërojnë asnjë send Allahut, se nuk do të vjedhin, se nuk do të bëjnë kurvëri, se nuk do t’i mbysin fëmijët e tyre, se nuk do të gënjejnë me ndonjë shpifje për fëmijën e huaj (që kanë marrë) se është i tyre dhe nuk do të të kundërshtojnë në atë që i urdhëron, atëherë prano zotimin e tyre dhe lute Allahun t’i falë ato, se Allahu është mëkatfalës dhe mëshirues.” (El-Mumtehine, 12)

HYRJE¹

Sheriati islam është i vetmi sistem jete që i ka konsideruar meshkujt dhe femrat të barabartë, duke ruajtur natyrshmërinë dhe veçoritë e tyre. Prandaj, kur shikojmë rregullat e shariatit që flasin për të drejtat e femrës dhe obligimet e saj, kuptojmë se vetëm sheriati islam i ka trajtuar në mënyrën më të përsosur. Kur sistemet e ndryshme njerëzore e kanë konsideruar femrën si djall, ferr, turp, feja islame e çmon lart dhe e konsideron si partneri kryesor për zhvillimin e llojit njerëzor. Rregulli që ka të bëjë me të drejtat e femrës, e konsideron atë të barabartë me mashkullin, përveç disa dallimeve që kanë të bëjnë në aspektin e përgatitjes, kompetencave dhe fuqisë fizike. Këto janë vartësitë e këtyre të drejtave dhe është kusht që të mos

1. Ky punim kryesisht është marrë nga libri i dr. Abdul Kerim Zejdanit „Usulu Daveti“.

vijnë ndesh me të drejtat dhe obligimet e saj. Duke u bazuar mbi këtë rregull, femra realizon këto të drejta:

a. Ajo gëzon të drejtën për të jetuar, ngaqë është e mbrojtur sikurse burri, ndaj për këtë, feja islame e ka ndaluar varrosjen për së gjalli, ka obliguar zbatimin e masës ndëshkuese me vdekje të atij që e mbyt gruan me paramendim. Këto rregulla vlejné ashtu siç vlejné edhe për mashkullin.

b. Meriton respektin, sepse është njeri. Allahu i Lartësuar ka thënë: “Ne vërtet nderuam pasardhësit e Ademit (njerëzit)”².

c. Ka të drejtë të fitojë pasuri në format dhe rrugët e lejuara. Femra e ka të drejtën e fitimit të të drejtave materiale dhe atyre jomateriale, njëlloj si edhe mashkulli.

2. El-Isra: 70.

Të drejtën e fitimit dhe të trashëgimisë feja islame e ka miratuar, pasi në kohën e injorancës ishin të ndaluara këto të drejta. Allahu i Lartësuar ka thënë: "Meshkujve u takon pjesë nga pasuria e lënë nga prindërit e të afërmit (pas vdekjes). Edhe femrave u takon pjesë nga ajo që lënë prindërit e të afërmit, le të jetë pak ose shumë ajo që lënë, u takon pjesë e caktuar (nga Zoti)".³ Përderisa femra është e aftë në aspektin psikik dhe di të administrojë paratë, është e lirë të veprojë me paratë e saj, pa i marrë leje askujt.

ç. Ka të drejtën e marrjes së mehrit në aktin e martesës. Allahu i Lartësuar ka thënë: "Grave jepjuani dhuratën e kurorës së tyre (niqahin) më të mirë"⁴. Ajo ka të drejtën e furnizimit nga bashkëshorti: "I ati i fëmijës është i obliguar për furnizimin dhe veshmbathjen e tyre (gruas) ashtu si është rregull."⁵ E drejta për të merituar furnizimin edhe për fëmijët e saj, është ana prindërore e saj si nënë.

d. Ajo ka të drejtën e përkujdesjes së fëmijës, nëse ndodh ndarja e saj nga bashkëshorti.

e. Ajo ka të drejtë të studiojë shkencat e dobishme në mënyrën që i përshtatet natyrshmërisë së saj dhe duke iu përmbajtur rregullave të domosdoshme islame. Shkenca, e cila i bën asaj më së shumti dobi, është studimi i shariatit islam, i asaj që është hallall dhe asaj që është haram. Sa i përket studimit të shkencave të ndryshme, është çështje e lirë e robit (mubah), pra, nëse femra dëshiron të mësojë ndonjë prej shkencave, nuk ka kurrfarë pengese, por me kusht që të kihet parasysh rregullat dhe kushtet që parasheh feja islame, me qëllim të ruajtjes së femrës. Po ashtu, femra duhet të dijë se çfarë i përshtatet natyrshmërisë së saj, ta përforcojë specializimin e saj të natyrshëm për edukimin e fëmijëve dhe ruajtjen e shtëpisë, të mësojë artin e rrobaqepësisë, përgatitjes së ushqimit dhe bazat e edukimit të fëmijës. Kur ajo të dëshirojë shtimin e njohurive, nuk ka kurrfarë pengese, por me kusht që mësimi të mos ndikojë që ajo të shprehë neglizhencë ndaj detyrave të saj si bashkëshorte dhe si nënë. Po ashtu, lejohet shtimi i njohurive, me kusht që mësimi të realizohet me mënyra të lejuara dhe nuk lejohet përzierja me meshkuj, duke arsyetuar se është duke mësuar, nuk lejohet t'i zbulojë bukuritë para meshkujve. Të gjitha këto veprime e të ngjashme, janë të ndaluara dhe nuk lejohen, me pretekstin se është çështje e kërkimit të diturisë.

OBLIGIMET E FEMRËS

Rregulli për obligimet, është si rregulli i të drejtave të

3. En-Nisa: 7.

4. En-Nisa: 4.

5. El-Bekaret: 233.

femrës. Femra në aspektin e obligimeve, është e barabartë me mashkullin, përveç disa dallimeve që kanë të bëjnë me çështjet e ngarkesave të obligimeve. Baza e këtij rregulli është se edhe femra është njeri dhe se ajo i ka aftësitë e kryerjes së obligimeve dhe realizimin e të drejtave të saj. Allahu i Lartësuar ka thënë: "O ju njerëz! Kini frikë Zotin tuaj që ju ka krijuar prej një veteje (njeriu) dhe nga ajo krijoi palën (shoqën) e saj, e prej atyre të dyve u shtuan shumë burra e gra."⁶ Gratë janë si burrat në kërkesën për t'i pasur frikën Allahut, gjegjësisht në nënshkrimin ndaj urdhrave dhe ndalesave të Allahut. Nga ky rregull rezultojnë këto çështje:

a. Gruaja është e barabartë me burrin në aspektin obligimeve fetare, si në çështjet e besimit, të adhurimeve dhe të veprimeve të bashkëjetesës. Dallimi është vetëm në ato çështje ku natyrshmëria e tyre gjinore i dallon, si p.sh.: me xhihad obligohet vetëm burri, ndërsa femra nuk obligohet me xhihad, veç nëse ajo del vullnetarisht.

Atëherë nuk pengohet, por mund të kryejë disa punë që janë të mundshme, si shërimi i të plagosurve, përgatitja e ushqimit etj. Në Kuranin Fisnik përmendet se gratë i kanë dhënë besimin të Dërguarit (s.a.v.s.), po ashtu si burrat. Allahu i Lartësuar ka thënë: "O Pejgamber, kur të vijnë besimtarët të të japin besën se nuk do t'i shoqërojnë asnjë send Allahut, se nuk do të vjedhin, se nuk do të bëjnë kurvëri, se nuk do t'i mbysin fëmijët e tyre se nuk do të gënjejnë me ndonjë shpifje për fëmijën e huaj (që kanë marrë) se është i tyre dhe nuk do të kundërshtojnë në atë që i urdhëron, atëherë prano zotimin e tyre dhe lute Allahun t'i falë ato, se Allahu është mëkatfalës dhe mëshirues."⁷ Me këtë argumentohet se gratë janë të ngarkuara me obligime fetare si edhe meshkujt.

b. Femra, e cila obligohet me detyra fetare meriton shpërblimin. Allahu i Lartësuar ka thënë: "Kush bën ndonjë nga punët e mira, qoftë mashkull ose femër duke qenë besimtar, hyn në xhenet dhe nuk i bëhet farë padrejtësie."⁸ "Zoti iu përgjigj lutjes së tyre (e tha): Unë nuk ia humb mundin asnjërit prej jush, mashkull qoftë apo femër. Ju jeni njëri nga tjetri"⁹, "Kush bën vepër të mirë, qoftë mashkull ose femër, e duke qenë besimtar, Ne do t'i japim atij një jetë të mirë (në këtë botë), e (në botën tjetër) do t'i japim shpërblimin më të mirë për veprat e tij."¹⁰

c. Urdhrat kuranore, që u drejtohen besimtarëve, përfshijnë si meshkujt ashtu edhe femrat, vetëm nëse ek-

6. En-Nisa: 1.

7. El-Mumtehinetu: 12.

8. En-Nisa: 124.

9. Ali Imran: 195.

10. En-Nahl: 97.

ziston ndonjë indikacion që e veçon obligueshmërinë vetëm për meshkujt, duke përfshirë femrën. Allahu i Lartësuar ka thënë: "Nuk është (shpëtim) sipas shpresave tuaja as sipas shpresave të ithtarëve të librit. Kushdo që bën keq, do të ndëshkohet dhe, përveç Allahut, nuk ka për t'i gjetur vetes, as mbrojtës, as ndihmës."¹¹. Në këtë përfshihen si burrat, ashtu edhe gratë. Kurani Fisnik i përmend edhe gratë edhe burrat, kur ka të bëjë me ndonjë obligim apo lavdërim të tyre. Allahu i Lartësuar ka thënë: "Nuk ka dyshim se për myslimanët e myslimanet, besimtarët e besimtare, adhuruesit e adhurueset, të sinqertit e të sinqertat, durimtarët e durimtare, të përvuajturit e të përvuajturat, sadakadhënësit e sadakadhënëset, agjëruesit e agjërueset, ruajtësit e nderit e ruajtëset e nderit, shumëpërmendësit e Allahut e shumëpërmendëset e Allahut, Allahu ka përgatitur falje (mekatesh) dhe shpërbllim të madh."¹²

ç. Femra e ka për obligim ta respektojë, të dëgjojë bashkëshortin sipas rregullit dhe t'i kryejë detyrat që ka ndaj tij. Në hadithin e të Dërguarit (s.a.v.s.), përmendet kështu: "Po ta urdhëroja dikë t'i binte në sexhde dikujt prej njerëzve, kisha për të urdhëruar gruan t'i binte në sexhde burrit të saj". Nëse gruaja e respekton burrin sipas rregullit dhe i kryen detyrat që ka ndaj tij, ajo do të konsiderohet prej grave të vjera. Sipas asaj që transmeton Ebu Hurejra (r.a.), se të Dërguarit (s.a.v.s.), i është thënë: "O i Dërguari i Allahut, cila grua është më e mirë?" Ai është përgjigjur: "Gruaja e cila e bën të lumtur burrin, kur ai e shikon atë, e dëgjon urdhrin e tij dhe nuk e kundërshton atë për marrëdhënie seksuale..."

d. Gruaja është përgjegjëse për shtëpinë dhe mirëmbajtjen e saj. Ajo e ka për obligim këtë amanet. Në hadithin e të Dërguarit (s.a.v.s.), thuhet: "Çdokush është bari dhe secili është përgjegjës për kopenë e tij... gruaja është bareshë në shtëpinë e burrit dhe përgjegjëse për kopenë e saj".

PROFESIONI I CILI ËSHTË I VEÇANTË PËR TË

Allahu i Lartësuar ka krijuar të gjitha krijesat, duke u dhënë mundësitë e kryerjes së qëllimeve për të cilat i ka krijuar. E ka krijuar femrën që të jetë grua dhe nënë, e cila është më meritore për një detyrë të atillë. Vërtet Allahu i ka dhënë femrës fuqinë për edukimin e fëmijëve, durimin për përkujdesjen ndaj tyre dhe pozitën e natyrshme të nënës. Andaj detyra-profesioni thelbësor i saj i veçantë si femër, është detyra si bashkëshorte, si nënë, si edukuese e fëmijëve dhe si themeluese e një gjenerate të dobishme. Edukimi i fëmijëve është në shtëpi e jo në rrugë, andaj për këtë duhet kohë e mjaftueshme dhe feja islame i ka dhënë kohë të mjaftueshme femrës, duke mos e obliguar atë të angazhohet për të fituar për ekzistencë, ngaqë këtë detyrë dhe obligim e ka bashkëshorti. Po ashtu, feja islame e ka liruar femrën edhe prej shumë obligimeve të tjera me të cilat mashkullin e ka obliguar, me të vetmin qëllim që ajo

11. En-Nisa: 123.

12. El-Ahzab: 35.

të ketë kohë të mjaftueshme për ta kryer detyrën e saj si bashkëshorte dhe si nënë. Kështu, lufta për në rrugën e Allahut nuk është obligim për femrën, por për mashkullin, falja e namazit me xhemat në xhami është vaxhib apo *sunneti muekkede* për mashkullin, ndërsa për femrën jo, namazi i xhumasë është obligim për mashkullin, ndërsa për femrën jo etj. Këta shembuj argumentojnë se sa dëshiron feja islame që gruaja të qëndrojë në shtëpi dhe të mos dalë pa arsye të justifikueshme, me qëllim që të mos largohet prej detyrës së saj shumë të rëndësishme: edukimi i fëmijëve dhe rregullimi i banesës, në të cilën pushon bashkëshorti kur kthehet prej punës. Allahu i Lartësuar ka thënë: "Dhe rrini në shtëpitë tuaja e mos shfaqni bukurinë tuaj, si shfaqej në injorancën e hershme"¹³. Me këtë nuk synohet që femra vetëm të qëndrojë në shtëpi dhe të mos dalë jashtë asnjëherë. Ajo ka të drejtë të dalë për shkuarje në haxh, për të falë namazin në xhami, për të vizituar të afërmit e saj, për shërim etj.

RREGULLAT, TË CILAVE DUHET T'U PËRMBAHET FEMRA

Ka disa rregulla dhe sjellje të cilat femra doemos duhet t'i respektojë, me qëllim që të kontribuojë që shoqëria të jetë e pastër dhe larg paragjykimeve dhe kurtheve të shejtanit. Prej rregullave të tilla janë sa vijon:

E para: Nuk i lejohet femrës që të vetmohet me asnjë njeri që është i huaj për të. Kjo rregull vlen edhe për mashkullin. Arsyeja është vendosja e preventivave për të ndaluar mundësitë e ndikimit të djallit, ngase shejtani, sipas hadithit, ecën nëpër njeriun si gjaku, duke ia zbukuruar të keqen dhe duke i zgjuar epshin. Në hadithin sherif të të Dërguarit (s.a.v.s.), thuhet: "Mos u vetmoni me gratë e huaja. Pasha Atë që ka në dorë shpirtin tonë, nuk mund të jenë të vetmuar një mashkull dhe një femër e shejtani të mos jetë mes tyre." Ndërsa në një hadith tjetër është: "Mos të vetmohet askush me një femër përveç nëse është ndonjë i afërm i saj."

E dyta: Domosdoshmëria që femra të largohet nga përzjerja me meshkuj të huaj, për shkak të frikës së fitnes-telasheve. Prandaj feja islame nuk e ka obliguar femrën të shkojë në namazin e xhumasë. Me qëllim që të mos përzihet me meshkuj të huaj, nuk kërkon prej saj të falë namazin me xhemat, nuk rekomandon që femra të ndjekë xhenazen deri në varreza dhe, kur ndodh që femra të falet në xhami, duhet të qëndrojë me femrat në rreshtin e fundit pas meshkujve.

Kur është e domosdoshme që femra të përzihet me meshkuj, atëherë lejohet, por duke respektuar kufijtë e caktuar, si p.sh. dalja e femrës në xhihad me luftëtarët që t'u përgatisë atyre ushqim, të kujdeset për të plagosurit. Ka ndodhur që disa gra kishin dalë me të Dërguarin (s.a.v.s.), për të shkuar në luftë dhe janë angazhuar me shërimin e të plagosurve e u kanë dhënë ujë luftëtarëve myslimanë. Jo vetëm kaq, por nganjëherë femra detyrohet doemos të dalë në luftë, duke luftuar bashkë me myslimanët e tjerë, siç ka ndodhur me disa gra në betejën

13. El-Ahzab: 33.

e Uhudit. Po ashtu, femra nganjëherë detyrohet të dalë për nevojat e veta, duke hipur në autobus apo tren dhe do të përzihet patjetër me meshkuj. Në këto raste dhe të ngjashme me to, lejohet të përzihet femra, por me kusht që t'u përmbahet rregullave islame, si në ecje, veshje dhe në të folur.

E treta: Të mos i paraqesë bukuritë e saj, përveç ndaj atyre që lejohet. Në Kuranin Fisnik janë përmendur rregullat e daljes së femrës jashtë shtëpisë: "Thuaju edhe besimtareve të ndalin shikimet e tyre, t'i ruajnë pjesët e turpshme të trupit të tyre, të mos zbulojnë stolitë e tyre, përveç ato që janë të dukshme"¹⁴. Sipas kësaj, nuk lejohet që femra të zbulojë qëllimisht bukuritë e saj, përveç atyre që janë të dukshme apo bukurisë së jashtme të rrobave që, sipas Ibn Mesudit (r.a.), lejohet. Lejohet të duket boja e qepallave (kuhli) apo unaza, sipas mendimit të Ibn Abbasit (r.a.). Apo lejohet të duken duart dhe fytyra, sipas mendimit të shumicës së juristëve myslimanë¹⁵, pra, sipas tyre, lejohet të zbulohet fytyra dhe duart. Disa prej dijetarëve kanë lejuar të zbulohet fytyra dhe duart, me kusht që në to të mos ketë kurrfarë zbukurimi.

E katërta: duhet patjetër që femra të jetë e veshur siç kërkon sheriatu islam dhe në përputhshmëri me atë që ka urdhëruar Allahu i Lartësuar. Allahu i Lartësuar ka thënë: "Le të vënë shamitë mbi kraharorin e tyre"¹⁶. Shamia është ajo që vendoset për të mbuluar kokën dhe ajeti fisnik urdhëron të vendoset në kokë, duke mbuluar qafën dhe gjoksin. Allahu i Lartësuar, në një ajet tjetër, thotë: "O ti Pejgamber, thuaju grave tuaja, bijave tuaja dhe grave të besimtarëve t'i vënë shamitë (mbulojë) e veta mbi trupin e tyre, se kjo është më afër që ato të njihen (se nuk janë rrugaçe) e të mos ofendohen. Allahu fal gabimet e kaluara, Ai është mëshirues."¹⁷. Shpreja "xhelabibihine" në ajet, kupton pallton, të cilën femra e vesh mbi rrobat e saj, e njëjtë me palltot që veshin sot gratë.

Prej kushteve të tjera që duhet të kihet parasysh në veshjen islame, janë: që rrobat të mos jenë të tejdukshme, të mos jenë të ngushta sa të duket vija e trupit. Në hadithin sherif thuhet kështu: "Nga fundi i umetit tim do të jenë gratë e veshura-të zhveshura, kokat do t'i kenë si gungat e devesë. Mallkoni, se ato janë të mallkuara". Ky hadith është një prej mrekullive të të Dërguarit (s.a.v.s.), i cili na ka informuar për këtë që sot është e pranishme

në mesin tonë. Në një hadith tjetër, thuhet se i Dërguari (s.a.v.s.), ka ndaluar që femra të veshë rroba të ngushta sa të duket vija e trupit.

Po ashtu, si kushte të veshjes së femrës janë që të mos parfumohet kur të dalë jashtë shtëpisë, që rrobat të mos jenë të ngjashme me ato të burrave. Në hadithin e të Dërguarit (s.a.v.s.), thuhet: "Nuk është prej radhëve tona ajo grua që u përngjan meshkujve dhe nuk është prej radhëve tona ai mashkull që u përngjan femrave".

Si përmbyllje e gjithë kësaj, rregullat që kanë të bëjnë me veshjen fetare të femrës janë: rroba të mbulojë tërë trupin përveç fytyrës dhe duarve; rroba të mos jetë zbukurim tërheqës, të mos jetë e tejdukshme, të mos jetë e ngushtë, të mos parfumohet, të mos jenë të ngjashme me rrobat e femrave më të meshkujve dhe me rrobat e jobesimtarëve dhe të mos jenë rroba që shprehin famë"¹⁸.

E pesta: kur të dalë jashtë, femra duhet t'u përmbahet rregullave që kanë të bëjnë me ecjen dhe të folurit.

Për këtë, ka dhënë shenjë Kurani Fisnik: "Të mos kërcasin me këmbët e tyre, për të zbuluar fshehtësi nga stolitë e tyre."¹⁹

Nëse vepron kështu, ajo ka zbuluar fshehtësitë e saj para meshkujve dhe kjo vepër është e ndaluar.²⁰

Në fakt, ky është një parandalim për të mos shkuar deri te harami dhe, duke u bazuar në këtë, nuk duhet shikuar si synimin, por si rezultat i veprimimit. Duke u nisur mbi këtë bazë, nuk duhet që femra të ecë në mënyrë që të ndikojë tek meshkujt që ata të kthejnë shikimin nga ajo apo të mendojnë keq për të. Në këtë ndalesë bëhet analogji, duke u ndaluar çdo mënyrë e ecjes që shkakton provokim, ndaj femra duhet të ecë e qetë, duke mos

ndikuar në tërheqjen e mëkatarëve dhe atyre që janë me moral të dobët. Allahu i Lartësuar ka thënë: "O gratë e Pejgamberit, ju nuk jeni si asnjë grua tjetër, nëse kini kujdes e ruheni, andaj mos u llastoni në të folur e të lakmojë ai që ka sëmundje në zemrën e tij, po thoni fjalë të matura."²¹ Për komentimin e këtij ajeti, Imam Ibnul Arebij thotë: "Ato i ka urdhëruar Allahu të mos llastohen kur flasin, të flasin qartë dhe të mos flasin në atë mënyrë që të ndikojnë zemrën e lakmitarit dhe atij që dëgjon. Ka urdhëruar që ato të flasin fjalë të matura.. Thuhet se fjala "el-maruf" në ajet, ka për qëllim që kur të flitet, të filet me zë të ulur"²². Femra myslimane e ka për obligim t'u përmbahet rregullave të caktuar në të folur.

18. Nasirudin el-Elbanij "Hixhabul meretil myslimeh fil Kitabi ve Sunneti", fq. 89, boton el-Mektebul Islamiju.

19. En-Nur: 31

20.

21. El-Ahzab: 32

22. Ibnul Arebij, lbid: fq. 123

14. En-Nur: 31.

15. Ibnul Arebij el-Malikij: Ahkamul Kur'ani, vol. III, fq. 1356-1357.

16. En-Nur: 31.

17. El-Ahzab: 59.

Sa më të pastër dhëmbët, aq më e fortë kujtesa

Një studim i fundit nxjerr një rezultat mahnitës, lidhur me pastërtinë e dhëmbëve dhe higjienën orale. Prania e bakterieve në dhëmbë çon në shqetësime të shumta, jo vetëm në gojë, por edhe më tej.

Studiuesit e Universitetit të Kalifornisë kanë testuar ndikimin e pastërtisë së dhëmbëve në memorien e njeriut. Falë këtij studimi të ri, u arrit të zbulohet se te personat e moshuar, që i lajnë më pak dhëmbët, janë 65% më të zhvilluara problemet cerebrale se sa te personat që i lajnë tri herë në ditë dhëmbët.

Përfundimet e këtij studimi të botuar në "Journal of Geriatrics Society", treguan monitorimin e bërë në 5 mijë

banorë të një komuniteti të moshuarish, nga viti 1992 në vitin 2010. Në krahasimin e përfundimeve, rezultoi se personat që i lajnë dhëmbët vetëm 1 herë në ditë rrezikonin memorien e tyre me 4.5%, ndërsa ata që i lajnë më shpesh, kishin një memorie shumë herë më të freskët.

Prindërit duhen të kujdesen që fëmijët e tyre të ush-



Ushtrimet në fëmijërinë e hershme, parakusht për jetë të mirë



trohen të paktën tri orë në ditë, respektivisht të jenë tri orë aktivë gjatë ditës. Këto janë rekomandimet e ekspertëve që të shmangjet ajo që fëmijët të rriten si obezë.

Fëmijët më të vegjël se pesë vjeç duhen të nxiten për të ecur deri te kopshti ose te shitorja, derisa foshnjat

po ashtu duhen të nxiten të jenë sa më shumë aktivë gjatë lojës.

Parashikohet që deri në vitin 2050 gati dy të tretat e fëmijëve mund të jenë obezë, respektivisht mund të kenë më shumë kilogramë, në raport me gjatësinë e tyre. Mjekja Sally Davies, nga Britania e Madhe tha që hulumtimi tregon se ushtrimet në fëmijërinë e hershme janë parakusht i mirë për jetë, trup dhe shpirt të shëndetshëm.

Ushtrimet të cilat ekspertët i rekomandojnë më së shumti për fëmijë, janë vrapimi, notimi, kërcimi dhe vozitja me biçikletë. Zgjatja, po ashtu, është një nga aktivitetet që rekomandohen për fëmijët.

Tensioni i lartë, fruti që e mposht atë

Deri në 6 herë më shumë antioksidantë për të luftuar tensionin e lartë dhe kolesterolin, të grumbulluara në një frut të vetëm.

Një mollë në ditë, ul rrezikun për goditjen nga tensioni i lartë, kjo falë përqindjes së madhe të antioksidantëve, pasi ndihmojnë në shmangien e problemeve kardiovaskulare.

Sipas një studimi të publikuar në "Telegraph", mollët prej kohësh janë cilësuar si burim antioksidantësh ose, thënë ndryshe, substanca mike për zemrën.

Për të arritur në këtë përfundim, shkencëtarët kanë testuar frutin dhe një enzimë të tij ACE, ku u vu re se ndikimi i saj zvogëlonte rrezikun e prekjes nga tensioni i lartë.

Studimi i botuar në revistën "Food Chemistry", tregon se për personat që konsumojnë një mollë në ditë, ulet me 6 herë rreziku i prekjes nga tensioni i lartë.



Logitech: tastiera që lahet

Çdokush që ka fëmijë ose ndoshta një punë, ku hani mbi tavolinën tuaj, e di shumë mirë se ushqimi dhe tastiera nuk përzihen. Në fakt, ato mund të bëhen mjaft ngjitëse dhe mbushen me thërrime, në qoftë se ju nuk i pastroni rregullisht.

Tastiera Logitech K310, që lahet, u prezantua të mërkurën. Ajo ka pamjen e njohur të tastierave nga Logitech, që mund të kenë përdorur, por kjo mund të zhytet edhe në ujë. Ju mund ta lani atë në lavamanin e kuzhinës, apo ta fshini me një leckë të lagur.

Tastiera mund të durojë shumë larje dhe përdorim, bëhet e ditur sipas Logitech. Shkronjat janë të printuara me laser dhe të veshura me material që nuk fshihet, kështu që nuk zhduken pas pastrimit. Vrimat në pjesën e pasme të tastierës lejojnë rrjedhjen e ujit dhe hyrjen e ajrit që të thajë çdo

pjesë.

Është e përshtatshme me Windows XP, Windows Vista dhe Windows 7. Kjo tastierë pritet të jetë në dispozicion në të gjithë SHBA-në, duke filluar nga gushti për një çmim prej \$39,99. Ajo do të jetë në dispozicion në Evropë në tetor të këtij viti.



Pas 25 vitesh, Microsoft vendos të ndryshojë logo. Lajmi njoftohet nga vetë gjigandi i

produkteve kompiuterike nëpërmjet faqes zyrtare në internet, si dhe nëpërmjet Facebook.

“Në prag të lëshimit të një sërë produktesh, ndër më të rëndësishmet në historinë e Microsoft, publikojmë sot logon e re të kompanisë”, thuhet në njoftimin e Microsoft.

“U bënë plot 25 vite që nga ndryshimi i logos dhe ne me-

Microsoft ndryshon logon

ndojmë që tashmë është koha e duhur për të ndryshuar sërish. Ky është një vit tepër i rëndësishëm për Microsoft, vit ku ne po përgatitemi të hedhim në treg Microsoft Windows 8, Windows Phone dhe disa shërbime të tjera të Xbox si dhe versionin e ri të Office”, thuhet më tej në komunikatën e Microsoft.

Logo e re e kompanisë më të madhe në sistemet e operimit kompjuterik është ndërtuar mbi identitetin e së vjetrës, me katër ngjyra, të kuqe, jeshile, blu dhe të verdhë. Ndryshimi qëndron se në logon e re, katër kuadratet janë uniforme, pa dallgëzime që i jepnin trajtën e flamurit logos së përdorur deri më tani, si dhe në sistemin e operimit Windows 8, ku ngjyra e përdorur është vetëm e kaltra.

Një libër me 53.000 fjalë, konvertohet në ADN

Kërkimet në Universitetin e Harvardit kanë transformuar me sukses një libër me 53,426-fjalë në ADN, e njëjta substancë që siguron shabllonin gjenetik për të gjitha gjallesat. Arritja përfundimisht mund të çojë në adoptimin masiv të ADN-së si një medium afatgjatë ruajtjeje.

Pasi është publikuar në revistën *Shkenca*, eksperimenti kishte për qëllim të tregonte realizueshmërinë e ruajtjes së sasive të mëdha të të dhënave në molekulat e ADN-së. Meqenëse të dhënat janë regjistruar në çifte bazash nukleoze individuale në vargun e ADN-së. ADN-ja në fakt mund të ruajë më shumë informacion për milimetër kub se memoria flash.

Vështirësia është në përkthimin – në ADN dhe në kthimin mbrapa (përmbledhur në diagramin e mëposhtëm). Hulumtuesit filluan me përmbajtjen e librit, i cili përfshinte tekstin si dhe 11 imazhe dhe një program javascript dhe e kthyen atë në një kod binar. Pastaj ata çdo zeroje dhe njëshi i caktuan një bazë nukleotiti.

Pas kësaj, erdhi pjesa më e vështirë: kombinimi i ADN-së, që është 5.27 milionë baza e gjatë. Ata e kryen udhëtimin duke e ndarë në pjesë, secila 96 baza e gjatë. Kur përfunduan, libri ishte një grimcë e vogël ADN-je, që peshonte sa një të miliontën e peshës së një kokrrë rëre.

Leximi i librit të ADN-së ishte pak më i lehtë, pasi gjithçka që duhej ishte vetëm teknologjia e sekuencave të ADN-së. Pas rregullimit të sekuencave, ishte e lehtë për ta deshifruar atë përsëri në një kod binar dhe më pas në një të plotë si një skedar HTML-je. Hulumtimet thanë se gabimet e paraqitura nga i gjithë procesi ishin minimale, vetëm 10 BITS, nga 5.27 milion në total.

Përveç dendësisë së memories, ruajtja e ADN-së ka dy përparësi më shumë. E para, është jetëgjatësia; ADN-ja zgjat për mijëra vjet (edhe miliona, nëse është e izoluar në qelibar). E dyta, është korrigjimi i të ardhmes: Meqenëse ADN-ja është baza e tërë jetës, shoqëritë në të ardhmen do të kenë gjithmonë teknologji në dispozicion për ta lexuar atë.

Gjendja e shqiptarëve në Siri

Nga Siria çdo ditë vijnë lajme për luftime të ashpra mes forcave Ushtrisë së Lirë Siriane dhe forcave të regjimit të Asadit. Luftimet vazhdojnë në kryeqytet, por dhe në Haleb, qytetin e dytë më të madh në Siri pas Damaskut.

Çdo ditë vijnë lajme për shpërthime, ndërkohë që për 17 muaj, që nga fillimi i kryengritjeve kundër regjimit, raportohen të kenë humbur jetën mbi 17 mijë vetë (kjo është shifra e fundit të cilës i referohet CNN), ndërsa 150 mijë të tjerë janë detyruar të largohen për t'u strehuar në shtetet fqinje, përfshi dhe Turqinë, e cila ka pritur deri tani 50 mijë refugjatë.

Mes të vdekurve apo të tjerëve që janë detyruar të braktisin shtëpitë, në Siri ka edhe shumë familje shqiptare (të njohur si Arnautë). Në fakt, ata kanë shumë vite që jetojnë atje, kryesisht që nga koha e Shtetit Osman. Ata tashmë janë integruar dhe kanë pasaportë siriane, e megjithatë, nuk e kanë harruar origjinën e tyre, bile ka prej tyre që dinë të flasin dhe shqip.

SHQIPTARËT NË SIRI

Nga të parët e tyre kanë mësuar se janë vendosur në Siri

që në kohën e Shtetit Osman apo nga fundi i shekullit XIX dhe fillimi i shekullit XX e megjithatë, ata nuk e kanë harruar se kanë origjinë shqiptare. Disa prej tyre dinë të tregojnë se e kanë origjinën nga Shkodra, Peja, Podujeva, Vushtria etj. Shumica mbajnë mbiemrin "Arnaut" (shqiptar) dhe të gjithë i dinë lagjet ku banojnë shqiptarët. Mes tyre ka dhe njerëz të njohur të letrave në Siri, në botën arabe, por edhe në trojet shqiptare, si Dr. Muhamed Mufaku-Arnauti nga Damasku, i cili ka shkruar dhe përkthyer mbi 40 libra të ndryshëm, në arabisht dhe shqip, të botuara në vende të ndryshme, si në Damask, Beirut, Prishtinë, Tiranë etj. Ai është po ashtu, nipi i një prej dijetarëve më të mëdhenj myslimanë me origjinë shqiptare, Abdulkadër Arnauti, i cili ka jetuar në Damask.

Ministria e Jashtme e Shqipërisë thotë se bëhet fjalë për 5 mijë shqiptarë, ndërkohë që Drejtori Ekzekutiv i Qendrës Shqiptare për Studime Orientale (ACFOS-Albania), Ermal Bega, thotë se në qytete të ndryshme të Sirisë jetojnë mbi 10 mijë arnautë (shqiptarë). Madje, ai shton se ngritja e një ambassade atje do ta forconte më tej këtë komunitet.

Tensionim në marrëdhëniet Turqi-Iran

Javëve të fundit është vënë re një tensionim në rritje ndërmjet Turqisë dhe Iranit, por edhe nisura për ta eliminuar këtë tensionim. Në krye të zhvillimeve shkaktare të tensionimit në fjalë, qëndron deklarata me cilësi kërcënuese për Turqinë, bërë nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë së Iranit. Kundrejt kësaj deklarate kërcënuese, Turqia reagoi nëpërmjet një note proteste të Ministrisë së Punëve të Jashtme, që u shoqërua gjithashtu nga komunikatat verbale të Kryeministrit Rexhep Tajip Erdoan dhe ministrit të Jashtëm, Ahmet Davutollu. Ankaraja e paralajmëroi Teheranin, duke theksuar se një qëndrim i tillë bie ndesh me normat politiko-morale dhe mund të dëmtojë marrëdhëniet Turqi-Iran.

Megjithatë, nuk ishte kjo e vetmja arsye e tensionimit; pasi u rritën dyshimet se Irani mbështet aktet terroriste të PKK-së. *Vrasja në krye të detyrës e 8 ushtarëve turq nga terroristët e PKK-së në një zonë pranë kufirit me Iranin, bëri që kritikën dhe reagimet e Ankarasë në adresë të Teheranit të pësojnë një rritje drastike, sepse informacionet e shërbimeve sekrete tregojnë që terroristët janë infiltruar nga Irani për të kryer sulmin.* Pikërisht në këtë atmosferë të tensionuar, ministri iranian i Punëve të Jashtme, Ali Ekber Salih, realizoi një vizitë surprizë në kryeqytetin turk. Gjatë takimit 3 orësh në Ankara, që Salih pati me homologun turk, Ahmet Davutollu, nuk u fol vetëm për çështjen e lartpërmendur, por edhe për krizën siriane. Kreu i diplomacisë persiane i mohoi deklaratat e shefit të Shtatmadhorisë së vendit të tij dhe vuri theksin mbi bashkëpunimin turko-iranian kundër terrorit.

Për fat të mirë, as aftësitë udhëheqëse logjike dhe të ndjeshme të Ankarasë dhe as ato të Teheranit nuk janë bërë asnjëherë vegël e këtyre lloj skenarëve. Liderшипet e Turqisë dhe Iranit i kanë qëndruar besnike qëndrueshmërisë dhe

pandryshueshmërisë së kufijve dhe ekuilibrit 4-shekullor Turqi-Iran. Pavarësisht se mes tyre kanë një numër jo të vogël dallimesh dhe mosmarrëveshesh, këto dy vende kanë mbajtur gjithnjë në konsideratë se njëkohësisht kanë edhe shumë interesa të përbashkëta. Duke qenë se e dinë mjaft mirë që kanë nevojë për njëra-tjetrën dhe që trazirat në njërin prej tyre do të ndikonin me kah negativ edhe tjetrën, përgjithësisht Turqia dhe Irani e kanë mbështetur njëra-tjetrën. Shembulli më tipik për këtë, është dialogu Ankara-Teheran në periudhën e vështirësive, që Irani përjeton për shkak të programit të tij bërthamor. Mjafton të kujtojmë se sa shumë është përpjekur Turqia për të eliminuar pengesat e Iranit në këtë çështje, madje, duke marrë parasysh të gjitha rreziqet, ajo ka votuar edhe kundër në Këshillin e Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, për të parandaluar sanksione ndërkombëtare në dëm të Iranit.

Pritshmëria është që edhe udhëheqja iraniane ta kuptojë këtë vullnet të mirë të Turqisë dhe të veprojë në përputhje me të. Qeveritarët e Iranit duhet të njëmendësojnë se sa helmuese është deklarata e shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë në Iran. Ata duhet të jenë të vetëdijshëm se shmangia e qëndrimeve, që do ta vendosnin Iranin përballë Turqisë, është e domosdoshme edhe për interesat e tyre kombëtare.

Tani lindin këto pyetje: Si do të veprojë Turqia dhe Irani në këtë periudhë, që të mund të dalin pa dëme nga kjo krizë? Vallë, a do të arrijnë vizita e Ali Ekber Salihit në Turqi dhe paralajmërimet e kësaj të fundit ta zgjidhin një problem të tillë? Për të mësuar përgjigjen e këtyre pyetjeve, do të na duhet të presim...